

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti Juridik

Studime të ciklit të dytë-programi “E drejta civile”



***“Gjuha e palëve dhe gjykatës në procedurën
kontestimore, në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
me theks të veçantë në komunën e Strugës nga 2008
deri më 2018”***

Kandidatja:

Ajhan Kain

Mentor:

Prof.dr. Adnan Jashari

Përmbajtja

Hyrje_____	6
Kapitull I _____	8
1.Nocioni dhe qëllimi i procedurës kontestimor_____	8
2. Objekti dhe karakteristika e procedurës kontestimore_____	9
3.Procesi kontestimor_____	12
4.Prezumimet procedurale_____	16
5.Parimet e procedurës kontestimore_____	18
6.Subjektet në procedurën kontestimore_____	32
6.1.Gjykata _____	33
6.2. Palët procedurale _____	37
6.3.Personat e tretë në procedurë _____	42
6.4. Përfaqësuesit e palëve _____	45
7.Zhvillimi i procedurës _____	51
7.1. Padia nocioni, llojet, efekti juridik, kundërpadia._____	51
7.2.Përgatitja e shqyrtimit kryesor dhe shqyrtimi kryesor_____	56
7.3.Aktgjykimi dhe aktvendimi_____	58

7.4. Plotëfuqishmëria	61
Kapitulli II	63
1. Kushtetuta e ish RSFJ dhe ndryshimet e pësuara nga 1945 deri më 1991	63
2. Ligji mbi procedurën kontestimore 1956 dhe Ligji mbi procedurën kontestimore 1976.	65
3. Ligji mbi gjykatat i vitit 1976	67
4. Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë	71
Kapitulli III	73
1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991	73
2. Amandamenti V	75
3. Gjuha në Ligjet për procedurën kontestimore (1998 dhe 2005)	78
4. Ligji për përdorimin e gjuhës së cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal (2008)	81
5. Ligji mbi përdorimin e gjuhëve (2019)	83
Kapitulli IV	86
1. Të dhëna statistikore nga anketa	86
2. Konkluzat dhe rekomandime	92
Bibliografia	95

Hyrje

Gjuha dhe gjuha e përdorur nëpër institucionet shtetërore është një pjesë integrale e funksionimit të tyre. Për këtë arsye shtetet kanë sjellë dispozita të inkorporuara nëpër ligje me të cilët rregullohet funksionimi i institucioneve dhe gjuha në të cilën komunikojnë ato. Në raste të caktuara shtetet kanë sjellë edhe ligje të tëra për të rregulluar çështjen në fjalë, ngaqë ekzistojnë raporte komplekse në mes etnive të cilat jetojnë në territorin e atyre shteteve.

Në këtë punim ne do të përqëndrohemi në sqarimin e gjuhës me të cilën komunikojnë organet shtetërore, dhe më saktësisht gjuha e cila përdoret nëpër procedurat gjyqësore. Për të qenë më të saktë gjuhën e përdorur në procedurën kontestimore. Duke pasur parasysh se ekzistojnë marrëdhënie komplekse ndërmjet etnive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pushteti legjislativ, i ndikuar nga marrëdhëniet shoqërore dhe presioni shoqëror, u detyruan që ta rregullojë çështjen në fjalë në mënyrë më të detajuar.

Republika e Maqedonisë së Veriut si shoqëri multi etnike, e ka rregulluar çështjen e gjuhës me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve, megjithatë nuk ka qenë gjithmonë kështu. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë pas shpalljes së pavarsisë nuk parashihte përdorim të gjuhëve të tjera të ndryshme nga ajo maqedone. Megjithatë me amandamentet kushtetuese të 2002 kjo çështje është ri rregulluar. Kjo ka çuar në materializimin e këtyre amandamenteve dhe konkretisht të amandamentit V në ligje të tëra, por gjithashtu kanë ndikuar edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë ligjet të cilat kanë ekzistuar. Duke pasur parasysh se Amandamenti i V rregullon çështjen e gjuhës, i cili është materializuar në një mori ligjesh.

Kjo gjë ka ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe indirekte, në të gjithë sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vijim të këtij punimi do të mundohemi të shqyrtojmë në mënyrë të detajuar procedurën kontestimore si të tëra. Gjithashtu do të shqyrtojmë të gjitha aktet juridike me rëndësi që tangojnë gjuhën në procedurën kontestimore

dhe jo vetëm. Në një kapitull të veçantë të këtij punimi do të shqyrtojmë edhe zhvillimin historik të gjuhës së përdorur nëpër procedurat kontestimore nëpër gjykatat e Republikës së Maqedonisë, qoftë ajo si njësi federale e ish Jugosllavisë dhe gjithashtu pas pavarësisë nga ish Jugosllavia. Në pjesën e fundit të këtij punimi do të sjellim edhe rezultatet nga një anketë e realizuar nga ana jonë, për të pasur parasysh mendimin e qytetarëve në lidhje me gjuhën dhe çështjet e gjuhës në vendin tone.

Si hipoteza të këtij punimi kemi këto: 1. Palët mund t'i drejtohen gjykatës në gjuhë që është e ndryshme nga gjuha maqedonase për inicim të procedurës kontestimore.

2. Në çfarë gjuhe mund të komunikojë gjykata me palët në procedurën kontestimore?

3. A vlen edhe në këtë rast parimi Ligji i veçantë derogon Legjin e përgjithshëm, përkatësisht a duhet Ligji mbi përdorimin e gjuhëve ta derogojë Ligjin për procedurë kontestimore, për sa i përket dispozitave që kanë të bëjnë me gjuhën ?

4. Sa është i theksuar komunikimi i gjykatës përveç gjuhës maqedone me palët edhe në gjuhë tjetër të ndryshme nga gjuha maqedone me palët në Komunën e Strugës.

Në këtë punim do të shërbejemi me këto metoda studimi: Me qëllim të vërtetimit të hipotezave të përmendura më lartë dhe të konkluzioneve që do të nxjerr në përfundim të punimit, do të shfrytëzoj disa metoda me të cilat do të realizoj qëllimet e theksuara në këtë punim. Gjatë punimit të magjistraturës do të përdor më shumë metoda, të cilat i gjen të kombinuara gjatë gjithë punimit, dhe të cilat shpresoj që të më japin një pasqyrë më të plotë për përshtatjen e normave juridike raporteve konkrete shoqërore, edhe atë: metodën historike, metodën e analizës, metodën e sintezës, metodën normative, metodën komparative, metodën empirike, metodën statistikore dhe grafike.

Në vijim do të fillojmë të shqyrtojmë çështjet të cilat i përmendëm më sipër, duke i trajtuar ato në mënyrë të detajuar. Në kapitullin e parë do trajtojmë procedurën kontestimore si tërësi.

KAPITULLI I

1.Nocioni dhe qëllimi i procedurës kontestimore.

Kur flasim për procedurën në përgjithësi përherë na asocion në një lloj metode për të arritur një qëllim të caktuar. Duke bërë analogji me titullin e mësipërm mund të vërejmë se procedura kontestimore paraqet një metodë, për të arritur një qëllim të caktuar, siç edhe është rasti në të shumtat e procedurave gjyqësore, rrjedhimisht kemi të bëjmë me mbrojtjen e të drejtës subjektive civile. Me fjalë të tjera "procedura kontestimore paraqet veprim të rregulluar me ligj, të gjykatës, të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë të orientuar kah qëllimi i caktuar – mbrojtja e të drejtave subjektive civile të shkelura apo të rrezikuara".¹ Gjithashtu "tërësia (përmbledhja) e veprimeve procedurale që i ndërmarrin subjektet procedurale, respektivisht tërësia e marrëdhënieve procedurale që vendosen ndërmjet subjekteve që marrin pjesë gjatë shqyrtimit dhe vendosjes gjyqësore lidhur me marrëdhëniet e caktuara juridike e përbëjnë procedurën kontestimore".²

Për sa i përket qëllimit të procedurës kontestimore duket mjaftë e thjeshtë që në mënyrë deduktive të kuptohet nga aq sa u tha më lartë, por çështja nuk është edhe aq e thjeshtë. Për sa i përket qëllimit të procedurës kontestimore ekzistojnë përplasje në doktrinën juridike. Megjithatë këto pikëpamje nuk janë diametralisht të kundërta, ata përsëri dallojnë në disa elemente nga njëra tjetra. Sipas njëres pikëpamje qëllimi i procedurës kontestimore është mbrojtja e të drejtave subjektive të qytetarëve.³ Kjo pikëpamje ka mangësi në vetvete. Ajo nuk

¹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 52

² Po aty

³ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 56.

e dallon qëllimin e vënies në veprim të procedimit civil, nga ana e palës, nga qëllimi, i cili realizohet me procedimin civil, si institut juridik, në jetën e përditshme shoqërore.⁴

Sipas pikëpamjes së dytë, qëllimi i gjykimeve kontestimore është, pra, vërtetimi (rivendosja) e sistemit të cënuar juridik, e vetvetiu edhe zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve shoqërore mbi të cilat është mbështetur sistemi juridik.⁵ Njëkohësisht, me këtë realizohet edhe qëllimi, të cilin e ka pasur subjekti juridik me rastin e kërimit të mbrojtjes.⁶

Nga sa mund të vërehet prej më lartë, pikëpamjet të cilat flasin për qëllimin e procedurës, në esencë nuk janë edhe aq të ndryshme. Megjithatë sipas mendimit tonë këto dy pikëpamje edhe pse në qasje janë të ndryshme dhe burojnë nga pikëpamje diametralisht të kundërta juridiko – politike, ato në vetvete plotësojnë njëra tjetrën.

2. Objekti dhe karakteristika e procedurës kontestimore.

Kur flasim për objektin e procedurës kontestimore gjithmonë kemi parasysh, marrëdhënien juridike për të cilën është duke u zhvilluar procedura kontestimore. Duke u nisur nga kjo dhe duke u bazuar në Ligjin për procedurë kontestimore përkatësisht neni 1 të këtij ligji kuptojmë se : "Me këtë ligj rregullohen, rregullat e procedurës në bazë të së cilave gjykata shqyrton dhe vendos në kontestet për të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit, për marrëdhëniet personale dhe familjare të qytetarit, siç janë kontestet nga marrëdhëniet e punës, tregtare, pronësore dhe kontestet e tjera juridiko civile, nëse me ligj nuk për ndonjë nga ato konteste nuk është paraparë që gjykata ato t'i zgjidhë sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër".⁷ Nga vetë përkufizimi dhe përcaktimi ligjor në nenin 1 të Ligjit për procedurë kontestimore mund të vërehet se çfarë është objekt i procedurës kontestimore.

⁴ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 56.

⁵ Po aty

⁶ Po aty.

⁷ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 10.02.2020.

Duke u thirru përsëri në nenin 1 të L.P.K. mund të nxirren edhe karakteristikat e procedurës kontestimore. Si karakteristika të procedurës kontestimore janë: 1) procedura kontestimore është metodë e rregullt për zgjidhjen e konflikteve/kontesteve juridiko civile; 2) procedura kontestimore është procedurë kontestuese; 3) Procedura kontestimore është procedurë e gjykit.

Procedura kontestimore është metodë e rregullt për zgjidhjen e konflikteve/ kontesteve juridiko civile, sepse kjo rrjedh nga vetë formulimi i dispozitës ligjore të nenit 1 të L.P.K. Ngaqë nëqoftë se ndonjë kontest juridiko civil do të duhej të zgjidhej sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër, ajo atëherë do të paraqiste përjashtim nga rregulla, edhe pse kontesti mund të burojë nga marrëdhëniet civile.

Procedura kontestimore është procedurë kontestuese, ngaqë pala e cila e ka inicuar procedurën ka një kërkesë ndaj palës së paditur të cilën pala e paditur e mohon në tërësi apo pjesërisht, ngaqë në qoftë se do të ishte një situatë e ndryshme, nuk do të ekzistonte nevoja për të vendosur në lëvizje aparatin shtetëror për mbrojtje të së drejtave subjektive të subjekteve të së drejtës. Megjithatë edhe tek kjo karakteristikë mund të paraqitet një përjashtim. Gjatë zhvillimit të procedurës mund të ndodhë që kontesti të pushojë së ekzistuari. Kjo nuk do të thotë se pushon së zhvilluari edhe procedura kontestimore e cila është duke u zhvilluar. Gjykata në këtë rast do i ndjekë hapat e paraparë me ligj për një situatë të këtillë dhe do e përfundojë procedurën me anë të aktgjykit, me lidhjen e pajtimit gjyqësor etj. Sipas profesori Janevski :” procedurës kontestimore nuk i paraprin çdoherë kontesti.⁸ Zhvillimi i saj nuk presupozon çdoherë ekzistimin e kontestit lidhur me ndonjë raport të caktuar juridiko – civil.⁹ Në procedurën kontestimore zgjidhen çështje për të cilat që nga fillimi i vetë procedurës ndërmjet palëve nuk ka kontest (p.sh. shkurorëzimi i martesës sipas propozimit me marrëveshje nga ana e bashkëshortëve, vëretetimi i ekzistimit të martesës dhe të ngjajshme).¹⁰ Edhe pse, ndërmjet palëve nuk ekziston kontesti, megjithatë procedura kontestimore inicohet dhe

⁸ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 54

⁹ Po aty

¹⁰ Po aty

zhvillohet, sepse ajo është mënyrë e vetme e përcaktuar me ligj për realizimin e së drejtës së caktuar¹¹”.

Në lidhje me karakteristikën e tretë, themi se procedura kontestimore është procedurë e gjykimit ngaqë, në këtë procedurë shqyrtohet kërkesëpadia, shqyrtohen provat e propozuara nga palët, deklaratat, u lejohej palëve që të ”konfrontohen”, dhe në fund gjykata sipas bindjes së saj të lirë, do bëjë vendosjen në lidhje me çështjen në fjalë, me fjalë të tjera do e gjykojë çështjen dhe do vendosë për të me aktgjykim.

Nga sa u tha më lartë mund të kuptojmë se për të inicuar procedurën kontestimore gjithmonë është e nevojshme padia. Padia i drejtohet gjykatës. Në të personi i cili i’a ka drejtuar gjykatës padinë (paditësi) duhet qartë të përcaktojë se kë padit, cila marrëdhënie juridiko civile është kontestuese dhe të substancojë padinë e tij. Gjykata pasi të shqyrtojë padinë lidhur me rregullshmërinë formale do i’a dërgojë të njëjtën personit i cili është i përcaktuar në padi si personit të cili i është drejtuar ajo (i padituri). I njëjti ka afat që brenda 30 ditëve të bëjë përgjigje në padi, n.q.s. nuk e bën një gjë të tillë llogaritet se ai e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit. Nqs i padituri i përgjigjet duke kontestuar kërkesën/at e padisë, atëherë fillon së ekzistuari kontesti edhe gjithashtu krijohet edhe raporti i litispindencës. Në këtë situatë gjykata fillon të ndërmarrë hapat për mbajtjen e seancës pregatitore nëse kjo është e nevojshme, në qoftë se jo atëherë do të ndërmarrë hapat për mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Pasi të konsumohet gjithcka e cila është e paraparë për t’u shqyrtuar në shqyrtimin kryesor, dhe me këtë nënkuptojmë fjalën hyrëse (nqs nuk ka seancë përgatitor) nga palët, propozimin dhe shqyrtimin e provave, qofshin ato dëshmitarë, dokumente ose prova në forma të tjera, gjykata do u japë mundësinë palëve për të thenë fjalën e tyre përfundimtare. Pasi të mbyllet shqyrtimi kryesor, gjykata do të vendosë në lidhje me çështjen e shqyrtuar. Pasi të ketë sjellë vendim gjykata do e shpall aktgjykimin. Ndaj të njëjtit palët kanë të drejtë ankese. Ankesa i drejtohet gjykatës, dhe pasi gjykata të shqyrtojë rregullshmërinë formale të saj, të gjithë lëndën e shqyrtuar do i’a dërgojë gjykatës së shkallës më të lartë për t’a shqyrtuar. Nqs gjykata e shkallës së dytë vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, aktgjykimi nuk mund të goditet me mjete të

¹¹ Po aty

rregullta të goditjes. Rrjedhimisht merr formën e prerë dhe çështja bëhet *res iudicata*. Aktgjykimet e formës së prerë palët mund t'i godasin me mjete të jashtëzakonshme të goditjes, kuptohet brenda afatit të përcaktuar ligjor. Nqs nuk e ndërmarrin këtë veprim brenda afatit të përcaktuar aktgjykimi nuk mund të goditet me asnjëfar lloj mjeti juridik.

3.Procesi kontestimor

Nga aq sa u përmend më lartë përciptazi u theksua edhe procesi kontestimor. Në këtë nënkapitull do të elaborojmë procesin kontestimor dhe gjithashtu shkurt do trajtojmë edhe natyrën juridike të tij. Në një numër të madh të rasteve procesi kontestimor përdoret si sinonim i procedurës kontestimore, megjithatë këto janë dy konstruksione të ndryshme juridiko-teorike. Dallojnë në një mori elementesh.

Që të kuptojmë procesin kontestimor, duhet së pari të shqyrtojmë prejardhjen etimologjike të procesit kontestimor. Kjo gjendet në gjuhën latine, përkatësisht në *ffjalët lis, litis*, që do me thënë kontest, grindje, konflikt. Pra procesi kontestimor paraqet një grindje, procedura e inicuar kontestimore, jo përherë mund të jetë e tillë ose të përmbajë këtë element. Duke u nisur nga kjo mund të themi se procesi kontestimor paraqet metodë të parashikuar me ligj për shqyrtim dhe vendosje për të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit në kontestet nga marrëdhëniet pasurore dhe marrëdhëniet e tjera juridike në plan konkret (in concreto).¹²

Sa i përket procedurës kontestimore profesori Janevski shprehet: "Procedura kontestimore paraqet metodë të parashikuar me ligj për shqyrtim dhe vendosje për të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit në kontestet nga marrëdhëniet personale dhe familjare, nga marrëdhëniet e punës, si dhe nga marrëdhëniet pasurore dhe marrëdhëniet e tjera juridike civile në plan të përgjithshëm (in abstracto)".¹³ Siç mund të vërejmë dallimi i parë qëndron në aspektin e zgjidhjes së çështjes konkrete (me procesin kontestimor, si kategori

¹² Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 58

¹³ Po aty.

konkrete) dhe zgjidhjen e çështjes në mënyrë abstrakte për numër të pakufizuar të rasteve me procedurën civile.

Një dallim tjetër në mes të procedurës kontestimore dhe procesit kontestimor paraqitet edhe në momentin në të cilin paraqitet njëra dhe në cilin moment paraqitet tjetra. Kur flasim për procedurën kontestimore, siç edhe e kemi përmendur, ajo paraqitet, apo fillon të ekzistojë kur paditësi e ka parashtruar padinë në gjykatë. Me fjalë të tjera kur padia si mjet për inicim të procedurës kontestimore, mbërrin në gjykatë, është momenti i nisjes së procedurës kontestimore. Për dallim nga procedura kontestimore, procesi kontestimor fillon të ekzistojë në një moment tjetër. Përkatësisht në momentin kur të paditurit i dërgohet padia për përgjigje. Në këtë moment krijohet trekëndëshi i litispidencës, dhe kështu nis procesi kontestimor. Kushtimisht që i padituri t'i përgjigjet padisë, duke mohuar plotësisht apo pjesërisht kërkespadinë.

Nga sa u tha më sipër kuptojmë se procesi kontestimor është dukuri e cila gjithmonë shfaqet më vonë se procedura kontestimore. Megjithatë mund të ndodhë që të mos paraqitet fare procesi kontestimor në raste të caktuara, përkatësisht të mos ekzistojë gjendja kontestuese, ngaqë për të ekzistuar duhet që të dy palët të jenë në qëndrime kundërthënëse.

Një dallim tjetër në mes procedurës kontestimore dhe procesit kontestimor qëndron edhe në atë se për një proces kontestimor mund të vijmë në shprehje më tepër procedura kontestimore. Kështu duke i'u referuar Profesorit Janevski: “ procesi kontestimor konkret, brenda të cilit zgjidhet ndonjë kontest juridiko-civil mund të përbëhet nga një ose më tepër procedura të njëpasnjëshme paralele.¹⁴ Kështë një proces kontestimor konkret mund të përfundojë me zhvillimin e procedurës së shkallës së parë, ndërsa në një proces kontestimor mund të zhvillohet procedura e shkallës së parë dhe procedura e shkallës së dytë, bile edhe procedura e shkallës së tretë.¹⁵ Nga ana tjetër, edhe atëherë kur procedura në një proces kontestimor konsumohet me procedim të shkallës së parë, procedura mund të ndërlikohet, nëse brenda saj zhvillohet ndonjë procedurë incidentale (p.sh. procedura për zgjidhjen e

¹⁴ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 59

¹⁵ Po aty

çështjes paraprake), ose nëse paralelisht me shqyrtimin për çështjen kryesore dhe në bashkangjitje me të zhvillohet edhe ndonjë procedurë e adhezionit (p.sh. procedura për përjashtimin e gjyqtarit, procedzra për përcaktimin e masës së përkohëshme dhe të ngjajshme)".¹⁶

Kur flasim për natyrën juridike të procesit kontestimor, nuk mund të themi se ka një qëndrim të unifikuar në lidhje me këtë. Në doktrinën juridike ekzistojnë disa pikpamje në lidhje me natyrën juridike të procesit kontestimor, në vazhdim do të përmendim disa nga to. 1) Teoria kontraktuese; 2) Teoria mbi procesin kontestimor si marrëdhënie juridiko – procedurale dhe 3) Teoria mbi procesin kontestimor si gjendje juridike.

- 1) Teoria kontraktuese, sipas kësaj teorie procesi kontestimor është kontratë juridiko-civile të lidhur ndërmjet palëve procedurale.¹⁷ Me lidhjen e kësaj kontrate, palët obligohen ti nënshtrohen gjykimit në rast të kontestit eventual ndërmjet tyre.¹⁸ Nga sa u tha mund të themi se kjo teori ka mangësi serioze, sepse një proces kontestimor nuk mund të burojë vetëm nga një kontratë e lidhur mes dy palëve të caktuara. Procedura kontestimore mund të inicohet me padi nga çdokush ndaj çdokujt nëse pretendon se i është shkelur apo rrezikuar ndonjë e drejtë. Gjykata nuk fillon të veprojë sipas vullnetit të palëve, por sipas dispozitave juridiko publike, të cilat parashohin veprimin dhe ushtrimin e kompetencave që dalin nga ato dispozita. Sot kjo teori është në tërësi e braktisur.
- 2) Teoria mbi procesin kontestimor si marrëdhënie juridiko – procedurale thotë se procesi kontestimor është dukuri juridiko – procedurale. Kjo ngaqë procedura zhvillohet sipas dispozitave juridiko – publike dhe gjithashtu gjykata autorizimet e veta në lidhje me zgjidhjen e kontestit i nxjerr nga dispozitat juridiko – publike. Këtu edhe gjykata është palë, për dallim nga teoria kontraktuese. Prandaj, procesi kontestimor definohet si marrëdhënie juridiko – publike e cila krijohet ndërmjet

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

¹⁸ Po aty

gjykatës dhe palëve procedurale, me qëllim të sjelljes së vendimit të gjykatës lidhur me bazën e kërkesës për mbrojtje juridike.¹⁹

- 3) Sipas teorisë mbi procesin kontestimor si gjendje juridike, procesi kontestimor nuk është as marrëdhënie juridike materiale, e as marrëdhënie juridike procedurale, por është situatë juridike që krijohet gjatë zhvillimit të një marrëdhënie.²⁰ Sipas profesorit Janevski: "edhe pse, është e pakontestueshme se procesi kontestimor, si tërësi zhvillohet nëpërmjet të veprimeve të subjekteve procedurale, duke kaluar nga një gjendje juridike në tjetrën, kësaj teorie mund t'i bëhet vërejtje se procesin kontestimor e vështron vetëm si situatë të veçantë (të padrejtë) jetësore, duke mohuar në këtë mënyrë karakterin imperativ të normave me të cilat rregullohen veprimet e subjekteve procedurale."²¹

Nga e gjithë ajo sa u tha më sipër mund të vërejmë se të tre teoritë të cilat i përmendëm kanë mangësi dhe nuk e përcaktojnë saktësisht natyrën juridike të procesit kontestimor. Vlerësojmë se më e saktë do të ishte që natyrën juridike të procesit kontestimor ta cilësojmë si "marrëdhënie juridike specifike – marrëdhënie juridiko – procedurale". Gjatë zgjidhjes së kontestit, i cili buron nga marrëdhënia e caktuar juridiko – materiale, ndërmjet palëve në procesin kontestimor, si dhe ndërmjet tyre dhe gjykatës krijohet marrëdhënie e cila është e rregulluar me (rregullat) normat e së drejtës procedurale.²²

Procesi kontestimor është marrëdhënie dinamike juridiko – procedurale, marrëdhënie në lëviyje dhe zhvillim të vazhdueshëm.²³ E Shikuar në këtë kuptim procesi kontestimor paraqet një varg situatash procedurale, të cilat nëpërmjet veprimeve të subjekteve procedurale ndryshojnë vazhdimisht, gjithnjë përderisa nuk arrihet qëllimi përfundimtar i procesit

¹⁹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 60

²⁰ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 61

²¹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 61

²² Po aty.

²³ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 62

kontestimator dhe ajo nuk pushon.²⁴ Procesi kontestimator si marrëdhënie juridiko – procedurale pushon me plotëshfuqishmërinë e vendimit, me të cilin zgjidhet kontesti, ose në ndonjë moment të mëhershëm të zhvillimit të saj procesi kontestimator pushon si rezultat i vullnetit të vetë palëve (p.sh. me tërheqjen e padisë, me lidhjen e pajtimit gjyqësor dhe të ngjajshme).²⁵

4.Prezumimet procedurale

Sikurse edhe në procedurat e tjera, ashtu edhe në procedurën kontestimore duhet bërë dallimi midis lejueshmërisë së procesit gjyqësor dhe themelësisë së kërkesëpadisë.²⁶ Lejueshmëria e procesit vlerësohet në bazë të normave procedurale – juridike, kurse themelësia e kërkesëpadisë në bazë të normave materialo – juridike.²⁷ Rrethanat apo kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor quhen prezumime procedurale.²⁸

Siç mund të vërejmë Profesori Brestovci në mënyrë shumë të thukët ka sqaruar se çfarë janë prezumimet procedurale. Duke u nisur nga kjo mund të orientohemi dhe të kërkojmë këtë kategori juridike në L.P.K. Megjithatë, duhet pasur parasysh se termi “prezumime procedurale” është vetëm konstruksion teorik, e jo edhe kategori ligjore. Në L.P.K. për këtë gjë ekziston termi “pengesa procedurale”.

Kur flasim për prezumimet procedurale, shtrohet pyetja se kush duhet të mbajë llogari për to? Për një pjesë të prezumimeve procedurale mban llogari ex officio gjykata, p.sh. kur bën vlerësimin e rregullshmërisë formale të padisë. Për një pjesë tjetër të prezumimeve procedurale mund të mbajnë llogari edhe palët, megjithatë për to (prezumimet procedurale) përherë vendos gjykata. Mungesa e prezumimeve procedurale mund të çojë deri në hedhjen poshtë të padisë. Megjithatë, n.q.s një procedurë veçmë është vendosur në lëvizje dhe ka kaluar nëpër disa stadiume, ajo procedurë nuk mund të anulohet, sepse ekzistimi i mungesës së atyre prezumimeve ka qenë me karakter relativ, dhe ato më nuk paraqesin pengesë.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq.194

²⁷ Po aty

²⁸ Po aty

Ekzistojnë më shumë kritere të cilat grupojnë prezumimet procedurale, në vijim shkurtazi do i shqyrtojmë një nga një. Prezumimet procedurale mund të klasifikohen në: prezumime të përgjithshme procedurale; prezumime të veçanta procedurale; prezumime procedurale pozitive; prezumime procedurale negative; prezumime procedurale absolute; prezumime procedurale relative; prezumime procedurale që kanë të bëjnë me gjykatë; prezumime procedurale që kanë të bëjnë me palët; prezumime procedurale që kanë të bëjnë me objektin e kontestit dhe prezumimet procedurale lidhur me padinë. Në vijim do i shqyrtojmë me radhë të gjitha këto klasifikime.

- 1) Prezumime procedurale të përgjithshme janë ato prezumime nga ekzistimi i të cilave varet lejimi i çdo procedure.
- 2) Prezumime procedurale të veçanta – Me dallim nga prezumimet procedurale të përgjithshme, të cilat duhet të plotësohen në çdo proces kontestimor, prezumimet e posaçme ligji i parasheh për lejueshmërinë e disa procedurave të posaçme kontestimore, për lejueshmërinë e procedurës në gjykatën e shkallës së dytë apo për vendosj mbi ndonjë çështje procedurale të caktuar²⁹(deponimi i kaucionit aktorial, besueshmëria e dokumentit për dhënien e urdhër pagesës etj).
- 3) Prezumime procedurale pozitive, janë ato prezumime procedurale nga ekzistimi i të cilave mundësohet zhvillimi i procedurës kontestimore dhe rrejdhimisht edhe sjellja e aktgjykimit.
- 4) Prezumime procedurale negative, janë ato prezumime procedurale ekzistimi i të cilave e pengon, pamundëson zhvillimin e procedurës kontestimore dhe rrjedhimisht sjelljen e vendimit për themelësinë e padisë. Këtu bëjnë pjesë litistpedenca ose ndryshë thënë gjyqvarësia, pajtimi gjyqësor, aktgjykimi i formës së prerë (res iudicata), kalimi i afatit prekluziv etj.
- 5) Prezumimet absolute janë ato prezumime për të cilat gjykata vendos ex offitio.
- 6) Prezumimet relative janë ato prezumime për të cilat gjykata mban llogari vetëm sipas kërkesës së palës, apo prapësimit të palës. Në këtë grup bëjnë pjesë: prapësimi për kaucionin aktorial, prapësimin për ekzistimin e kontratës për arbitrazh etj.

²⁹ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 196

- 7) Presumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën janë kompetenca e gjykatës përkatësishtë ajo lëndore dhe territoriale, përbërja e rregullt e gjykatës dhe objektiviteti i bartësve të funksionit të gjyqtarit.
- 8) Presumimet procedurale lidhur me palët janë: ekzistimi i palës; zotësia e palës për të qenë palë ndërgjyqëse; zotësia procedurale e palëve dhe përfaqësimi i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale, përfaqësimi i rregullt i personit juridik dhe ekzistimi i prokurës së rregullt, autorizimi procedural për ndjekjen e çështjes në gjyq (legitimatio ad processum)³⁰, interesi juridik për të kërkuar mbrojtje juridike me përmbajtje të caktuar.
- 9) Presumimet procedurale të cilat kanë të bëjnë me objektin e kontestit janë: të jetë e lejuar rruga e rregullt për mbrojtje juridike, të mos ketë litispedencë të dyfishtë, mos jetë lidhur pajtimi gjyqësor, mos jetë çështje e gjykuar në mënyrë të plotëfuqishme, padia të jetë e parashtruar në kohë, nëse me dispozitë të veçantë është parapraë afati i caktuar për paraqitjen e saj.³¹
- 10) Presumimet procedurale të cilat kanë të bëjnë me padinë është: rregullshmëria e padisë.

Nga sa u tha më lartë mund të vërejmë se ekzistojnë një numër i madh kriteresh sipas të cilëve mund të bëhet kategorizimi i prezumimeve procedurale. Nisur nga kjo edhe njëherë të theksojmë se presumimet procedurale paraqesin kushte apo rrethana nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor konkret, i cili është inicuar me padi. Me fjalë të tjerë ekzistimi ose mos ekzistimi i ndonjërës nga këto rrethana mund të çojë deri në palejueshmërinë e zhvillimit të procesit dhe anasjelltas.

5.Parimet e procedurës kontestimore

³⁰ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 195

³¹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 64

Kur flasim për parimet e procedurës kontestimore, kemi parasyshë se jemi duke folur për rregullat themelore të cilat janë udhërrëfyes i përgjithshëm për atë se nga çfarë lloj qasje duhet të jetë e qeverisur një procedurë. Në vijim do sjellim mendimet e disa profesorëve eminent të cilët janë shprehur në lidhje me parimet e procedurës kontestimore.

Sipas Profesorit Brestovci: “Me fjalën parim (maksimë, princip) emërtohet përfundimi i përgjithshëm që del nga njohja e botës dhe që vihet në themel të një teorie, të një botëkuptimi a të një shkence.³² Në procedurën kontestimore me këtë term quhen rregullat themelore të cilat e përshkojnë aktivitetin të cilin e kryejnë subjektet e procesit me qëllim që të arrihet mbrojtja juridike e së drejtës subjektive apo me qëllim që të konstatohet se për një gjë të tillë nuk ka vend.³³ Parimet e kësaj procedure i caktojnë metodat e veprimi që kryhet gjatë shqyrtimin të çështjes juridike dhe vendosjes mbi të. Parimet në fjalë ia japin vulën kryesore institucioneve të procedurës kontestimore dhe shkencës së procedurës kontestimore.³⁴ Njohja e parimeve të kësaj disipline juridike është e domosdoshme sikurse për ligjdhënësin ashtu edhe për atë që i zbaton normat e krijuara nga ligjdhënësi.”³⁵

Profesori Janevski në lidhje me parimet e procedurës kontestimore, dhe parimet në përgjithësi shprehet: “Parimet janë rregulla të përgjithshme dhe themelore, kahe, postulate për punë të orientuara drejt një qëllimi të caktuar.³⁶ Nëpërmjet tyre shprehen qëllime të caktuara juridiko – politike dhe juridiko – teknike të cilat realizohen në procedurë dhe që shërbejnë si udhërrëfyes gjatë rregullimit të procedurës për dhënien e ndihmës juridike.³⁷ Postulatet themelore të mbrojtjes juridike të cilat duhet të realizohen nëpërmjet të procedurës janë: ligjshmëria, drejtëshmëria, efikasiteti dhe ekonomia. Për realizimin e këtyre postulateve të mbrojtjes juridike shërbejnë parimet themelore procedurale.³⁸ Nëpërmjet tyre shprehen karakteristikat thelbësore të procedurës si metodë e mbrojtjes juridike dhe paraqesin

³² Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 51

³³ Po aty

³⁴ Po aty

³⁵ Po aty

³⁶ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq.66

³⁷ Po aty

³⁸ Po aty

udhërrëfyes dhe ide e cila na shpie në formësimin e instituteve procedurale.³⁹ Parimet themelore të procedurës paraqesin kahe për zbatimin e aktiviteteve procedurale.”⁴⁰

Si parime të procedurës kontestimore mund të numërohen këto: 1) Parimi i dispozitivitetit dhe oficalitetit; 2) Parimi i shqyrtimit dhe hetimit; 3) Parimi i dëgjimit të palëve; 4) Parimi i konstatimit të së vërtetës; 5) Parimi i vlerësimit të lirë të provave; 6) Parimi i zhvillimi të gjykimi gojarisht dhe me shkrim; 7) Parimi i pandërmjetësisë; 8) Parimi i publicitetit; 9) Parimi i gjuhës në procedurë; 10) Parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm; 11) Parimi i ekonomisë procedurale; 12) Parimi i koncentrimit të procedurës dhe unitetit të shqyrtimit kryesor. Siç mund të vërejmë procedura kontestimore udhëhiqet nga një numër i konsiderueshëm parimesh të cilat kanë për qëllim të mundësojnë mbrojtjen e të drejtave subjektive të subjekteve të së drejtës, por gjithashtu edhe ruajtjen e së drejtës objektive.

Parimi i dispozitivitetit dhe oficalitetit. Parimi i dispozitivitetit është një nga parimet themelore dhe më të rëndësishme të procedurës kontestimore. Ky parim merr shprehje nga vetë dispozitat e L.P.K. Parimi i dispozitivitetit në vetëvete ngërthen disa veprime dispozitive të subjektit të së drejtës. Me këtë nënkuptojmë se subjekti mund të 1) inicojë procedurën; 2) të mbajë atë në rrjedhë; 3) të përcaktojë objektin e procedurës kontestimore, 4) të disponojë me objektin e procedurës dhe 5) të disponojë me materialin procedural.

- 1) Subjekti mund të inicojë procedurën, është veprim plotësisht dispozitiv i subjektit, sepse vetë iniciimi i procedurës varet nga vullneti i tij. Pra është brenda autorizimeve të tij dhe forcës së tij të vullnetit që të inicojë procedurën, përkatësisht të parashtrijë padinë në gjykatë për të inicuar procedurën.
- 2) Subjekti mund të mbajë atë në rrjedhë, që do me thënë se është plotësisht brenda veprimeve të tij dispozitive nëse do të ndërmarrë veprime juridiko – procedurale për të mbajtur procedurën në rrjedhë. Kjo e thënë për shkak se vetë subjekti mundet që

³⁹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq.67

⁴⁰ Po aty

të tërheqë padinë, ose të heqë dorë nga kërkesëpadia dhe në këtë mënyrë procedura të mos rrjedhë më tej.

- 3) Të përcaktojë objektin e procedurës kontestimore, subjekti në padinë e parashtrua gjykatës lirisht mund të përcaktojë se cila marrëdhënie është kontestuese, edhe nëse në realitet ajo marrëdhënie nuk është kontestuese, kjo nuk paraqet pengesë për ta vendosur në padi atë si kontestuese, sepse në fund fare gjykata n.q.s. padia plotëson kushtet formale, me aktgjykim do e vendosë në themel bazueshmërinë e kërkesëpadiës, respektivisht n.q.s. nuk është e bazuar do e refuzojë atë si të pabazuar. Gjithashtu kjo në vetvete përfshin se subjektin mund të përcaktojë edhe vëllimin dhe llojin e mbrojtjes së cilës kërkon.
- 4) Të disponojë me objektin e procedurës, me këtë nënkuptojmë se palët të cilët marrin pjesë në procedurë, munden lirisht të disponojnë me objektin e procedurës. Kjo ngaqë paditësi është i autorizuar që të tërheqë padinë, ose të heqë dorë nga kërkesëpadia. Ndërsa i padituri mundet që gjatë rrjedhës së procedurës të pranojë kërkesën e paditësit, të cilën deri në ato moment e ka kundërshtuar.
- 5) Të disponojë me materialin procedural, palët disponojnë lirisht me materialin procedural, në kuptim që ata vendosin se cilin material procedural do ta shtrojnë para gjykatës.⁴¹ Kështu paditësi që në padi i thekson faktet mbi bazën e të cilave e mbështet kërkesëpadinë e tij, si dhe provat me të cilat i vërteton ato fakte. I padituri mundet që të mohojë kërkesëpadinë dhe të paraqesë prova me të cilat mund të vërtetohet pretendimi i tij.

Megjithatë edhe parimi i dispozitivitetit është i kufizuar deri në njëfarë mase. Kjo situatë merr shprehje atëherë kur dispozicionet e palëve janë në kundërshtim me bazat e sistemit juridik. Këtë situatë shprehimisht e parasheh L.P.K. në nenin 3 paragrafi 3 "gjykata nuk do i lejojë dispozicionet e palëve të cilat janë : 1)në kundërshtim me normat imperative; 2) në

⁴¹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 71

kundërshtim marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën dhe 3) në kundërshtim me moralin.”⁴²

Parimi i oficialitetit. Parimi i oficialitetit nënkupton se gjykata sipas detyrës zyrtare në procedurën e inicuar duhet t’i ndërmarrë veprimet procedurale. Kjo gjë është jashtëzakonisht e kufizuar në këtë L.P.K. Megjithatë gjykata mund të veprojë ex officio vetëm në raste të caktuara me L.P.K. Për t’a ilustruar këtë gjykata mundet përjashtimisht ex officio të përcaktojë ekspertizë, edhe pse palët nuk e kanë kërkuar të njëjtën.

Parimi i shqyrtimit dhe hetimit. Parimi i shqyrtimit dhe i hetimit janë dy qasje tërësisht të ndryshme të cilat i referohen materialit provues. Sipas parimit të shqyrtimit gjykata nuk ka rol aktiv në grumbullimin e materialit provues. Roli për grumbullimin e materialit provues është tek palët, pra barra bie mbi ta për të prezentuar para gjykatës faktet dhe provat me të cilat tentojnë të vertetojnë faktet e pretenduara. Pra në këtë qasje të shprehur në sistem gjykata është pasive. Ky sistem quhet sistemi akuzator.

Parimi i hetimit është diametralisht i kundër me parimin e shqyrtimit. Këtu barra për grumbullimin e materialit provues bie mbi gjykatën. Këtu gjykata ka rol aktiv dhe roli i palëve është shumë i kufizuar, deri në atë pikë sa për të pyetur dëshmitarët apo për të ndërmarrë ndonjë veprim në seancë duhet t’i drejtohen gjykatës për t’a ndërmarrë atë veprim, përjashtimisht me leje të gjykatës t’a ndërmarrin atë veprim në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Ky sistem ka qenë i inkorporuar në L.P.K. Kjo qasje është karakteristike për shtetet absolutiste. I njëjti mban emrin e sistemit inkuizitor.

Parimi i dëgjimit të palëve. Ky parim është ndër parimet më të vjetra të procedurës kontestimore, edhe kjo mund të ilustrohet edhe me shprehje latine “*Audiatur et altera pars*” ndërsa në L.P.K. parashihet në nenin 5 edhe atë: “Gjykata të gjitha palëve do u japë mundësi që të deklarojë për kërkesat dhe pretendimet e palës kundërshtare. Gjykata është e autorizuar

⁴² <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 11.02.2020

që të vendosë për kërkesat ndaj të cilave pala kundërshtare nuk i është dhënë mundësia për tu deklaruar vetëm në rastet të cilat janë përcaktuar me këtë ligj.”⁴³ Gjithashtu nëpërmjet këtij parimi sigurohet kundërshtia e mendimeve dhe qëndrimeve të palëve lidhur me objektin e kontestit, për këtë arsye ky parim emërtohet edhe si parim i kontradiktorialitetit.⁴⁴ Ekzistojnë disa metoda procedurale për realizimin e parimit të dëgjimit të palëve. Megjithatë çfarë duhet të prezumohet nëse njëra palë fare nuk deklarohet? Për këtë teoria por në një mënyrë flitet edhe në legjislacion, edhe janë zhvilluar disa të ashtuquajtura sisteme. Këto sisteme janë: litiskontestacioni afirmativ; litiskontestacioni negativ, qëndrimi i papërcaktuar ndaj joaktivitetit të palëve.

Sistemi i litiskontestacionit afirmativ, në situatën kur i padituri nuk deklarohet prezumon se i padituri me heshtjen e tij i pohon pretendimet e paditësit dhe në këtë mënyrë edhe sillet aktgjykimi në dëm të tij. Pra ai duhet që në mënyrë aktive të mbrohet dhe të heqë dorë nga heshtja që të mos sillet aktgjykim në dëm të tij.

Sistemi i litiskontestacionit negativ, në situatën kur i padituri nuk deklarohet prezumon se i padituri, me vetë heshtjen e tij i mohon pretendimet e paditësit. Sipas këtij sistemi barra bie kryekëput mbi paditësin për t’i provuar pretendimet e tij me anë të provave, ndërsa i padituri mundet që ato t’i mohojë me heshtje.

Sistemi i qëndrimit të papërcaktuar ndaj joaktivitetit të palëve, vlerëson se pala me heshtjen e saj as nuk i pohon as nuk i mohon pretendimet e palës tjetër. Qëndrimi i palës thjeshtë nuk është i ditur, prandaj nuk mund të sillet aktgjykim duke u bazuar vetëm në heshtjen e palës.

Sistemi procedural i R.M.V. nuk ka përqafuar kryekëput asnjërën nga këto qëndrime, megjithatë ka elemente të sistemit të litiskontestacionit afirmativ, edhe kjo mund të shihet në situatën kur palës së cilës i është çuar padia për përgjigje, nuk e ndërmerr atë veprim, pra

⁴³ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 11.02.2020

⁴⁴ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 77

konsiderohet se pala i ka pranuar pretendimet e paditësit dhe me anë të kësaj çështja vendoset në themel.

Tek parimi i dëgjimit të palëve ekzistojnë edhe përjashtime. Pra gjykata nuk është e detyruar t'i dëgjojë të dy palët në rastet të cilat janë shprehimisht të parapara me L.P.K. Këto raste janë: a) pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata sjell vendim lidhur me kompetencën e vet vetëm në bazë të të dhënave në padi; b) në procedurën për zgjidhje në konfliktin të kompetencës; c) kur sjell vendim për urdhërpagesë; ç) kur pa dëgjuar kundërshtarin sjell aktvendim lidhur me masën e përkohëshme; d) kur pa dëgjuar kundërshtarin e propozuesit vendos dhe zhvillon procedurën për sigurimin e provës; dh) kur vendos lidhur me shpenzimet procedurale; e) kur ankesa kundër aktvendimit nuk i dërgohet kundërshtarit të ankuesit; ë) kur faktet relevante janë përgjithësisht të njohura, gjykata, pa mbajtur seancë vendos për kthim në gjendjen e mëparshme.⁴⁵ Shkelja e dispozitave për dëgjimin e palëve është shkelje esenciale e dispozitave të L.P.K.⁴⁶

Parimi i konstatimit të së vërtetës. Ky parim është një parim mjaft i rëndësishëm. Kjo ngaqë gjykata për të sjellë një vendim të drejtë duhet të konstatojë të vërtetën, dhe në asnjë mënyrë të dëmtojë palën e cila ka të drejtë. Gjithashtu me anë të këtij parimi, dhe kur ndodh që të jet cënuar rendi juridik, bëhet sanimi i tij.

Të vërtetën gjykata duhet t'a konstatojë brenda procesit i cili është duke u zhvilluar. Këtë gjë gjykata duhet t'a arrijë duke i shqyrtuar provat e propozuara nga të dy palët. Pasi të shqyrtojë provat gjykata do të konstatojë të vërtetën, por kjo e vërtetë është e vërtetë procedurale, e cila buron nga provat e propozuara për të vërtetuar pretendimet palët përkatëse.

Kur gjykata vendos ajo mund ta konstatojë të vërtetën në tre shkallë, edhe atë t'a konstatojë atë me siguri, me bindje dhe me besueshmëri. Kur gjykata e konstaton të vërtetën me siguri, nuk ka aspak hapësirë për dyshim. Kjo gjë ndodh rrallë. Gjkata mund ta konstatojë

⁴⁵ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 79-80.

⁴⁶ Po aty

të vërtetën me bindje. Me këtë nënkuptohet se ajo ka sjellë një aktgjykim në bazë të provave të cilat kanë krijuar tek gjykata një bindje në lidhje me rrethanat e rastit të cilat nuk janë të dyshimta për njeriun me logjikë të zhvilluar. Ndërsa besueshmëria paraqet mundësi që parafytyrimi të jetë në harmoni me faktet. Kjo është shkalla më e ulët e së vërtetës.

Konstatimi i së vërtetës në procedurë është i kufizuar me anë të afatit. Kjo do me thënë se pala duhet që brenda afatit të caktuar të parashtrojë provat, që të mos zvarritet procedura. Rrjedhimisht me anë të provave mund të vihet deri te konstatimi adekuat i së vërtetës.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar një të vërtetë me anë të aktgjykimit të sjellë. Megjithatë kjo nuk do të thotë se kjo e vërtetë është absolute. Ajo mund t'i nënshtrohet kontrollit nga shkalla e dytë dhe të pësojë ndryshime, ose të vërtetohet.

Parimi i vlerësimit të lirë të provave. Ky parim paraqet një shprehje të avancimit të aftësisë perceptuese dhe mendore të gjykatës. Kjo edhe e manifestuar nga ky parim të cilin ligjdhënësi e ka inkorporuar në legjislacion, prej një kohe goxha të konsiderueshme. Me këtë parim nënkuptohet se gjykata në procedurë provat i vlerëson në mënyrë të lirë dhe sipas bindjes së saj. Në formulimin e aktgjykimit vetë do vendos se në cilat prova do të mbështetet, cilat nga ato janë të besueshme dhe cilat nga ato janë jo kredibile.

Pra nga sa vërejtje vlerësimi i lirë i provave paraqet një sistem në vete në lidhje me vlerësimin e lirë të provave. Pra quhet sistemi i vlerësimit të lirë të provave. Ky sistem është i inkorporuar edhe në L.P.K. të R.M.V.

Për dallim nga sistemi i lirë i vlerësimit të provave, ekziston sistemi legal i vlerësimit të provave. Në vijim do të sjellim atë se si është shprehur Profesor Janevski në lidhje me këtë: "Sipas sistemit të vlerësimit legal të provave, e drejta procedurale i përcakton parakushtet për zgjedhjen, ekzaminimin dhe vlerësimin e fuqisë provuese të mjeteve provuese.⁴⁷ Rregullat ligjore sipas natyrës së çështjeve janë abstrakte dhe gjenerale.⁴⁸ Ato bazohen në rregullat e përvojës së fituar në gjenerata. Në këtë sistem është irrelevant, qëndrimi personal i gjyqtarit.

⁴⁷ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 85

⁴⁸ Po aty

Fuqinë provuese të mjetit të caktuar provues e cakton paraprakisht vetë ligjdhënësi.⁴⁹ Detyra e gjykatës kufizohet në vërtetimin e ekzistimit të prezumimeve procedurale të parapra me ligj për zbatimin e rregullave ligjore lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të caktuara faktike.⁵⁰ Sipas sistemit të vlerësimit legal të provave, gjykata ka të drejtë që të përdorë vetëm mjete provuese, të cilat janë të parashikuara me ligj, sipas rregullës, vetëm ato mjete provuese, të cilat do i ofrojnë palët”.⁵¹

Pra nga sa mund të vërejmë, këto dy sisteme të vlerësimit të provave kanë qasje diametralisht të kundërt me njëri tjetrin. Në botë sot dominon sistemi i vlerësimit të lirë të provave. Sistemi legal paraqet një sistem të cili pothuajse i ka kaluar koha në çdo anë të globit.

Parimi i zhvillimit të gjykimit gojarisht dhe me shkrim. Ky parim është një nga parimet të cilat qeveris seancat të cilat mbahen. Për këtë parim Profesori Brestovci shprehe:” Për komunikimin dhe këmbimin e mendimeve midis njerëzve si dhe midis palëve dhe gjykatës ekzistojnë dy forma: forma orale, kur gjykata palëve dhe palë gjykatës mendimet ia shprehin gojarisht drejtëpërdrejt; forma e shkruar, kur palët kërkesat, propozimet dhe informata e tjera i përpilojnë me shkrim dhe shkresat ia dorëzojnë gjykatë, e kjo gjithashtu të formuara me shkrim ua dërgon palëve letërghirret, urdhëresat e ndryshme si dhe vendime.⁵² Edhe çështja e aprovimit të veprimit në formë të shkruar ose gojarisht është çështje e zgjedhjes së metodës së punës në procedurë.⁵³ I zbatuar në mënyrë të plotë, parimi i oralitetit kërkon që të gjitha veprimet procedurale të kryhen gojarisht dhe që gjykata vendimin mbi objektin e kontestit ta japë vetëm në bazë të rezultatit të shqyrtimit të çështjes juridike të kryer gojarisht.⁵⁴ Veprimet procedurale të kryera me shkrim e kanë vetëm rëndësinë e paralajmërimit se më vonë do të kryhen gojarisht në seancën gjyqësore.⁵⁵ Vetvetiu ato nuk kanë kurrfarë rëndësie procedurale.”⁵⁶

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Po aty

⁵¹ Po aty

⁵² Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 59

⁵³ Po aty

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 59

Megjithatë nga ajo sa u tha më sipër, nuk do me thënë se vetëm veprimet e ndërmarra gojarisht janë të rëndësishme për procedurën. Për këtë mendojmë se veprimet procedurale të ndërmarra gojarisht kanë të bëjnë kryekëput me seancën, pra veprimet juridiko procedurale që ndërmerren në seancë. Ngaqë ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm veprimesh juridiko procedurale të cilat ndërmerren në formë të shkruar siç është përgjigja në padi. Goditja e aktvendimeve dhe aktgjykimit të gjykatës bëhet me shkrim. Pra nqs duam që të tërheqim një vijë, atëherë mund të themi se veprimet e ndërmarra me gojë janë karakteristike për veprimet e ndërmarra në seancë. Ndërsa veprimet juridiko - procedurale të ndërmarra me shkrim janë karakteristike për ato veprime juridike të cilat ndërmerren jashtë seancës. Nuk mundet që e tërë procedura të zhvillohet vetëm në njërën formë. Domosdoshmërishte të ekzistojnë të dy format e ndërmarrjes së veprimeve, për të arritur një shkallë më të lartë të efikasiteti dhe civilizimit gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore.

Parimi i pandërmjetësisë. Parimi i pandërmjetësisë është metodë e punës, respektivisht mënyrë sipas së cilës grumbullohet materiali procedural, me qëllim që të konstatohen faktet juridikisht relevante, si dhe rregull mbi mënyrën e egzaminimit të provave.⁵⁷

Sipas parimit të pandërmjetësisë, është e nevojshme që: a) ndërmjet gjykatës dhe mjeteve provuese, respektivisht burimit të informacioneve të mos ketë ndërmjetësues, respektivisht, gjykata me anë të shqisave të vetë të vërejtë natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese; b) e njëjta gjykatë, e cila kryen perceptimin e materialit procedural (në mënyrë të pandërmjetësuar), e njëjta gjykatë të vendosë edhe për fuqinë provuese të mjeteve provuese; c) ajo gjykatë ta sjellë vendimin menjëherë pas përfundimit të seancës në të cilën është mbledhur materiali procedural.⁵⁸

Megjithatë gjykata jo çdoherë mbështetet në këtë metodë, sepse ekzistojnë mjete provuese për të cilat gjykata nuk ka njohuri të mjaftueshme për t'i kuptuar dhe interpretuar. Në

⁵⁷ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 89

⁵⁸ Po aty

këtë rast vjen në shprehje nevoja për t'u bërë ndërmjetësimi. Si shembull klasik i kësaj është eksperti i cili përpilon dhe interpreton ekspertizën.

Ky parim në L.P.K. merr shprehje në nenin 4 i cili vijon: “Gjykata në parim vendos për kërkesëpadinë në bazë të shqyrtimit gojor, të drejtëpërdrejtë dhe publik.”⁵⁹ Pra nga ky formulim i dispozitës mund të vërehet se cilat metoda janë të përzgjedhura nga ligdhënësi në lidhje me këtë. Megjithatë edhe L.P.K. bën përjashtime nga kjo dispozitë, përjashtime të cilat i kemi theksuar më sipër.

Parimi i publicitetit. Parimi i publicitetit në procedurë paraqet një karakteristikë dalluese në sistemet demokratiko – liberale. Me këtë nënkuptojmë se gjykimet janë publike. Gjithashtu qytetarët mund të kenë qasje në shkresat e procedurës, cilatdo qofshin ato. Mirëpo ekzistojnë edhe përjashtime. Ky parim është i paraparë në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe atë në nenin 102.

Neni 102 i K.R.M. është siç vijon: “shqyrtimi para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit janë publike”.⁶⁰ Pra nga vetë formulimi i dispozitës kushtetuese mund të vërejmë se prej ku buron ky parim. Gjithashtu më hollësishtë ky parim është i rregulluar me aktet juridike adekuate.

Gjithashtu po në këtë nen të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, parashihet edhe përjashtimi i publikut. Në vijim të nenit 102 thuhet: “Publiku mund të përjashtohet në rastet e caktuara me ligj”.⁶¹ Më në hollësi përjashtimi i publikut është i rregulluar me dispozitat e L.P.K.

⁵⁹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur me 12.02.2020

⁶⁰ <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf> qasur më 13.02.2020

⁶¹ Po aty qasur më 13.02.2020

Rastet në të cilat mund të përjashtohet publiku janë të parapara në disa ligje materiale, por në parim, publiku përjashtohet kur shqyrtohen çështjet familjare, të sigurisë shtetërore, të adoptimit, kontestet e atësisë dhe amësisë, kur shqyrtohen fshehtësitë zyrtare ose profesionale dhe kështu me rradhë. Duke u nisur nga nenet 293 dhe 294 të L.P.K. kuptojmë se: “Kolegji mund ta përjashtojë publikun për të gjithë shqyrtimin kryesor ose për një pjesë të tij, nëse atë e kërkojnë interesat e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare, profesionale ose fshehtësisë personale, interesat e rendit publik ose për arsye të moralit.”⁶² Kolegji mundet ta përjashtojë publikun edhe në rast se me masat e ruajtjes së rendit të parapara me këtë ligj, nuk do të ishte e mundur që të sigurohet rrjedhë e pandërprerë e shqyrtimit.⁶³ Neni 294 thekson se: Përjashtimi i publikut nuk i përfshin palët, përfaqësuesit e tyre ligjor, të autorizuarit me prokurë dhe ndërhyrësit.⁶⁴ Ndërsa neni 295 i L.P.K. thekson se: për përjashtimin e publikut vendos kolegji me aktvendim të cilin duhet që ta arsyetojë”.⁶⁵

Parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm. Parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm, është një parim i cili është inkorporuar në L.P.K. për të parandaluar zvarritjet e procedurave. Me këtë ligji ka përcaktuar afate strike për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale, të cilat n.q.s nuk ndërmirren brenda afatit, humbet e drejta për t’i ndërmarrë më pas. Neni 10 i L.P.K. thekson se: “Gjykata është e detyruar që procedurën ta zbatojë pa shtyerje, në afat të arsyeshëm, me sa më pak shpenzime dhe të pamundësojë çdo keqpërdorim të së drejtave të cilat palëve u takojnë në procedurë”.⁶⁶

Me afat të arsyeshëm nënkuptojmë kohën brenda së cilës gjykata duhet të përfundojë në mënyrë të merituar procedurën, me këtë rast, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret, kompleksiteti i saj, sjellja e palëve gjatë zhvillimit të procedurës, rëndësia e objektit të

⁶² <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 13.02.2020

⁶³ Po aty qasur më 13.02.2020

⁶⁴ Po aty qasur më 13.02.2020

⁶⁵ Po aty qasur më 13.02.2020.

⁶⁶ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 13.02.2020.

kontestit për palët, veprimi i gjykatës, përpara së cilës është zhvilluar procedura dhe të ngjajshme.⁶⁷

Parimi i ekonomisë procedurale. Me parimin e ekonomisë procedurale, synohet që të zhvillohet procedurë efikase me sa më pak shpenzime për të arritur mbrojtjen juridike të kërkuar, për pretendimet e ndonjë të drejte të shkelur apo të rrezikuar. Për këtë gjykata duhet që të veprojë në mënyrë të zgjuar që të shmangë shpenzimet të cilat nuk janë të domosdoshme. Për këtë parim Profesori Pozniq shprehet: “ Intenca politiko – juridike që konflikti të zgjidhet me sa më pak shpenzime dhe humbje kohe ka ardhur në shprehje në Ligj përmes një sërë dispozitash, me të cilat gjykata detyrohet që të veprojë në një mënyrë të caktuar apo që nga disa mënyra veprimi të zgjedhë atë më të dobishmen.⁶⁸ Si shembuj të kësaj detyrë mund të përmenden këto rregulla: palëve prezente gjykata gojarisht ua komunikon vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës së ardhshme; dëshmitarët dhe ekspertët gjykata i thërret për në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes para se të jetë dhënë vendimi për marrjen e provave; ngjajshëm me këtë ajo mund t’i detyrojë ekspertët që mendimin e tyre ta paraqesin me shkrim para se të fillojë shqyrtimi kryesor i çështjes juridike, me qëllim që palë të përgatiten për të; prova mund të merret edhe para gjykatës së porositur, në vend se para asaj të çështjes; në vend të seancës për përgatitjen e çështjes, kryetari i trupit gjyqësor e cakton menjëherë seancën për shqyrtimin kryesor të saj, në rast se mendon se e para nuk është e nevojshme”.⁶⁹

Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim të autorizimeve procedurale. Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim të autorizimeve procedurale është paraparë në L.P.K.⁷⁰ Palët dhe ndërhyrësit janë të obliguar që përpara gjykatës të flasin të vërtetën dhe të shfrytëzojnë me mirëbesim të drejtat që u janë njohur me këtë ligj.⁷¹ Është në pyetje standardi juridik nëpërmjet të cili ligji i jep mundësi gjykatës që të vlerësojë se cila sjellje procedurale mund të kualifikohet si sjellje me

⁶⁷ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 96

⁶⁸ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 187

⁶⁹ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 187

⁷⁰ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq.99

⁷¹ Po aty

mirëbesim, dhe cila me keqbesim.⁷² Me këtë rast, ligji i krijon detyrim gjykatës që të pamundësojë çdo keqpërdorim të të drejtave që u takojnë palëve në procedurë.⁷³

Profesori Pozniq thekson se:” Tagri (autorizimi) për kryerjen e veprimeve procedurale i është dhënë palës për mbrojtjen e së drejtës, për të cilën mendon se i është shkelur, ose për mbrojtje nga një pretendim, të cilin e quan të pathemeltë.⁷⁴ Kjo detyrohet që në barrë të vetë t’i marrë mejetet procedurale të sulmit dhe të mbrojtjes në lidhje me veprimin e kryer me pandërgjegje nga kundërshtari.⁷⁵ Në këtë qëllim ajo pëson humbje të kohës, shpenzime dhe mund, pa qenë e sigurtë se do t’i kompensohen, Sidomos nuk është i lejueshëm keqpërdorimi i të drejtave procedurale kundrejt gjykatës, sepse për shkak të një veprimi të tillë angazhohet pa nevojë aktiviteti i saj.”⁷⁶ Në L.P.K. janë paraparë masa preventive por edhe masa ndëshkuese për personat të cilët bëjnë keqpërdorim të autorizimeve të tyre gjatë rrjedhës së procedurës, veprime të cilat janë me qëllime malicioze.

Parimi i koncentrimit të procedurës dhe unitetit të shqyrtimit kryesor. Ky parim merr shprehje në nenin 297 paragrafi 2 i L.P.K. që thekson se :” Kryetari i kolegjit respektivisht gjyqtari individual e ka për detyrë që të kujdeset objekti i kontestit të shqyrtohen në të gjitha anët, por të mos zvarritet procedura për atë shkak, ashtu që shqyrtimi sipas mundësisë të përmbyllet në një seancë.”⁷⁷ Për sa i përket kësaj profesori Janevski thekson: “ që të realizohet kjo detyrë, kryetari i kolegjit gjyqësor me parashtrimin e pyetjeve dhe në mënyra të tjera të përshtatshme kujdeset që gjatë zhvillimit të procedurës të parashtrohen faktet vendimtare, të plotësohen pretendimet jo të plota të palëve me fakte të rëndësishme, të shënohen ose të plotësohen mjetet provuese që kanë të bëjnë me pretendimet e palëve dhe në përgjithësi të jepen të gjitha

⁷² Po aty

⁷³ Po aty

⁷⁴ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 183

⁷⁵ Po aty

⁷⁶ Po aty

⁷⁷ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 13.02.2020

sqarimet e nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike e cila është e rëndësishme, për sjelljen e vendimit”.⁷⁸

Për realizimin e parimit të koncentrimit të procedurës janë në dispozicion dy metoda: a) metoda e rradhës së rreptë ligjore dhe b) metoda e arbitraritetit.

- A) Sipas metodës së rradhës së rreptë ligjore, procedura është e ndarë në një varg stadiumesh, me atë që me ligj është paraparë se cilat veprime mund të ndërmerren në atë stadium të procedurës dhe sipas cilës rradhë.⁷⁹ Palët janë të obliguara që të ndërmarrin të gjitha veprimet procedurale, të cilat janë paraparë për atë stadium të procedurës.⁸⁰
- B) Sipas metodës së arbitraritetit, edhe pse procedura kontestimore është e ndarë në stadione, sipas kësaj metode, me ligj janë përcaktuar vetëm kornizat e përgjithshme, instruktive dhe rradha e shqyrtimit, ku sipas njërës variantë i është lënë gjykatës që në kontestin konkret të kujdeset për koncentrimin e shqyrtimit, ndërkohë që sipas variantës së dytë e cila është më e rrallë, u është lënë palëve që me dispozicionet e tyre të ndikojnë në rradhitjen e ndërmarrjes së aktiviteteve procedurale.⁸¹ Sipas metodës së arbitraritetit, i është lënë gjykatës që sipas vlerësimit të vet, brenda kornizave të stadiumeve të parashikuara me ligj, të përcaktojë atë rradhë procedurale për të cilën konsideron se në rastin konkret është më e përshtatshme për arritjen e qëllimit kryesor dhe kualitetit themlor të mbrojtjes juridike.⁸²

Me unitet të shqyrtimit kryesor nënkuptojmë së shqyrtimi kryesor paraqet tërësi unike procedurale në të cilën vjen deri tek koncentrimi dhe lidhshmëria e të gjitha aktiviteteve

⁷⁸ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 103

⁷⁹ Po aty

⁸⁰ Po aty

⁸¹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 104

⁸² Po aty

procedurale.⁸³ Shqyrtimi kryesor nuk është e thënë të përmbyllet në një seancë, ai mund të zgjasë më tepër seanca, dhe kjo nuk ndikon në prishjen e unitetit të shqyrtimit kryesor.

Parimi i gjuhës në procedurë. Për këtë parim dhe në përgjithësi gjuhën në procedurë do e elaborojmë në kapituj e ardhshëm, për këtë arsye që të mos përsëritemi, në këtë pjesë nuk do e elaborojmë të njëjtën.

6.Subjektet në procedurën kontestimore

Procedura kontestimore paraqet metodën themelore për mbrojtjen e të drejtave subjektive juridiko – civile. Këtu marrin pjesë subjektet të cilat në një mënyrë apo në një tjetër i tangon procesi konkret kontestimore. Është shumë e rrallë që një proces kontestimor të zhvillohet në formën më të thjeshtë të mundur, me pjesëmarrjen e sa më pak subjekteve.

Si subjekte themelore të procesit kontestimore janë gjykata, paditësi dhe i paditur (palët). Megjithatë në procedurë mund të marrin pjesë edhe subjekte të tjera të cilat kanë ndonjë interes juridik të cilin duan që ta ruajnë dhe i kyçen procedurës. Një pjesë tjetër e këtyre subjekteve kyçen që t'i ndihmojnë gjykatës në situatat e domosdoshme apo ato tekniko operative. Në vijim do e elaborojmë gjykatën si subjekt në procedurën kontestimore.

6.1.Gjykata

Gjykata paraqet një nga subjektet themelore të domosdoshme që të ekzistojë procedura kontestimore. Kur flasim për gjykatat në përgjithësi duhet të kemi parasysh se gjykatat paraqesin njërin nga tre pushtetet në shtet. Pushteti gjyqësor. Gjykatat rregullohen me Ligjin për gjykata, i cili në mënyrë të detajuar parasheh organizimin dhe funksionimin e gjykatave. Kuptohet se ky ligj buron dretëpërsëdrejti nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

⁸³ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq.

Sipas nenit 3 të L.GJ. qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor janë: “ zbatimi i paanshëm i së drejtës pavarësisht nga pozita dhe cilësia e palëve; mbrojtja, respektimi dhe avansimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; sigurimi i njëjtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimi në asnjë lloj baze; sigurimin e sigurisë juridike në bazë të sundimit të së drejtës”.⁸⁴ Pra nga vetë formulimi i dispozitës së ligjit derivojmë se cilat janë funksionet dhe qëllimet e gjykatave.

Në vijim të L.GJ. përkatësisht në nenin 4 theksohet se: “Gjykata vendos në procedurë të paraparë me ligj: për të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe interesat e bazuara në ligj; për kontestet në mes qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike; për veprat penale dhe kundërvajtjet; për çështje të tjera të cilat me ligj janë vendosur në kompetencë të gjykatave”.⁸⁵

Për sa i përket organizimit të gjykatave Kushtetuta por edhe Ligji për Gjykatat nuk lejon që për çështjet juridike të cilat duan zgjidhje të vendosin gjykata të cilat nuk janë të rregullta. Prej kësaj mund të themi se sistemi gjyqësor në R.M.V. paraqet sistem tre shkallësh. Në shkallë të parë gjykojnë gjykatat themelore, në shkallë të dytë gjykojnë gjykatat e apelit, dhe në shkallë të tretë gjykon Gjykata Supreme. Duke u nisur nga neni 22 i L.GJ. rrjedh se pushtetin gjyqësor në R.M.V. e ushtron edhe Gjykata Administrative.

Nga sa u tha mund të kuptojmë se në interes të temës së cilën jemi duke e trajtuar janë: gjykatat e kompetencës së përgjithshme, gjykatat e apelit dhe Gjykata Supreme e R.M.V.

Kur flasim për gjykatat dhe vendosjen e tyre për çështjet konkrete duhet të kemi parasysh edhe faktin se a janë kompetente ata gjykata për të vendosur në lidhje me atë çështje. Për të kuptuar se çfarë është kompetenca do citojmë Profesorin Janevski: “Kompetenca mund të definohet në mënyrë të dyfishtë – në kuptimin objektiv dhe në kuptimin subjektiv.”⁸⁶ Në kuptimin objektiv, kompetencë do të thotë rrethi i punëve të organit të caktuar ose ndarja e punëve ndërmjet organeve të caktuara shtetërore në lidhje me shqyrtimin dhe vendosjen për

⁸⁴ http://www.aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_sudovite.pdf qasur më 14.02.2020

⁸⁵ http://www.aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_sudovite.pdf qasur më 14.02.2020

⁸⁶ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 110

punë të caktuara juridike, ose në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale.⁸⁷

Në kuptimin subjektiv, kompetenca është e drejtë dhe detyrë e organit të caktuar shtetëror të veprorë dhe të vendosë në një çështje të caktuar juridike ose të ndërmarrë një veprim të caktuar procedural.”⁸⁸

Kur flasim për kompetencën duhet të kemi parasyshë se edhe këtu ekzistojnë kategorizime të saj. Kategorizimi themelor që bëhet është se a është kompetenca absolute apo relative. Me kompetencë absolute nënkuptojmë :”juridiksion ose lejim i rrugës gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave.”⁸⁹ Ajo definohet si ndarje e punëve ndërmjet gjykatave të vendit dhe organeve ose trupave të tjera shtetërore të vendit nga njëra anë, dhe si ndarje e punëve ndërmjet gjykatave të vendit dhe gjykatave të huaja në anën tjetër.”⁹⁰ Kompetenca absolute ose gjyqësore në kuptimin objektiv përfshin rrethin e punëve të cilat është parapraë që t’i kryejë gjykata për të realizuar funksionin gjyqësor, respektivisht në kuptimin subjektiv ajo është e drejtë dhe detyrë e gjykatës që të zgjidh çështjen e caktuar juridike ose të ndërmerr veprim të caktuar procedural në procedurë.⁹¹

Kompetenca relative emërtohet edhe si kompetencë.⁹² Ajo mundëson që të realizohet kufizimi i rrethit të punëve ndërmjet gjykatave të sistemit gjyqësor të vendit. Në kuadër të kompetencës relative dallohen tre lloje të kompetencës: kompetenca lëndore, vendore dhe funksionale.⁹³

Kompetenca lëndore. Me rregullat për kompetencën lëndore (competentia ratione materiae) caktohet rrethi i punëve të gjykatave të llojeve të ndryshme si dhe ai i gjykatave të rangut të ndryshëm, por të llojit të njëjtë.⁹⁴ Krite për caktimin e kompetencës lëndore janë:

⁸⁷ Po aty

⁸⁸ Po aty

⁸⁹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 111

⁹⁰ Po aty

⁹¹ Po aty

⁹² Po aty

⁹³ Po aty

⁹⁴ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 88

objekti i kontestit (kriteri kauzal, *competentia ratione causae*) dhe vlera e objektit të kontestit (kriteri vlerësor, *competentia rationae valoris*)⁹⁵

Kompetenca vendore (tokësore). Themel i kompetencës tokësore nuk është gjithmonë Ligji.⁹⁶ Palëve u është njohur e drejta që me vullnetin e tyre të influencojnë në kompetencën tokësore. Në raste të caktuara kompetenca tokësore caktohet edhe me vendimin e gjykatës më të lartë.⁹⁷ Me kompetencë tokësore nënkuptojmë se një gjykatë e caktuar në cilin territor i shtrihet e drejta dhe detyra të gjykojë. Kompetenca vendore ndahet në të përgjithshme dhe të veçantë. A) Kompetenca e përgjithshme tokësore udhëzohet nga parimi “Actor sequitur forum rei” që do me thënë se për padinë është kompetente gjykata ku e ka vendbanimin i padituri. B) Kompetenca e posaçme tokësore, kur paditësi inicon procedurë kontestimore në lidhje me një paluajtshmëri, kompetente për të gjykuar çështjen nuk është gjykata ku e ka vendbanimin i padituri, por gjykata ku ndodhet paluajtshmëria, në qoftë se këto dy parametra nuk janë të njëjtë me njëri tjetrin.

Kompetenca funksionale. Sipas Profesorit Janeveski: “rregullat mbi kompetencën funksionale përcaktojnë se cila gjykatë do të jetë kompetente të veprojë si gjykatë e shkallës së parë.⁹⁸ Me këtë realizohet edhe kufizimi i kompetencës së më tepër gjykatave të llojit të njëjtë sa i përket procedimit dhe vendosjes në më tepër çështje të ndryshme juridike.⁹⁹ Me anë të rregullave mbi kompetencën funksionale përcaktohet se cila gjykatë konkrete do të jetë kompetente për të vendosur sipas mjeteve juridike dhe për të vendosur për disa çështje të tjera procedurale, nëse zgjidhja e një çështje të caktuar juridike është në kompetencë e një gjykatë të shkallës së parë.¹⁰⁰ Kështu e përcaktuar, kompetenca funksionale emërtohet edhe si kompetencë instancionale. Nëse njëherë vërtetohet kompetenca lëndore e shkallës së parë e gjykatës së llojit të caktuar, kjo sipas skemës së vërtetuar që më parë tërheqë procedimin nga

⁹⁵ Po aty

⁹⁶ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 122

⁹⁷ Po aty

⁹⁸ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq 116

⁹⁹ Po aty

¹⁰⁰ Po aty

gjykata e caktuar të rangut më të lartë në të njëjtën çështje.¹⁰¹ Kompetenca funksionale, si kompetencë instancionale, çdoherë përcaktohet sipas gjykatës e cila në rastin konkret sipas kompetencës lëndore ka proceduar dhe vendosur në shkallë të parë, pa marrë parasysh se cila gjykatë sipas ligji ka qenë gjykatë e kompetencës lëndore ose vendore për të vendosur në shkallë të parë për bazën e kërkesëpadisë.”¹⁰²

Kur flasim për gjykimin dhe përbërjen e gjykatës duhet të kemi parasyshë se është parim që çështja të gjykohet nga kolegji. Megjithatë në L.P.K. shprehimisht janë përcaktuar edhe rastet kur çështja gjykohet nga gjyqtari individual. Në shkallë të parë çështja do të gjykohet nga gjyqtari individual n.q.s. vlera e kontestit nuk e tejkalon lartësinë e 1.8 milionë denarëve. Gjyqtari individual gjithashtu gjykon çështjet nga kontestet ekonomike të cilat nuk e kalojnë shumën e 1.8 milionë denarëve, gjyqtari individual gjykon edhe në çështjet për pengim posedimi edhe në çështjet për sigurim të provës, dhe në një mori tjetër rastesh të cilat janë paraparë me L.P.K. Megjithatë palët mund të merren vesh që gjykimin e çështjes ta bëjë gjyqtari individual edhe nëse për atë është kompetent kolegji. Në shkallë të dytë të gjitha çështjet shqyrtohen dhe gjykohen në kolegji. Në qoftë se shken rregullat e përbërjes së gjykatës, ato paraqesin shkelje esenciale absolute të dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjyqtari mund të përjashtohet nga gjykimi nëse konstatohet se ai ka interes juridik në atë çështje, nëse është në lidhje gjaku me njërin nga palët, ose është edhe në ndonjë cilësi tjetër në atë proces kontestimor. Kjo gjë është paraparë që të sigurohet gjykim objektiv dhe i drejtë i të gjitha çështjeve të cilat arrijnë në gjykatë për të gjetur zgjidhje. Iniciativa për përjashtimin e gjyqtarit ose gjyqtarit porot mund të ndërmerret nga vetë gjyqtari ose ai porot dhe nga palët.

6.2. Palët procedurale

Procedura kontestimore fillon të ekzistojë me inicimin e saj nga një subjekt i së drejtës. Ky subjekt me parashtrimin e padisë në gjykatë fiton cilësinë e palës, dhe emërtohet si paditës. Personi kundër të cilit është drejtuar padia, paraqet palën tjetër procedurale dhe quhet i

¹⁰¹ Po aty

¹⁰² Po aty

paditur. E gjithë procedura zhvillohet që të zgjidhet kërkesa e pretenduar e paditësit e cila kontestohet nga i padituri. Në këtë situatë siç mund të vërejmë ekzistojnë dy subjekte të cilët kanë interesa të kundërta dhe po ashtu qëndrime diametralisht të kundërta.

Ekzistojnë disa teori për të përkufizuar se çfarë është pala, edhe atë teoria juridiko materiale; teoria procedurale dhe teoria funksionale. Sipas teorisë materiale, palë janë subjektet të cilat janë në një marrëdhënie juridiko materiale, nga e cila ka dalë një kontest dhe i cili duhet të zgjidhet nga gjykata. Sipas teorisë procedurale nocioni palë është nocion i veçantë juridik. Sipas kësaj teorie: “nocioni palë është nocion i posaçëm juridik dhe juridiko – procedural, i pavarur nga marrëdhënia juridiko – materiale nga e cila ka dalur kontesti, dhe i cili është shkak për zhvillimin e procedurës.”¹⁰³ Mjafton që një subjekt në padi të jetë shënuar si paditës, ndërsa tjetri si i paditur që të fitohet cilësia e palës në procedurë.”¹⁰⁴ Pra sipas kësaj teorie është irrelevante se a ekziston marrëdhënia juridiko – materiale nga e cila mund të burojë kontesti. Sipas teorisë funksionale palë është një subjekt i autorizuar kur parashtron padinë në emër të vet por për interes të një tjetri.

Më sipër folëm për fitimin e cilësisë së palës por lam pa përmendur se cilësia e palës mund të fitohet edhe me ndërhyrje por edhe me suksesion, qoftë ai univerzal apo singular. Palët në procedurë janë të barabarta dhe asnjëra nga këto nuk është e favorizuar në procedurë. Prandaj janë mundësitë e barabarta për të dy palët për të vërtetuar pretendimet e tyre, duke parashtruar provat për të vërtetuar faktet e pretenduara.

Kur jemi tek palët, një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm për pjesëmarrjen e tyre në procedurë janë edhe prezumimet procedurale për sa i përket palëve. Ne më përpara në këtë punim i kemi trajtuar prezumimet procedurale, dhe si një grup i prezumimeve procedurale, përmendëm edhe prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me palët. Në këtë pjesë të këtij punimi do i elaborojmë më hollësisht të njëjtat. Si prezumime procedurale për palët mund të përmendim: zotësinë për të qenë palë, zotësinë procedurale, zotësinë postulative, legjitimimin

¹⁰³ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 150

¹⁰⁴ По ату

procedurale dhe legjitimimin real. Në vazhdim do i trajtojmë një nga një këto prezumime të cilat i përmendëm.

Zotësia për të qenë palë. Me zotësinë për të qenë palë nënkuptojmë zotësinë e palës për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve të cilat burojnë nga procedura. Profesori Pozniq për këtë çështje shprehet se: “Paditësi ose i padituri në procedurën kontestimore mund të jetë kushdo që ka zotësinë për të qenë titullar i të drejtave dhe detyrimeve sipas së drejtës civile.”¹⁰⁵ Zotësia për të qenë palë ndërgjyqëse, pra, zakonisht i përgjigjet nocionit të zotësisë juridike, prandaj ai mund të jetë palë ndërgjyqëse.”¹⁰⁶ Për sa i përket veçanërishtë personave fizik dhe juridik ai shprehet: “A) çdo person fizik, pa marrë parasysh moshën, zotësinë për të vepruar dhe shtetësinë.”¹⁰⁷ Paditës apo i paditur mund të jetë edhe embrioni, në rast se është fjala për mbrojtjen e interesave të tij¹⁰⁸; B) Çdo person juridik.”

Në rast se vërehet se palës e cila merr pjesë në procedurë i mungon zotësia për të qenë palë, atëherë gjykata e hedh poshtë padinë. Të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra deri atëherë konsiderohen të pavlefshme.

Zotësia procedurale. Me zotësi procedurale nënkuptojë cilësinë që pala personalisht në mënyrë të pavarur dhe të vlefshme të ndërmarrë veprime procedurale, dhe të mundet që t’i realizojë të drejtat dhe të bartë detyrimet në mënyrë të pavarur gjatë rrjedhës së procedurës. Kjo zotësi korrespondon me zotësinë juridike. Sipas profesorit Brestovci: “Zotësia procedurale është cilësi e palës ndërgjyqëse që personalisht dhe vleftësisht të kryejë veprime procedurale në procesion kontestimor.”¹⁰⁹ Zotësia procedurale e palës mund të jetë vetëm e plotë dhe e pakufizuar.¹¹⁰ Pala e cila ka zotësi mund t’i kryejë të gjitha veprimet procedurale në gjykimin në të cilin vendoset për të drejtën apo detyrimin e saj”.¹¹¹ Pala e cila nuk ka zotësi procedurale

¹⁰⁵ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 150

¹⁰⁶ Po aty

¹⁰⁷ Po aty

¹⁰⁸ Po aty

¹⁰⁹ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 126

¹¹⁰ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 127

¹¹¹ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 127

mundet që në procedurë të jetë e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor ose nga përfaqësuesi me prokurë.

Zotësia postulative. Zotësia postulative paraqet cilësinë e palës me zotësi procedurale që në mënyrë të drejtëpërdrejtë pa ndërmjetësim të çfarëdo lloji të ndërmarrë veprime procedurale. Zotësia postulative është në raport të ngushtë me zotësinë procedurale. Sipas profesorit Janevski: “Zotësia postulative, çdoherë presupozon ekzistimin e zotësisë procedurale të palës. Mungesa e zotësisë postulative, ndërkaq nuk do të thotë se pala nuk ka zotësi procedurale. Kështu i huaji i cili nuk e njeh gjuhën zyrtare në të cilën zhvillohet procedura përpara gjykatës, nuk ka zotësi postulative, nuk mund të ndërmerr asnjë veprim procedural, mirëpo kjo nuk do të thotë se ai nuk ka zotësi procedurale, përkundrazi ai ka zotësi procedurale, ka mundësi të autorizojë përfaqësues, ndërsa deklaratat që duhet t’i japë personalisht mund t’i jep nëpërmjet përkthyesit”.¹¹² Palët të cilat nuk kanë zotësi postulative janë ato palë të cilat mund të kenë ndonjë të metë fizike apo mungesë njohurie kjo në aspekt të njohjes së gjuhës në të cilën zhvillohet procedura. Pra të gjitha mungesat që çojnë në pamundësimin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale personalisht edhe pse pala ka zotësi procedurale, paraqesin shkaqe për mungesë të zotësisë postulative.

Legjitimimi real. Nga zotësia për të qenë palë dhe nga zotësia procedurale, duhet dalluar qartas legjitimimi real (legitimatō ad causam).¹¹³ Me këtë term në shkencë dhe në praktikën gjyqësore tregohet raporti subjektiv i palëve ndaj së drejtës për mbrojtjen e së cilës është vënë në veprim procedimi kontestimor.¹¹⁴ Pala është e legjitimuar realisht në qoftë se është pjesëmarrëse e raportit materialo – juridik nga i cili ka rrjedhur padia.¹¹⁵ Paditësi është i legjitimuar (aktivisht) në qoftë se në raportin e tillë ka pozitën e anës kreditore, kur të paditurit i takon legjitimimi (pasiv) në rast se i është ngarkuar detyrimi përkatës.

Legjitimimi procedural. Personat, të cilët marrin pjesë si palë në procedurë, përveç zotësisë për të qenë palë dhe zotësisë procedurale, e në disa raste edhe zotësisë postulative,

¹¹² Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 174 - 175

¹¹³ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 155

¹¹⁴ Po aty

¹¹⁵ Po aty

duhet të kenë patjetër edhe autorizim për zhvillimin e procesit kontestimor konkret – legjitimim procedural (legitimatio ad processum).¹¹⁶ Legjitimimi procedural është shprehje e marrëdhënies juridike konkrete të palës ndaj objektit të kontestit konkret.¹¹⁷ Për vërtetimin e ekzistimit të legjitimitetit procedural, e drejta procedurale udhëzon në të drejtën materiale.¹¹⁸ Ekzistimi i legjitimitetit procedural do të thotë se palët në kontest janë palë të “vërteta”, se kanë interes juridik, nevojë për mbrojtje juridike për zhvillimin e procedurës konkrete, e cila është e determinuar subjektivisht – me ekzistimin e palëve të caktuara, dhe objektivisht – me ekzistimin e kërkesëpadisë së caktuar.¹¹⁹ Duke provuar se ka legjitimim procedural, paditësi është i obliguar që përpara se të lëshohet në shqyrtimin meritor lidhur me objektin e kontestit ta bëjë të besueshëm autorizimin për iniciimin e procedurës konkrete në raport me të paditurin konkret, duke pasur parasysh padinë konkrete.¹²⁰

Legjitimimi procedural mund të jetë aktiv dhe pasiv. Personat të cilët kanë legjitimim procedural atë cilësi e derivojnë nga norma juridike e cila u jep të drejtë të kërkojnë mbrojtje juridike, dhe interesi i tyre juridik supozohet ex lege të cilin nuk duhet që ta dëshmojnë dhe në bazë të interesit juridik të provuar.

Për të mos e lënë pa përmendur si palë në procedurë ekzistojnë edhe bashkëndërgjyqësit. Me bashkëndërgjyqësi nënkuptojmë situatën kur më tepër subjekte kërkojnë mbrojtje juridike nga një subjekt, ose një subjekt kërkon ndihmë nga një subjekt, ose më tepër subjekte kërkojnë mbrojtje ndaj më tepër subjekteve në një procedurë. Bashkëndërgjyqësia është e paraparë në L.P.K. në nenin 186 i cili thekson: “më tepër persona mundet që me një padi të padisin, respektivisht të jenë të paditur (bashkëndërgjyqës) nëse: 1) për sa i përket të objekt së kontestit janë në bashkësi juridike ose nëse të drejtat e tyre respektivisht detyrime burojnë nga baza e njëjtë juridike apo faktike; 2) objekt i kontestit janë kërkesa respektivisht detyrime të llojit të njëjtë të cilat janë të bazuara në bazë qënësore

¹¹⁶ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 176

¹¹⁷ Po aty

¹¹⁸ Po aty

¹¹⁹ Po aty

¹²⁰ Po aty

faktike apo juridike të llojit të njëjtë, dhe nëse ekziston kompetenca lëndore dhe vendore e gjykatës së njëjtë për çdo kërkesë dhe për çdo të paditur dhe 3) ajo është e paraparë me ligj tjetër.¹²¹ Në vijim në paragrafin 2 të nenit të njëjtë theksohet: deri në mbylljen e shqyrtimit kryesor, nën kushtet e paragrafi 1 të këtij neni, krahas paditësit mund të paraqitet paditës i ri ose padia të zgjerohet në një të paditur tjetër me pëlqimin e tij. Paragrafi 3: personi i cili i bashkangjitet paditësit respektivisht ndaj personit të cili padia zgjerohet duhet që procesin kontestimor ta pranojë në atë gjendje në të cilën ajo ndodhet kur ai i bashkangjitet”.¹²²

Neni 187 në lidhje me këtë çështje thekson: “paditësi mundet në padi të përfshijë dy apo më shumë të paditur dhe të kërkojë që kërkesëpadia të miratohet ndaj të paditurit të ardhshëm, në rast se në formë të prerë refuzohet ndaj të paditurit i cili është i emërtuar para tij në padi”.¹²³ Pra n.q.s ekzistojnë dy ose më shumë të paditur, dhe gjykata e refuzon kërkesëpadinë ndaj të paditurit të parë në formë të prerë, paditësi kërkon që ndaj personit i cili vjen në rradhë pas të paditurit të parë gjykata të njëjtën kërkesëpadi ta miratojë.

Paditësi mundet që në padi të përfshijë dy apo më tepër të paditur, vetëm nëse ndaj çdonjërit prej tyre parashtrohet kërkesë të njëjtë ose prej ndonjërit prej tyre parashtrohet kërkesa të ndryshme të cilat janë në lidhje me njëra tjetrën dhe nëse gjykata e njëjtë ka kompetencë lëndore dhe vendore për çdo kërkesë.¹²⁴

6.3. Personat e tretë në procedurë

Që të zhvillohet në mënyrë të rregullt një proces kontestimor është e nevojshme që të ekzistojnë paditësi dhe i padituri. Gjatë zhvillimit të procesit të dy palët do i parashtrojnë argumentet dhe provat e tyre për të vërtetuar pretendimet e tyre. Megjithatë jo çdoherë një proces mund të jetë kaq i thjeshtë. Në një numër të konsiderueshëm rastesh ekziston nevoja që

¹²¹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> paragrafi 1, qasur më 14.02.2020.

¹²² <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> paragrafi 2, qasur më 14.02.2020

¹²³ Po aty

¹²⁴ Po aty

edhe personat e tretë të marrin pjesë në procesin konkret kontestimor. Kjo për shkak se ato subjekte kanë interes juridik që të marrin pjesë në të njëjtin. Megjithatë ato nuk kanë cilësinë e palës. Si lloje të pjesëmarrjes së personave të tretë në procedurë sipas L.P.K. janë: ndërhyrësi, informimi i personit të tretë për gjykim dhe emërimi i paraardhësit juridik. Në vijim do i shqyrtojmë me rradhë të tre këto institute juridike.

Ndërhyrja. Me ndërhyrje nënkuptojmë situatën kur një person i tretë, interesi juridik i të cilit tangohet në procedurën konkrete, i bashkangjitet njëres nga palët për ta ndihmuar në realizimin e interesit të tij juridik. Kjo gjë është e paraparë edhe me L.P.K. në nenin 194, ku theksohet se: “personi i cili ka interes juridik në procesin kontestimor i cili është duke rrjedhur në mes personave të tjerë, që njëra palë të ketë sukses mund t’i bashkangjitet asaj pale”.¹²⁵ Nga kjo nxjerrim edhe përkufizimin ligjor të ndërhyrësit.

Megjithatë, cilat janë qëllimet për të cilat mund të ndërhyjë i treti në proces? Këto janë dy qëllime, i pari që të ndihmojë palën për të pasur sukses, dhe i dyti, që të kontrollojë sjelljen procedurale të palës së cilës i është bashkangjitur. Veprimet juridiko – procedurale të ndërhyrësit janë të vlefshme. Kjo me kusht që ato veprime të mos bien ndesh me veprimet e palës. Në qoftë se ndërmerr të tilla veprime pala ato veprime mund t’i quajë si të pavlefshme (ndërhyrësi i zakonshëm).

Ekzistojnë dy lloje të ndërhyrësit, ndërhyrësi i zakonshëm dhe ndërhyrësi në pozitën e bashkëndërgjyqësit unik. Nëse ndërhyrësi ka pozitën e ndërhyrësit të zakonshëm, atëherë aktgjykimi nuk godet drejtëpërdrejtë interesat e tij, por vepron ndaj palëve. Megjithatë ekziston në teorinë procedurale një konstrukt teorik, i cili quhet efekti intervenues i aktgjykimit.

Sipas Profesorit Janevski: “efekti intervenues i aktgjykimit, manifestohet në procedurën e re, në të cilën marrëdhëniet e tyre të ndërsjella do t’i rregullojnë ndërhyrësi (në procedurën e re, sipas rregullës, i paditur) dhe pala së cilës ai i është bashkangjitur (në procedurën e re, sipas

¹²⁵ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 17.02.2020

rregullës paditës).¹²⁶ Kur pala së cilës i është bashkangjitur ndërhyrësi, do ta humbasë procesin dhe më vonë do të inicojë procedurë kundër ndërhyrësit, në procedurën e re, aktgjykimi që është sjellë më herët, kundrejt ndërhyrësit ka të ashtuquajturin efekt intervenues.¹²⁷ Esenca e efektit intervenues të aktgjykimit në raport me ndërhyrësin përbëhet nga ajo se në procedurën e re, ndërhyrësi nuk ka mundësi të paraqesë prapësim se në procedurën e mëparshme nuk është gjykuar drejt”.¹²⁸

Neni 197 paragrafi 1 në lidhje me ndërhyrësin në pozitën e bashkëndërgjyqësit unik thekson: “nëse efekti juridik i aktgjykimit duhet t’i përkasë edhe ndërhyrësit, atëherë ai në procedurë ka pozitën e bashkëndërgjyqësit unik”.¹²⁹ Për ta ilustruar me shembull: “e tillë është për shembull situata procedurale e kreditorit, i cili në cilësinë e ndërhyrësit i bashkohet të paditurit në gjykimin për vërtetimin se ekziston kërkesa e kontestuar në procedurën falimentuese. Pasi ndodhet në pozitën e bashkëndërgjyqësit, veprimet e tij prodhojnë efekt sikur të ishin të palës.¹³⁰ Kjo do të thotë se ndërhyrësi i këtillë, pavarësisht nga pala, së cilës i bashkohet, madje edhe kundër vullnetit të saj, mund të kryejë veprime procedurale, me qëllim që të pengojë dhënien e vendimit të disfavorshëm.¹³¹ Aktgjykimi ndaj ndërhyrësit me pozitë të bashkëndërgjyqësit unik vepron në mënyrë të drejtëpërdrejtë për dy shkaqe edhe atë: sepse ashtu e parasheh ligji dhe sepse ajo del nga vetë natyra e marrëdhënies juridike.

Do e lemë me kaq elaborimin e ndërhyrësve, edhe pse ka shumëçka për tu elaboruar, kjo për shkak të interesit të punimit të cilin jemi duke e përpiluar. Në vijim do elaborojmë institutin e lajmërimit të personit të tretë për procesin kontestimor.

Lajmërimi i personit të tretë për procesin kontestimor. Lajmërimi mbi gjykimin është veprim, me të cilin njëra nga palë e bën më dije personin e tretë se ndodhet në zhvillim e sipër

¹²⁶ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 194

¹²⁷ Po aty

¹²⁸ Po aty

¹²⁹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 17.02.2020

¹³⁰ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 426-427

¹³¹ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 427.

gjykimi.¹³² Veprimin e tillë ajo e kryen: 1) me qëllim që personi i tretë t'i bashkohet si ndërhyrës apo 2) me qëllim që personi i tretë të hyjë në gjykim në vend të saj.¹³³ Interes juridik për lajmërimin e personit të tretë lidhur me procedurën, mund të ketë edhe paditësi edhe i padituri varësisht nga fakti se cili prej tyre ndodhet në ndonjë marrëdhënie juridiko – materiale me personin e tretë.¹³⁴

Lajmërimi i personit të tretë lidhur me procedurën që është duke u zhvilluar bëhet ose me ndërmjetësimin e gjykatës ose nëpërmjet saj. Qëllimi i këtij veprimi juridik konkretisht mund të ilustrohet me shembullin se personi i cili lajmërohet mund t'i lindë e drejta e regresit ose e drejta e shpërblimit të dëmit. Efekti juridiko – material i lajmërimit të personit të tretë për procedurën manifestohet si ndërprerje e parashkrimit, dhe si mundësi që të paraqiten kërkesa juridiko – materiale.¹³⁵ Efekti juridiko – procedural i lajmërimit të personit të tretë për zhvillimin e procedurës manifestohet në procedurën e ardhshme eventuale, në të cilën marrëdhëniet e tyre do t'i rregullojnë personi i tretë dhe pala që ka kryer lajmërimin.¹³⁶

Emërimi i paraardhësit. Personi i cili është paditur si mbajtës i ndonjë sendi apo përdorues i ndonjë të drejte, i cili pretendon se sendin e mban apo të drejtën e ushtron në emër të personit të tretë, më së voni deri më seancën përgatitore, ndërsa nëse ajo nuk mbahet, atëherë në shqyrtimin kryesor, përpara se të lëshohet në shqyrtim të çështjes kryesore, ta thërrisë përmes gjykatës atë person të tretë (paraardhës), që në vend të tij të merr cilësinë e palës në proces.¹³⁷ Si shembull ilustrues në këtë rast mund të paraqitet qeraxhiu i cili paditet në lidhje me paluajtshëmrinë të cilën e ka me qera, ai në këtë rast mund ta emërojë si paraardhës pronarin.

6.4. Përfaqësuesit e palëve

¹³² B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 427

¹³³ Po aty

¹³⁴ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 196

¹³⁵ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 197

¹³⁶ Po aty

¹³⁷ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 17.02.2020

Si në pothuajse shumicën e marrëdhënieve edhe raporteve juridike, edhe në procedurë, palët mund të kenë përfaqësues. Me përfaqësim nënkuptojmë situatën kur një person në emër dhe për llogari të personit të tretë ndërmerr veprime të caktuara juridike. Edhe në procedurë vlen e njëjta gjë. Përfaqësimi në procedurë ndonjëherë është edhe i detyrueshëm.

Ekzistojnë disa lloje të përfaqësimit duke u nisur nga kritere të ndryshme. Por më së shpeshti përfaqësimi kategorizohet në: përfaqësim ligjor, përfaqësimi i personave juridik në bazë të statutit, ligjit apo kontratës, përfaqësimi vullnetar dhe i kontraktuar. Për këto do të flasim më poshtë. Megjithatë për se ekziston nevoja që palët të cilat marrin pjesë në procedurë të përfaqësohen?

Për tu përgjigjur në këtë pyetje duhet të kemi parasysh se ekzistojnë një mori shkaqesh. Për personat fizik këto shkaqe lidhen me zotësinë për të vepruar, përkatësisht me zotësinë procedurale. Ndërsa disa shkaqe kanë të bëjnë edhe me paaftësinë e palës të t'u shprehur dhe të ndërmarrë veprime procedurale si pasojë e ndonjë të mete, por që nuk i referohet pengimit për të pasur zotësi për të vepruar përkatësisht procedurale. Në këtë rast pala nuk ka zotësi postulative. Shkaqe të tjera që çojnë deri tek përfaqësimi i personave fizik në procedurë, janë vetë dispozitat e L.P.K. të cilat e parashohin një gjë të tillë. Nga këto dispozita mund të derivohet se në qoftë se bëhet fjalë për një objekt kontesti i cili kalon kufirin ligjor, atëherë detyrimisht pala duhet të jetë e përfaqësuar nga një profesionist (avokat). Ka edhe një numër të gjerë shkaqesh pse mund të vijë deri tek përfaqësimi.

Për sa u përket personave juridik, duhet të kemi parasysh se janë konstrukt artificial i cili nuk ka ndërgjegje, megjithatë për të realizuar në mënyrë më efektive raportet juridike, ligji u'a njeht cilësinë e subjekteve të së drejtës këtyre konstrukteve artificiale. Këto, pra personat juridik duke mos qenë të aftë që personalisht, pa ndërmjetësimin e njerëzve, të ndërmarrin veprime juridike, domosdoshmërisht duhet që ato t'i ndërmarrin me anë të përfaqësuesve. Siç e thamë ato veprime ndërmirren në emër dhe për interes të tyre nga përfaqësuesit e tyre.

Përfaqësuesi ligjor. Përfaqësuesi ligjor është përfaqësues i palës pa zotësi procedurale, i cili në emër dhe për llogari të palës ndërmerr veprime procedurale të plotëfuqishme. Palë pa zotësi procedurale janë të gjithë subjektet të cilët nuk kanë zotësi veprimi, ose e njëjta u është hequr. Më konkretisht si palë pa zotësi procedurale janë të miturit, dhe personat e moshës madhore, të cilëve u është marrë zotësia për të vepruar me vendim gjykate. Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor mund të paraqiten: prindërit, adoptuesi, kujdestari, qendra për punë sociale, likuiduesit e personave juridik dhe përfaqësuesit e përkohshëm dhe përfaqësuesit për pranimin e shkresave.

Këto subjekte të cilët u përmendën, të gjithë autorizimin për të përfaqësuar e derivojnë nga ligji. Nëse marrin rastin e parë, prindërit, këtë autorizim e derivojnë nga Ligji mbi familjen. Adoptuesi autorizimin për të qënë përfaqësues i të miturit të adoptuar e derivon gjithashtu nga Ligji mbi familjen. Kur flasim për kujdestarinë, kujdestari është përfaqësues i të miturve pa kujdes prindëror dhe personave të rritur të cilët janë zhveshur nga zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor, edhe këto e derivojnë autorizimin për përfaqësim nga ligjet materiale. Qendra për punë sociale po ashtu autorizimin për përfaqësim të personave nën kujdestarinë e saj e derivon nga L.F. pra që është ligj material etj.

Përfaqësuesi ligjor, siç e theksuam edhe më sipër, mund të ndërmerr veprime në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, pa ndonjë autorizim të caktuar me shkrim, sepse autorizimi i tij buron nga ligji. Ai është i detyruar që në procedurë të dëshmojë me provë se është përfaqësues ligjor i palës. Përgjatimisht sipas Profesorit Janevski: "nëse për parashtrimin ose tërheqjen e padisë, për pohimin, respektivisht heqjen dorë nga kërkesëpadia, për lidhjen e pajtimin ose për ndërmarrjen e veprimeve të tjera procedurale, në dispozita të veçanta është përcaktuar se përfaqësuesi duhet të ketë autorizim të veçantë, ai ka mundësi që t'i ndërmerr ato veprime vetëm nëse ka autorizim të tillë".¹³⁸

Përfaqësuesi i përkohshëm paraqet një institut juridik i cili merr shprehje përgjatimisht. Kjo ngaqë personat të cilët autorizimin për përfaqësim e derivojnë nga ligji, janë

¹³⁸ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 203-204

të përcaktuar nga vetë ligji, ose ,mund të caktohen me diskrecionin e organit kompetent (qendra për punë sociale, kujdestari). Prandaj përfaqësuesi i përkohshëm paraqet përjashtim sepse, ai caktohet vetëm kur mungon ekzistimi i përfaqësuesit ligjor të palës në procedurë, dhe do të ishte zvarritëse për procedurën dhe e dëmshme për palët nëse nuk do të caktohej përfaqësues i përkohshëm dhe pritej që të zgjidhej çështja se kush duhet të jetë përfaqësues ligjor. Neni 76 parag 1 thekson: “nëse në rrjedhën e gjykimit të gjykatës së shkallës së parë, vërehet se procedura e rregullt për përcaktimin e përfaqësuesit ligjor të të paditurit do të zgjaste shumë, dhe për shkak të saj, njëres apo të dy palëve mund t’u paraqiten pasoja të dëmshme, gjykata do t’i përcaktojë përfaqësues të përkohshëm”.¹³⁹ Në vijim të këtij neni përcaktohen edhe rrethanat në të cilat mund të përcaktohet përfaqësues i përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm (ligjor) për pranimin e shkresave, paraqet një lloj të përfaqësuesit ligjor. Ky për dallim nga përfaqësuesi i përkohshëm nuk ndërmerr veprime procedurale. Ky vetëm pranon shkresat të cilat vijnë në adresë dhe llogari të të përfaqësuarit. Përfaqësues i përkohshëm për pranimin e shkresave mund të caktohet në rast se personi të cili i është përcaktuar ky përfaqësues është jashtë vendit, ose nuk i dihet vendbanimi/qëndrimi. Gjithashtu përfaqësues i përkohshëm për pranimin e shkresave mund t’u caktohet edhe nëse më tepër persona padisin bashkarisht (bashkëndërgjyqësit aktiv), ndërsa nuk kanë përfaqësues ligjor të përbashkët, respektivisht përfaqësues me prokurë, gjykata mund t’i thërrasë që brenda afatit të caktuar të emërojnë përfaqësues të përbashkët për pranimin e shkresave.¹⁴⁰ Njëkohësisht, gjykata do t’i lajmërojë paditësit- bashkëndërgjyqës, se cilin prej tyre do ta konsiderojë si përfaqësues të përbashkët për pranimin e shkresave, nëse vetë ata brenda afatit të caktuar nuk emërojnë përfaqësues të tillë me prokurë.¹⁴¹

Përfaqësimi i personave juridik në bazë të statutit, kontratës ose të liqjit. Personat juridik janë krijesa artificiale të tre ose më tepër njerëzve për të kryer veprime të caktuara në mënyrë më efikase duke qenë të pajisur me të drejtën për të ushtruar autorizimet që burojnë nga ato të

¹³⁹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 19.02.2020

¹⁴⁰ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq 206

¹⁴¹ Po aty

drejta dhe për të bartur detyrimet të cilat burojnë nga të njëjtat. Siç edhe kemi thënë ligji këtyre u'a njeh subjektivitetin juridik, rrjedhimisht ato janë të pajisur me zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar. Megjithatë duke qenë krijesa artificiale ushtrimi i veprimeve u mbetet personave fizik, të cilët në një bazë të caktuar janë pjesë e këtyre krijesave. Edhe në procedurë zotësinë e veprimit personat juridik e realizojnë nëpërmjet personave fizik. Këto persona janë të autorizuar në bazë të aktit themelues të organit që të ndërmarrin veprime në emër dhe për llogari të personit juridik. Nga kjo kuptojmë se të drejtën për të përfaqësuar e derivojnë nga vetë akti themelues i personit juridik i cili mund të jetë në formë të statutit, të kontratë apo të ligjit.

Kur flasim për shoqëritë tregtare, duhet të kemi parasyshë se esenciale për të përcaktuar se kush e përfaqëson shoqërinë tregtare në qarkullimin juridik, por edhe në procedurë, është forma e organizimit të saj. Pra nëse shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri tregtare publike, personi i autorizuar me kontratën e themelimit të shoqërisë është bashkëpjesëmarrësi, ose bashkëpjesëmarrësit, nëse më tepër janë të autorizuar për t'a përfaqësuar këtë shoqëri tregtare. Nëse shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri komandite, personi i cili është i autorizuar për t'a përfaqësuar këtë shoqëri në qarkullimin juridik por edhe në procedurë është komplementari. Kur flasim për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar ose ndryshe shprehur Sh.P.K. personi i autorizuar për të përfaqësuar këtë shoqëri tregtare është administratori. Shoqërinë aksionare në qarkullimin juridik përfaqësuesi varet nga forma e organizimit të Sh.A. N.q.s ajo është njëshkallëshe atëherë këtë funksion e kryejnë anëtarët ekzekutiv. Nëse është dyshkallëshe atëherë këtë funksion e kryejnë anëtarët e këshillit administrativ, nëse me statut nuk është paraparë diçka tjetër.

Për sa i përket institucioneve publike do të numërojmë disa nga to për të dhënë një pasqyrë se kush i përfaqëson. Tek ndërmarrja publike përfaqësues është drejtori i ndërmarrjes; tek institucionet përfaqësues është drejtori i institucionit; tek shoqatat dhe fondacionet përfaqësues i tyre është personi i caktuar me statut të shoqatës apo fondacionit; tek partitë politike përfaqësues është kryetari apo personi i përcaktuar me statut; përfaqësues i njësisë së

vetëadministrimit lokal është kryetari i komunës; përfaqësues të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të saj është avokati shtetëror i R.M.V.

Përfaqësuesit me prokurë. Kur flasim për përfaqësimin me prokurë duhet të sqarojmë njëherë se çfarë paraqet prokura. Prokura paraqet akt të shprehjes së vullnetit të të përfaqësuarit të një person tjetër t'a përfaqësojë atë në procedurën gjyqësore dhe jo vetëm. Prokura mund në shumicën e rasteve është e shkruar. Pra nga sa mund të shohim përfaqësimi me prokurë paraqet ndërmarrjen e veprimeve nga një i tretë si pasojë e vullnetit të të përfaqësuarit që ky person i tretë, të ndërmarrë veprime juridike të plotëfuqishme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Si përfaqësues me prokurë në procedurën kontestimore rrethi i personave të cilët mund të pajisen me këtë akt është deri diku i kufizuar. Si persona të cilët mund të përfaqësojnë me prokurë janë avokatët, juristët pa provim të dhënë të judikaturës (nëse vlera e kontestit nuk kalon lartësinë e 1 milion denarëve), juristët të cilët janë të punësuar tek personi juridik pa provim të dhënë të judikaturës (nëse vlera e kontestit nuk kalon 1 milionë denarë) dhe personat e familjes më të ngushtë.

Vëllimin e prokurës, i përfaqësuari mund ta përcaktojë sipas diskrecionit të vullnetit të tij. Prokura si akt i vullnetit mund të jetë e për të gjitha veprimet procedurale ose prokurë për një veprim procedural, edhe pse ekzistojnë edhe klasifikime të tjera të prokurave, nuk do i shqyrtojmë të gjitha një e nga një. Me prokurë për të gjitha veprimet procedurale personi i autorizuar mund të ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat bien në rrethveprimin e punëve dhe veprimeve juridike të cilat mund të ndërmerren në procedurë, përkatësisht të veprimeve të përgjithshme në procedurë. Me prokurë për një veprim procedural nënkuptojmë se i autorizuari mund të ndërmarrë vetëm atë veprim për të cilat është i autorizuar sipas prokurës.

Personi i autorizuar me prokurë mund t'a bartë atë. Në këtë situatë merr shprehje i ashtuquajtur i substitutum. Nëse përfaqësuesi me prokurë, autorizimin për përfaqësim e bartë në person tjetër, ose autorizon person tjetër që të ndërmerret veprime procedurale të caktuara, për ndërmarrjen e të cilave është i autorizuar ai, bëhet fjalë për substitutum (zëvendësim) të

përfaqësuesit me prokurë.¹⁴² Personi në të cilin përfaqësuesi me prokurë e ka bartur prokurën është zëvendësi i tij (substituti).¹⁴³

Pushimi i prokurës mund të varet nga rrethana të ndryshme. Një nga ato rrethana është lloji i prokurës. Kur bëhet fjalë për prokurë për një veprim procedural, atëherë kuptohet se kjo prokurë shuhet kur veprimi procedural për të cilin personi ka qenë i autorizuar është ndërmarrë. Prokura për një veprim procedural mund të shuhet edhe nëse ndërmarrja e atij veprimi është irrelevant ose është e pamundur që të ndërmerret. Gjithashtu kjo prokurë shuhet, edhe me vdekjen e autorizuesit ose të autorizuarit, ose të përfaqësuesit ligjor të palës, me shuarjen e personit juridik, humbjen e zotësisë së veprimit të palës ose të përfaqësuesit ligjor etj.

Prokura e procedurale zakonisht pushon me përfundimin e procedurës, ose të stadiumit të procedurës për të cilën është dhënë.¹⁴⁴ Kjo llojë prokure shuhet kur personi i autorizuar sipas kësaj prokure nuk është avokat. N.q.s. personi i autorizuar me këtë prokurë është avokat kjo prokurë nuk shuhet në këtë moment. Sipas nenin 92 të L.P.K prokura pushon nëse: “Me vdekjen e personit fizik, respektivisht me shuarjen e personit juridik, pushon edhe prokura; Në rast të falimentimit, prokurën të cilën e ka dhënë debitori falimentues, pushon kur sipas dispozitave në fuqi do të paraqiten pasojat juridike të hapjes së procedurës falimentuese; përjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, i autorizuari me prokurë është i detyruar që edhe një muaj t’i ushtrojë veprimet nëse në këtë mënyrë pala do të shmang dëmin”.¹⁴⁵ Prokura procedurale pushon edhe me vdekjen e përfaqësuesit me prokurë ose kur ai humb zotësinë e veprimit. Prokura pushon edhe me vdekjen e të përfaqësuarit, me humbjen e zotësisë së veprimit, ose humbjen e zotësisë së veprimit të përfaqësuesit ligjor. Me ndalesën e ushtrimit të veprimitarisë së avokatit etj. I përfaqësuari ose përfaqësuesi mund të revokojë përkatësisht të heqë dorë nga prokura në çdo kohë. Kur i përfaqësuari e revokon prokurën, ai duhet më shkrim

¹⁴² Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 215-216.

¹⁴³ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq 216

¹⁴⁴ Po aty

¹⁴⁵ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 19.02.2020

të informojë gjykatën për këtë veprim, dhe ky veprim hyn në fuqi menjëherë. Nëse përfaqësuesi heq dorë nga prokura duhet gjithashtu të lajmërojë të përfaqësuarin dhe gjykatën se heq dorë nga prokura. Megjithatë ky veprim nuk hyn në fuqi menjëherë. I autorizuari është i detyruar që të ndërmarrë veprime në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit deri në një muaj pasi të ketë hequr dorë nga prokura, përjashtimisht nëse i përfaqësuari ka angazhuar përfaqësues të ri, atëherë ky është i liruar nga detyrimi në fjalë.

7.Zhvillimi i procedurës

7.1. Padia nocioni, llojet, efekti juridik, kundërpadia.

Në përditshmëri shpesh herë e dëgjojmë fjalën padi. Megjithatë për juristin çfarë do të thotë padia? Padia paraqet një shkresë me përmbajtje të caktuar e cila i drejtohet gjykatës dhe me të cilën inicohet procedura kontestimore. Ekzistojnë disa përkufizime në lidhje me padinë. Sipas përkufizimit material padia paraqet kërkesë që të mbrohet një e drejtë e shkelur apo e rrezikuar e subjektit të së drejtës i cili e parashtron padinë. Sipas përkufizimit formal padia paraqet shkresë e cila ka një përmbajtje të caktuar dhe me të cilën paditësi e paraqet kërkesën e tij.

Padia jo domosdoshmërishtë duhet të jetë në formë të shkresës. E njëjta mund të parashtrohet edhe me gojë para gjykatës e cila do ta evidentojë në procesverbal. Për të dhënë një përkufizim më gjithëpërfshirës për padinë do të shprehemi se: Padia paraqet një shkresë e cila përmban një ose më shumë kërkesa të paditësit i cili pretendon se e drejta/tat i është apo janë shkelur ose rrezikuar dhe kërkon mbrojtje nga gjykata, dhe në të cilën ai i plotëson të gjitha parametrat (elementet) të cilat duhet t'i ketë një padi për të qenë e rregullt. Me padi inicohet procedura kontestimore.

Megjithatë çfarë duhet të përmbajë një padi për të qenë e rregullt, përkatësisht cilat janë elementet të cilat duhet t'i përmbajë një padi për të qenë e rregullt? 1) Si element i parë i padisë kuptohet se duhet të jetë *petitumi* (kërkesa-kërkesëpadi). Me *petitumi* paditësi e

specifikon qartë llojin dhe mënyrën e mbrojtjes të cilën e kërkon nga gjykata. 2) Element tjetër të cilin duhet t’ia përmbajë padia është edhe baza faktike. Nga cilat fakte të ndodhura ose pretenduara ai e bazon, përkatësisht pretendon se e derivon të drejtën e tij të kërkesës ose të mbrojtjes së të drejtës së shkelur ose të rrezikuar. 3) Provat paraqesin një tjetër element të cilin duhet ta përmbajë padia. Kur bëhet fjalë për dokumente, paditësi ato duhet t’ia bashkangjisë padisë, ndërsa kur bëhet fjalë për dëshmitar, duhet që të evidentojë emrin, mbiemrin, adresën etj. 4) Të dhënat që duhet t’i ketë çdo parashtresë edhe të parapara në nenin 98 paragrafi 3 i L.P.K.: “përcaktimin e gjykatës, emër dhe mbiemër të bashkangjitura me dokument identifikimi si provë, vendbanimi respektivisht vendqëndrimi i palëve, respektivisht firmën dhe selinë e personit juridik të regjistruar në Regjistrin qëndor të Republikës së Maqedonisë ose në ndonjë tjetër regjistër të bashkangjitur me provë nga regjistri përkatës, përfaqësuesit e tyre ligjor dhe përfaqësuesit me prokurë nëse kanë, objektin e kontestit, vlerën e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe nënshkrim të parashtruesit, përkatësisht nënshkrim elektronik, e-mail adresën dhe numër kontakti”.¹⁴⁶ Në raste të veçanta duhet të ekzistojë edhe interesin juridik. Ai paraqet element të rëndësishëm, ngaqë nëse konstaton gjykata se nuk ka interes juridik pala e cila e ka parashtruar padinë do ta hedhë poshtë të njëjtën, si pasojë e mospërmbushjes së prezumimeve procedurale, ngaqë interesi juridik paraqet prezumim procedural. Në raste të caktuara padia duhet domosdoshëmirisht të përmbajë edhe vlerën e objektit të kontestit.

Nëse padia nuk i përmban elementet të cilat janë të domosdoshme që të konsiderohet e rregullt, gjykata paditësit do i jap një afat të caktuar për t’i përmirësuar lëshimet të cilat i ka konstatuar në padi. Nëse paditësi nuk e përmirëson padinë, gjykata e hedh poshtë të njëjtën si të palejuar. Nëse paditësi e përmirëson padinë, konsiderohet se data e parashtrimit të padisë është data kur fillimisht është parashtruar e njëjta.

Kur flasim për paditë dhe llojin e padive, ekzistojnë një numër i konsiderueshëm kriteresh sipas së cilave ato klasifikohen. Për interes të punimin nuk do i elaborojmë të gjitha një e nga një, por veç do i përmendim. Ndërsa sa i përket elaborimit do t’i elaborojmë, padinë deklaratore, padinë kondemnatore dhe padinë konstitutive.

¹⁴⁶ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 20.02.2020

Sipas efektit dhe natyrës së të drejtës subjektive mbrojtja e së cilës kërkohet paditë ndahen në: personale dhe sendore; duke marrë për kriter marrëdhënien e juridiko-civile e cila kontestohet paditë klasifikohen në: padi sendore, petitoare, posesore, negatore, pauliane etj. Në teorinë e të drejtës procedurale, rëndësi shumë më të madhe ka ndarja e padive në lloje duke pasur parasysh përmbajtjen e mbrojtjes juridike që kërkohet me padi, pavarësisht nga natyra e të drejtës subjektive të shkelur.¹⁴⁷ Sipas këtij kriteri, në teorinë procedurale është përgjithësisht e pranuar ndarja tripartite e padive në: padi deklaratore(vëretetimi), konstitutive(ndryshimi) dhe kondemnatore(dënimi).¹⁴⁸

Padia deklaratore(vërtetimi). Sipas Profesorit Pozniq: “Me këtë padi, paditësi porpozon që të konstatohet se ekziston një raport juridik.¹⁴⁹ Mbrojtjen të cilën e kërkon ai pra e kufizon në deklaram.¹⁵⁰ Në ligj përveç konstatimit të ekzistimit të raportit juridik, përmendet edhe mundësia e konstatimit të një të drejte. Në rastin e parë kemi të bëjmë me raportin juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, e në të dytin vetëm me një të drejtë subjektive.¹⁵¹ Si shembull për këtë lloj padie, mund të përmenden padia për konstatimin e marrëdhënies së punës, kontratës së shitblerjes, kontratës mbi ndërtimin, së drejtës së trashëgimit, pronësisë, shfrytëzimit.¹⁵² Zakonisht, me padi kërkohet konstatimi i raportit juridik si ekzistues (pozitiv), mirëpo me të mund të propozohet që gjykata të konstatojë edhe mosekzistimin e tij (negativ)¹⁵³

Padia konstitutive (ndryshimi). Padia konstitutive (ndryshuese) (juridiko – formësuese, respektivisht juridiko – transformuese) është lloj i tillë i padisë me të cilën paditësi kërkon nga gjykata t’i jep mbrojtje juridike, ashtu që me vendimin e vet të bëjë ndryshime të caktuara në marrëdhëniet juridiko – civile: të themelojë marrëdhënie juridike që nuk ka ekzistuar deri atëherë ose të ndryshojë ose anulojë marrëdhënien që ka ekzistuar deri atëherë.¹⁵⁴ Subjektet e

¹⁴⁷ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 322

¹⁴⁸ Po aty.

¹⁴⁹ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 232

¹⁵⁰ Po aty

¹⁵¹ Po aty

¹⁵² B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 233

¹⁵³ Po aty

¹⁵⁴ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq.325

së drejtës munden që me anë të vullnetit të tyre të krijojnë ndryshojnë apo shuajnë marrëdhënie juridike. Megjithatë kjo jo çdoherë është e mjaftueshme. Ndonjëherë që të mund të jenë të vlefshme këto krijime, ndryshime apo shuarje, duhet të ekzistojë edhe vendimi i gjykatës. Si padi konstitutive janë: padia e divorcit, padia për zmadhimin e mjeteve të ushqimisë, padia për zvogëlimin e dënimit kontraktues, padia për shuarjen e shoqërisë tregtare etj.

Padia kondemntaroe(dënuese). Në literaturë padia kondemnatore, përveç si padi dënuese emërtohet edhe si padi detyrimi. Me padi detyrimi paditësi pretendon se ndaj të paditurit i takon e drejta në një prestim të caktuar dhe propozon që gjykata ta detyrojë të paditurin ta përmbushë prestimin e tillë.¹⁵⁵ Për kondemnim është e drejtuar edhe padia me të cilën propozohet detyrimi për përmbushjen e një kërkesë materialo – juridike të natyrës reale apo tashëgimore, si p.sh. për dorëzimin e sendin paditësit në bazë të së drejtës së tij të pronësisë, të shfrytëzimit apo të trashëgimit.¹⁵⁶ Në këtë padi prestimi i kërkuar jo çdoherë është në veprim. Me këtë padi paditësi mund të kërkojë që i padituri të mosveprojë, përkatësisht të durojë.

Me parashtrimin e padisë gjykatës, ky veprim prodhon pasoja (efekt) qofshin ato materiale qofshin apo procedurale. Sipas Profesorit Brestovci efekti materialo – juridik që shkaktohet me parashtrimin e padisë pasqyrohet në: “me paraqitjen e padisë ndërprehet sikurse parashkrimi shues ashtu edhe parashkrimi fitues.”¹⁵⁷ Në qoftë se e drejta e paraqitjes së padisë është e kufizuar me afat prekluziv, atëherë prekluzioni nuk shkaktohet, në qoftë se padia paraqitet brenda afatit të tillë.¹⁵⁸ Kur e drejta e zgjedhjes midis dy prestimeve, në rast të detyrimeve alternative, i takon kreditorit, atëherë e drejta e zgjedhjes konsumohet në momentin e ngritjes së padisë.¹⁵⁹ E drejta e cila është e lidhur rreptësisht për personin e caktuar, pra ajo, e cila nuk mund të trashëgohet, kalon në trashëgimtarët, në qoftë se titullari i saj vdes pasi të ketë paraqitur padinë dhe trashëgimtarët mund ta vazhdojnë ndjekjen e

¹⁵⁵ B. Pozniq, E drejta e procedurës civile – botimi i dytë, Prishtinë, 1980, Fq. 232

¹⁵⁶ Po aty

¹⁵⁷ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 259

¹⁵⁸ Po aty

¹⁵⁹ Po aty

çështjes ë gjyq.¹⁶⁰ Në rastet në të cilat nuk është caktuar më parë afati për përmbushjen e detyrimit, debitori bie në vonesë që nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë.¹⁶¹ Ekzistojnë edhe një mori çështjes të tjera të cilat paraqesin pasoja juridiko – materiale me parashtrimin e padisë në gjykatë, megjithatë do të mjaftohemi me këto për tani.

Efekti juridiko – procedural i parashtrimit të padisë në gjykatë pasqyrohet në atë se me ndërmarrjen e këtij veprimi juridik, inicohet procedura kontestimore. Një efekt tjetër procedural është se, përfundimisht themelohet kompetenca e gjykatës për ta shqyrtuar çështjen; përcaktohet vlera e objektit të kontestit, fitohet cilësia e palëve të cilat janë të evidentuar në padi si paditës dhe i paditur; nëse është paraqitur litispendenca paditësi nuk mund ta ndryshojë padinë pa u pajtuar i padituri, respektivisht ta tërheqë atë pa pajtimin e të paditurit me kusht që ai të jetë lëshuar në shqyrtimin e çështjes kryesore në mënyrë aktive; paditësi ka mundësi që ta ndryshojë padinë nëse pas parashtrimit të padisë janë ndryshuar rrethanat, në atë mënyrë që nga e njëjta marrëdhënie faktike, të kërkojë objekt tjetër ose shumë të hollash, ndërsa i padituri nuk mund t'i kundërvihet kësaj, etj.¹⁶² Për sa i përket efektit procedural të parashtrimit të padisë do e lëmë me kaq. Në vijim me disa fjali do e elaborojmë edhe kundërpadinë.

Kundërpadia është padi e të paditurit kundër paditësit e parashtruar në procesin të cilin i dyti e ka vënë në veprim kundër të parit.¹⁶³ Me anë të kundërpadisë i padituri në të njëjtën gjykatë dhe në të njëjtin gjykim e parashtron kërkesëpadinë e tij të veçantë.¹⁶⁴ Me kundërpadi themelohet edhe një raport proceduralo-juridik, me role të kundërta të palëve.¹⁶⁵ Kundërpadia është paraparë si e drejtë e të paditurit dhe jo si detyrë procedurale e tij.¹⁶⁶ Ekzistojnë tre lloje kundërpadishë, edhe atë: konekse, kompensuese dhe prejudiciale.

¹⁶⁰ Po aty

¹⁶¹ Po aty

¹⁶² Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 333

¹⁶³ Prof.dr. F. Brestovci, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, 1988, Fq. 289

¹⁶⁴ Po aty

¹⁶⁵ Po aty

¹⁶⁶ Po aty

7.2.Përgatitja e shqyrtimit kryesor dhe shqyrtimi kryesor

Procedura kontestimore kalon në disa faza. Faza përgatitore, përkatësishtë seanca përgatitore, paraqet një fazë fakultative të procedurës. Faza përgatitore caktohet më së voni 15 ditë nga kalimi i afatit për përgjigje në padi. Siç thamë është fazë fakultative, edhe për këtë vendos gjykata. Nëse gjykata e sheh të nevojshme do ta caktojë të njëjtën. Nëse jo atëherë gjykata do të caktojë direkt shqyrtimin kryesor. Faza përgatitore nuk caktohet në kontestet me vlerë të vogël.

Në seancën përgatitore bëhet koncentrimi dhe përkufizimit i materialit procedural dhe gjithashtu gjykata mundohet që t'i evitojë përkatësishtë mënjanojë pengesat procedurale të cilat nuk janë shqyrtuar në fazat paraprake. Pra qëllim i seancës përgatitore është që të krijohen parakushtet për vendosje të themeltë të çështjes.

Seancën përgatitore e hap gjykatësi individual, përkatësisht kryetari i kolegjit dhe konstaton të pranishmit objektin dhe vlerën e kontestit dhe gjithashtu kujdeset për përmbushjen e prezumimeve procedurale, të cilat çojnë në lejimin e zhvillimit të mëtutjeshëm të procedurës. Pra në këtë fazë nëse është e nevojshme nga rrethanat e rastit mund të caktohet edhe ekspertimi i ndonjë prove, por kuptohet që nuk shqyrtohet në atë seancë rezultati i ekspertimit.

Në seancën përgatitore përcaktohen faktet të cilat janë kontestuese dhe gjithashtu grumbullohen provat dhe i gjithë materiali procedural. Në këtë fazë nuk sillet vendim meritor, përjashtimisht vetëm nëse i padituri nuk vjen në seancën e parë, paditësi heq dorë nga padia ose kërkesëpadia, ose nëse lidhet pajtimi gjyqësor. Me të përfunduar seanca përgatitore, caktohet seanca për shqyrtimin kryesor.

Shqyrtimi kryesor, paraqet fazë të domosdoshme dhe është fazë qendrore e procedurës. Në të bëhet shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha provave të paraqitura, dëgjohen dëshmitarët dhe ndërmerren të gjitha veprimet e tjera procedurale të cilat janë të nevojshme për t'i mundësuar gjykatës vendosje meritorë çështjes në shqyrtim. Pra nga sa mund të vërejmë shqyrtimi kryesor me të vërtetë është faza qendrore e procedurës.

Në procedurat kontestimore në të cilat nuk është mbajtur faza përgatitore, të gjitha veprimet të cilat ndërmerren në atë fazë, do të ndërmerren në seancën e parë të shqyrtimit kryesor. Shqyrtimin kryesor e hap gjykatësi individual, ose kryetari i kolegjit. Me hapjen e shqyrtimit kryesor kryetari i trupit gjykues, shpall objektin e kontestit, konstaton prezencën e personave të thirrur, dhe a janë të thirrur në rregull, vlerën e kontestit dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të pasur një zhvillim sa më të rrjedhshëm të seancës.

Palët pas mbarimit të seancës së parë për të shqyrtimit kryesor nuk mund të pretendojnë fakte të reja dhe të paraqesin prova të reja, përveç në rrethanat e përcaktuara me ligj. Në shqyrtimin kryesor palët përballen me njëra tjetrën duke shoshitur provat dhe duke arsyetuar pretendimet dhe kundërshtuar pretendimet e kundërshtarit. Në shqyrtimin kryesor palët mund të paraqesin prapësime dhe kundërshtime në lidhje me çështje të ndryshme që dalin nga shqyrtimi kryesor.

Gjykata përkatësisht kolegji respektivisht gjyqtari individual, ka rol pasiv. Ai bën vetëm drejtimin e procedurës, dhe nuk merr pjesë aktivisht në shqyrtimin kryesor. Gjatë shqyrtimit kryesor vendos vetëm për çështje të natyrës procedurale me aktvendim. Kur çështja gjykohet në kolegji atëherë siç edhe e thamë me procedurën udhëheq kolegji dhe kryetari i kolegjit flet në emër të kolegjit pasi vendimet të jenë marrë me shumicë. Jashtë seancës, kryetari i kolegjit është i autorizuar të vendosë për: 1)përmirësim të parashtresës; 2) rregullshmërinë e prokurës; 3)lirimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore; 4)shpenzimet procedurale në rast të tërheqjes së padisë;5)bashkimin e procedurave; 6) caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm; 7) sigurimin e shpenzimeve procedurale; 8)caktimin e afateve dhe vazhdimin e tyre etj.

Preferohet që shqyrtimi të mbyllet me një seancë për shkak të ekonomicitetit dhe efikasitetit të procedurës, megjithatë ligji lejon që një seancë të shtyhet nga ekzistimi i rrethanave të arsyeshme të cilat ligji i lejon. Me konsumimin e shqyrtimit të të gjitha provave të cilat kanë qenë për shqyrtim, dhe shqyrtimin e më tepër këndeve të vështirimit të çështjes, kolegji, përkatësisht gjykatësi individual e shpall shqyrtimin kryesor të mbyllur dhe këtë e bën me aktvendim. Pas mbylljes së shqyrtimit kryesor, kolegji tërhiqet për të vendosur në lidhje me çështjen.

7.3.Aktgjykimi dhe aktvendimi

Aktgjykimi paraqet aktin më të rëndësishëm të cilin e shpall gjykata. Me aktgjykim vendoset çështja në mënyrë meritore. Aktgjykimi është akt individual. Kur aktgjykimi shpallet ai merr cilësinë e aktit perfekt. Kjo do me thënë se nuk lejohet që të ndryshohet përmbajtja e tij, por vetëm gabimet e aspektit teknik. Aktgjykimet klasifikohen në aktgjykime deklaratore, kondemnatore dhe konstitutive. Gjithashtu aktgjykimi mund të jetë i plotë ose i jo i plotë, i pjesshëm, plotësues, i ndërmjetshëm, kontradiktor dhe jo kontradiktor, aktgjykimi në bazë të pranimit, aktgjykim në bazë të heqjes dorë, aktgjykimi në bazë të mosparashtrimit të përgjigjes në padi.

Aktgjykimi duhet të shpallet në brenda afatit të caktuar me ligj. Ai më pas duhet të përpunohet edhe në formë të shkruar dhe gjithashtu të shpallet brenda afatit të përcaktuar me ligj. Aktgjykimi përmban pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin. Këto janë karakteristika për të gjitha aktgjykimet.

- a) Aktgjykimi deklarator, është ai lloj i aktgjykimit në të cilin konstatohet ekzistenca ose mosekzistenca e një marrëdhënie ose raporti juridik. Përkatësisht me këtë lloj aktgjykimi gjykata e vendos çështjen në mënyrë meritore. Rrjedhimisht edhe konstaton faktet e pretenduara nga palët për ekzistimin apo mosekzistimin e një marrëdhënie të caktuar juridike. Si shembull mund të mirret: aktgjykimi me të cilin vërtetohet ekzistimi i martesës, ekzistimi i testamentit etj.
- b) Aktgjykimi konstitutiv, është aktgjykim me të cilin krijohet, ndryshohet ose shuhet një marrëdhënie juridike. Kur subjektet e së drejtës duan që të krijojnë ndryshojnë apo shuajnë një marrëdhënie juridike atëherë ato atë mund t'a bëjnë me shprehjen e vullnetit të tyre. Megjithatë kjo jo çdoherë është e mjaftueshme, pasi nevojitet edhe ndërhyrja e gjykatës që ato veprime të jenë të vlefshme. Si shembuj të aktgjykimeve konstitutive janë: aktgjykimi për shkëputjen e martesës, aktgjykimi për shkëputjen e kontratës, për shkëputjen e marrëdhënies së punës etj.
- c) Aktgjykimet kondemnatore, janë aktgjykime të cilat në dispozitivin e tyre, e detyrojnë palën që të bëjë, të mosbëjë ose të durojë një sjellje të caktuar. Për dallim

nga dy aktgjykimet e përmendura ky lloj aktgjykimi është aktgjykim që nëse nuk përmbushet detyrimi në mënyrë vullnetare, atëherë edhe mund të përmbahet. Këto ndryshe quhen edhe si aktgjykime dënuese.

- d) Aktgjykimi i plotë dhe jo i plotë, ky klasifikim i aktgjykimeve nisët nga ajo se me aktgjykimin e shpallur, a është vendosur për të gjitha kërkesat e paraqitura në padi ose jo. Nëse me aktgjykim është vendosur për të gjitha kërkesat atëherë aktgjykimi është i plotë, nëse është vendosur vetëm për një pjesë të tyre atëherë ky aktgjykim quhet aktgjykim jo i plotë.
- e) Aktgjykimi i pjesshëm është aktgjykim me anë të të cilit gjykata vendos për një ose për disa kërkesa të paraqitura në procedurë, ose vendos për një pjesë të kërkesës së paraqitur, me kusht që ato të jenë shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për sjelljen e vendimit përfundimtar.¹⁶⁷
- f) Aktgjykimi plotësues, është lloj i aktgjykimit jo të plotë me të cilin gjykata vendos për kërkesat për të cilat nuk ka vendosur me aktgjykimin e shpallur fillimisht. Ky aktgjykim sillet në bazë të iniciativës së palës.
- g) Sipas nenit 316 të L.P.K aktgjykimi i ndërmjetshëm është lloj i aktgjykimit jo të plotë i cili sillet kur i paditur e ka kontestuar edhe bazën e kërkesëpadsisë edhe shumën e kërkesëpadsisë, ndërkohë që sa i përket bazës çështja është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për sjelljen e vendimit, prandaj gjykata për shkaqe të përshtatshmërisë së pari sjell aktgjykim vetëm për bazën e kërkesëpadsisë – aktgjykim të ndërmjetshëm.¹⁶⁸
- h) Aktgjykimi kontradiktor dhe jo kontradiktor janë aktgjykime të cilat klasifikohen në bazë të asaj se palët a janë kundërshtuar në mes veti në procedurë deri në fund. Nëse palët kanë mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta deri në përfundimin e gjykimit kemi aktgjykim kontradiktor. Nëse njëra nga palët ka hequr dorë nga qëndrimet e saj, përkatësisht, paditësi ka hequr dorë nga padia ose ka hequr dorë

¹⁶⁷ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 374

¹⁶⁸ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-parnichnata-postapka-20-01-2011-prechisten-tekst.pdf> qasur më 21.02.2020

nga kërkesë padia, ose i padituri e ka pranuar kërkesëpadinë, atëherë kemi të bëjmë me aktgjykim jo kontradiktor.

- i) Aktgjykimi në bazë të pranimit, është aktgjykim jokontradiktor, cili buron nga fakti se i padituri e pranon kërkesëpadinë e paditësit. Nga kjo derivohet edhe aktgjykimi dhe është e panevojshme për ta çuar procedurën më tutje.
- j) Aktgjykimi në bazë të heqjes dore, është aktgjykim i cili vjen si pasojë e heqjes dorës nga kërkesëpadia nga ana e paditësit. Me këtë veprim paditësi pohon se kërkesa e tij është e pabazuar, dhe në bazë të këtij veprimi gjykata do ta sjellë aktgjykimin. Me shpalljen e aktgjykimit kjo çështje bëhet res iudicata dhe paditësi nuk mundet që përsëri për të njëjtën kërkesëpadi të padisë të paditurin e njëjtë, Për dallim nga tërheqja e padisë e cila nuk shkakton këtë efekt.
- k) Aktgjykim në bazë të mospërgjigjes në padi, kur pala nuk e realizon detyrimin ligjor për t'iu përgjigjur padisë dhe sillet në mënyrë pasive, ligji dhe gjykata këtë sjellje e konsiderojnë si pranim të kërkesëpadisë. Në bazë të këtij pasiviteti dhe mosdëshirës për mbrojtjen e të drejtave të veta i padituri do të bartë dhe pasojat e këtij aktgjykimi.
- l) Aktgjykimi për shkak të mungesës, është lloj i aktgjykimit i cili buron nga pasiviteti i të paditurit. Kur ai do të jetë absolutisht pasiv dhe nuk do të ndërmerr asnjë veprim procedural, atëherë gjykata do të sjellë aktgjykim për shkak të mungesës pasi do konsiderojë se pala e paditur me pasivitetin e saj e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit.

Aktivendimi paraqet akt të gjykatës me të cilin gjykata vendos për çështje të natyrës procedurale, pra që nuk kanë të bëjnë me vendosjen me themel të çështjes. Përgjashtimisht me aktivendim çështja vendoset me themel me aktivendim në disa procedura të veçanta kontestimore, siç janë procedura për pengimin e posedimit, për dhënien e urdhërpagesës dhe kur gjykata nuk vendos për shpenzimet procedurale në aktgjykim, për to vendose me aktivendim.

Ka disa lloje të aktvendimeve edhe atë: aktvendime për drejtim të procedurës, aktvendim me të cilin vendoset për prezumimet procedurale, aktvendim me të cilat vendoset për autorizimet procedurale të palëve, aktvendime me të cilat ndalet procedura, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime për shkak të keqpërdorimi të autorizimeve procedurale, aktvendime me të cilat vendose për kompenzimin e shpenzimeve procedurale, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime për shkak të mungesë së disiplinës procedurale dhe aktvendime me të cilat vendoset në mënyrë meritore.¹⁶⁹

7.4. Plotëfuqishmëria

Plotëfuqishmëria, ose forma e prerë e një aktgjykimi nënkupton se ai akt nuk mund të goditet më me mjete juridike, qofshin ato remonstrative apo devolutive, të rregullta ose të jashtëzakonshme. Një aktgjykim bëhet i formës së prerë pas kalimit të afatit të caktuar ligjor, me kusht që të mos goditet me mjete të rregullta të goditjes. Nëse goditet me mjete të rregullta të goditjes, atëherë çështja dërgohet në gjykatën e apelit e cila do e shqyrtojë të njëjtën. Me kryerjen e operacioneve për të cilat është e autorizuar gjykata e apelit, dhe plotësimin e afateve të caktuara dhe vendosjen përfundimtare në lidhje me aktgjykimin, ai merr formën e prerë ose ndryshe thënë bëhet i plotëfuqishëm.

Plotëfuqishmëria e aktgjykimit mund të vërehet edhe nga aspekti material por edhe nga ai formal. Me plotëfuqishmëri në aspektin material sipas Profesorit Janevski paraqet: “plotëfuqishmëria materiale është cilëse e vendimit të plotëfuqishëm formalqë do të thotë se me anë të vendimit përfundimisht dhe në mënyrë autoritative është zgjidhur çështja juridike që është objekt i vendosjes.”¹⁷⁰ Plotëfuqishmëria materiale ka të bëjë me përmbajtjen e vendimit dhe manifestohet nëpërmjet efektit të tij.¹⁷¹ Vendimi bëhet i plotëfuqishëm në kuptimin

¹⁶⁹ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 387 - 388

¹⁷⁰ Dr. A. Janevski, Dr. T. Zoroska – Kamiloska, E drejta procedurale civile - Libri i parë - E drejta kontestimore, Shkup, 2009, Fq. 390

¹⁷¹ По аты

material kur nuk ka kurrëfarë mundësie (as në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike) që të ndryshohet përmbajtja e tij”.¹⁷²

Plotëfuqishmëria në aspektin formal është cilësi e vendimit që nënkupton se vendimi nuk mund të goditet, përkatësisht të prishet, të ndryshohet në procedurën sipas mjeteve të rregullta të goditjes. Plotëfuqishmëria formale vin në shprehje atëherë kur kalon afati për parashtrimin e mjetit të rregullt të goditjes, me heqjen dorë nga ankesa dhe kur shkalla e dytë e vërteton vendimin e shkallës së parë.

Elementet e plotëfuqishmërisë janë: 1) res iudicata, kur aktgjykimi merr formën e prerë atëherë ajo çështje e cila është gjykuar nuk mundet që përsëri të shqyrtohet ngaqë aktgjykimi i formës së prerë paraqet pengesë për shqyrtim të sërishëm të çështjes së zgjidhur njëherë me aktgjykim të formës së prerë; 2) vendimi i formës së prerë i rregullon në mënyrë përfundimtare dhe autoritative marrëdhënien/t kontestuese ndërmjet tyre dhe është ligj për palët; 3) përmbajtja e të drejtave dhe detyrimeve të vërtetuara me aktgjykim të formës së prerë konsiderohet se është e vërtetë.

Me këtë shqyrtim do e përfundojmë kapitullin e parë të punimit. Në vijim do të shqyrtojmë zhvillimin historik të gjuhës së përdorur në procedurën kontestimore, duke nisur që nga fillimi i ish Jugosllavisë socialiste përkatësisht me aktet e para juridike të asaj kohe e këtej. Do të mundohemi që të bëjmë një shqyrtim sa më objektiv dhe shkencor të çështjes që kemi para nesh për shqyrtim.

¹⁷² Po aty

Kapitulli II

1.Kushtetuta e ish RSFJ dhe ndryshimet e pësuara nga 1945 deri më 1991

Kushtetuta e ish RSFJ, si edhe çdo kushtetutë tjetër ka pësuar ndryshime në aspektin përmbajtësor të saj. Megjithatë në këtë pjesë të punimit nuk do të fokusohemi për të trajtuar ndryshimet që kanë të bëjnë me organizimin territorial të drejtat, detyrimet etj. por do mundohemi të elaborojmë ndryshimet për sa i përketë gjuhës së gjykatës dhe të palëve në procedurë.

Pra duke u nisur nga ky vështrim atëherë si akt i parë më i lartë i këtij shteti është kushtetuta e 1946 e Republikave Federative Popullore e Jugosllavisë, ku ndër të tjera gjithsesi parashihet rregullimi i pushteti gjyqësor, por gjithashtu parashihet edhe gjuha në procedurë. Pra duke u nisur nga kjo dhe konkretisht nga neni 120 i cili thekson se: “Procedura para gjykatave udhëhiqet në gjuhët e republikave ose krahinave autonome ku ndodhet gjykata. Qytetarët të cilët nuk e dinë gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura, mund të shërbejnë me gjuhën e tyre. Këtyre qytetarëve u sigurohet e drejta që të njihen me të gjithë materialin procedural dhe nëpërmjet përkthyesit të ndjekin punën e gjykatës”. Nga ky formulim i dispozitës mund të themi se palës i janë siguruar të drejtat themelore në lidhje me procedurën. Megjithatë duke marrë parasysh natyrën deri diku represive të shtetit mund të themi se jo çdoherë kjo gjë ka mundur të realizohet.

Nëse nisemi dhe flasim për Maqedoninë, në kohën e atëherëshme e emërtuar si Republika Popullore e Maqedonisë, gjuhë zyrtare në procedurat gjyqësore dhe rrjedhimisht në atë kontestimore është gjuha maqedonase, kjo derivohet nga neni 112 i kushtetutës së RPM si njësi federale. Ndërsa pakicat mund të përdorin gjuhën e tyre dhe të njihen me materialin procedural dhe të ndjekin punën e gjykatës me anë të përkthyesit. Pra duke pasur parasysh se pothuajse e gjithë pjesa perëndimore e Maqedonisë e populluar me shqiptarë nuk është marrë parasysh për tu cilësuar si popull shtetëformues, rrjedhimisht edhe procedura nuk ka mundur

të zhvillohet në gjuhën shqipe. Ndërsa të ndjekja e procedurës me anë të përkthyesit paraqet të drejtë themelore të qytetarit për sa i përket procedurave gjyqësore.

Situata në Kosovë e cila ka qenë e organizuar si njësi autonome ka qenë më ndryshe, duke pasur parasysh se shumica e popullsisë ka qenë shqiptare, procedurat gjyqësore por i gjithë aparati shtetëror ka funksionuar edhe në gjuhën shqipe.

Pra duke u nisur vetëm nga formulimi i dispozitës kushtetuese të RFPJ nuk mund të themi se ajo paraqet një dispozitë diskriminuese, përkundrazi është dispozitë gjithëpërfshirëse e cila si çdo dispozitë tjetër kushtetuese lejon që të rregullohet me ligj, por në rastin konkret edhe me dispozitën kushtetuese të RPM të precizohet, nga ku në aspektin praktik del edhe problemi.

Deri më 1974 kushtetuta e RFPJ pëson ndryshime, me anë të së cilave së pari ndryshohet edhe emri i federatës, edhe atë emërtohet si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë shkurt R.S.F.J. decentralizohet dhe merr një frymë më demokratike. Megjithatë situata ndryshon në këtë vit dhe gjithçka bëhet më e centralizuar.

Për sa i përket procedurës kontestimore dhe gjuhës në të, ajo nuk pëson ndryshime, ngaqë siç e thamë ndryshimet janë të karakterit politik, dhe jo pastër juridik. Për sa i përket kushtetutës së 1974, ajo normalisht se e rregullon organizimin e gjykatave dhe punën e tyre. Megjithatë nuk specifikon gjuhën në të cilën duhet të udhëhiqet procedura. Kjo për arsye se në atë kohë filluan të miratohen akte të veçanta për punën dhe organizimin e gjykatave, si në rang republike, ashtu edhe në rang të njësive federale, qofshin ato republika apo krahina autonome.

Që të mos zgjatemi shumë në këtë pjesë të punimit, për sa i përket ndryshimeve kushtetuese, në vijim konkretisht do të elaborojmë procedurën kontestimore dhe punën e gjykatave duke elaboruar aktet juridike me të cilat në veçanti janë rregulluar këto çështje. Përkatësisht do të elaborojmë Ligjin mbi procedurën kontestimore të 1956, Ligjin mbi gjykatat e rregullta të 1976, Ligjin mbi procedurën kontestimore të 1976 dhe disa fjalë për Kushtetutën e R.S.M.

2.Ligji mbi procedurën kontestimore 1956 dhe Ligji mbi procedurën kontestimore 1976.

Ligji mbi procedurën kontestimore të 1956 nuk parasheh dispozitë shprehimore me të cilën përcaktohet gjuha në procedurën kontestimore. Por kjo nuk do me thënë se aspak kjo gjë nuk është e rregulluar me dispozitat në fuqi të kohës. Duke pasur parasysh se kjo çështje, pra çështja e gjuhës së gjykatës dhe palëve në procedurë në atë kohë ka qenë e rregulluar me kushtetutën e R.F.P.J. siç edhe e kemi elaboruar më lartë.

Pra gjuha në procedurë sipas së cilës është udhëhequr procedura, në të cilën i kanë ndërmarrë veprimet juridiko – procedurale palët, ka qenë gjuha e cila është paraparë me kushtetutën e njësisë federale ku është zhvilluar procedura. Pra nëse flasim për në territorin e Maqedonisë atëherë gjuhë e procedurës ka qenë gjuha maqedonase. Nëse i referohemi Kosovës atëherë gjuhë në të cilën është udhëhequr procedura ka qenë gjuha shqipe e kështu me rradhë. Ligji i procedurës kontestimore i 1956 paraqitet si një akt i kompletuar nga aspekti juridik dhe gjithëpërfshirës. Kjo ngaqë nga sa mund të vërejmë, për kohën ka qenë një hap i madh përpara për sa i përket procedurës kontestimore.

Rënditja dhe rregullimi i materies është goxha i qartë dhe i organizuar. Duke pasur parasysh edhe rrethanat kohore dhe ato socio - ekonomike, mund të themi se ky akt ka ndihmuar që të arrihet në mënyrë më efikase deri tek mbrojtja juridike për palët të cilët kanë qenë të interesuara në procedurë. Si çdo akt tjetër juridik, në letër ky akt duket gjithëpërfshirës dhe i mirëorganizuar, megjithatë eksploatimi i tij nuk mund të ketë ardhur nga vetë formulimi si akt i të njëjtit, por nga djallëzia dhe qëllimet e këqija të njerëzve.

Për sa i përket Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1976 mund të themi se paraqet një hap më tej në lidhje me gjuhën e përdorur në procedurën kontestimore nga gjykata dhe nga palët. I ndikuar nga rrethanat shoqërore të kohës dhe normalisht duke i'u përshtatur atyre, ky ligj paraqitet si më fleksibil për sa i përket gjuhës së përdorur në procedurë.

Sipas këtij ligji, përkatësishtë neni 6 i këtij ligji thuhet se: “Procedura kontestimore zhvillohet gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë gjykatë. Palët dhe pjesëmarrësit e

tjerë në procedurë kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe shkrimin e vet dhe t'u dërgohen letrat në gjuhët e kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë në pajtim me dispozitat e ligjit".¹⁷³ Nga formulimi i dispozitës mund të vërehet se kjo paraqet një hap të madh përpara për sa i përket gjuhës së përdorur në procedurë.

Në këtë periudhë kohore, gjuha e gjykatës në procedurë përcaktohet me Ligjin për gjykatat, të cilin do e elaborojmë më pas. Megjithatë formulimi i këtillë i dispozitës së ligjit, nënkupton se në një farë rrafshi si gjuhë "gjysëmzyrtare" janë paraqitur edhe gjuhët e pakicave. Kjo ngaqë, pala mund t'i drejtohet gjykatës në gjuhën e saj, gjykata përveç se duhet t'ia kthejë përgjigjen në gjuhën zyrtare të saj, duhet që palës t'i përgjigjet edhe në gjuhën e palës.

Duke u nisur nga logjika e dispozitës, hipotetizohet, nëse në një gjykatë në Serbi, ku gjuha zyrtare e gjykatës është serbishtja, n.q.s. një shqiptar i është drejtuar të njëjtës gjykatë në gjuhën shqipe, gjithmonë sipas dispozitës, gjykata duhet që aktet e saj t'ia dorzojë palës edhe në shqip. Megjithatë kjo mbetet vetëm në rrafshin hipotetik dhe teorik, sepse kjo gjë ka qenë shumë e vështirë për të ndodhur, për një mori arsyesh të cilat nuk kanë të bëjnë me teorinë dhe praktikën juridike.

Një gjë tjetër që e vërehet është se mungon formulimi "mund ta ndjekë procedurën nëpërmjet përkthyesit". Kjo nuk do me thënë që ka qenë i ndaluar përkthyesi nëse pala nuk e ka njohur gjuhën në të cilën është zhvilluar procedura, gjithësesi se ka mundur të shfrytëzojë asistencën e përkthyesit. Por fakti që dispozita ligjore parasheh që shkresat t'i dorëzohen palës edhe në gjuhën e tij, paraqet një hap të madh përpara, për sa i përket qasjes ndaj palëve.

Kjo është me rëndësi për shkak se Jugosllavia si federatë multietnike dhe multikulturore, në këtë formulim të dispozitës mundohet që edhe vetë procedura të jetë sa më gjithpërfshirëse dhe transparente. Por jo vetëm, duke pasur parasyshë tensionet e kohës dhe dinamikën e raporteve në mes popujve të Jugosllavisë në atë kohë, kjo dispozitë, në një farë mënyre sipas mendimit tonë, përveç korrektesës dhe etikës gjithëpërfshirëse juridike, mundohet që të ulë tensionet në një farë mënyre.

¹⁷³ Ligji mbi procedurën kontestimore, neni 6, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.F.J. nr. 4, 1977.

Për sa i përket renditjes dhe formulimit, ky akt juridik paraqitet si i kompletuar në pjesën më të madhe të tij. I mirërenditur dhe gjithëpërfshirës, duke pasur si qëllim që t'ua lehtësojë arritjen deri në mbrojtjen juridike të të drejtave të subjekteve të së drejtës, por edhe duke i dhënë rregulla të qarta gjykatës për mënyrën dhe renditjen e hapave që duhen ndërmarrë në procedurë.

3.Ligji mbi gjykatat i vitit 1976

Ligji mbi gjykatat i vitit 1976 i miratuar më 16 mars të 1976 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.10 të Republikës Socialiste të Maqedonisë më 29 mars të po atë viti, paraqet një akt jashtëzakonisht të rëndësishëm juridik për sa i përket gjykatave dhe rregullimit të tyre. Ky ligj paraqet një hap para në tentimin për barazi dhe funksionim sa më efikas të gjykatave dhe lëndëve të cilat do të jenë në procedim.

Sipas këtij ligji në nenin 2 thuhet se: “Gjykatat e rregullta (në tekstin e mëtejshëm: gjykatat) janë: gjykatat me kompetencë të përgjithshme dhe gjykatat ekonomike”.¹⁷⁴ Në vijim të këtij ligji përcaktohet edhe lloji i lëndëve të cilat mund të gjykohen nga të njëjtat. Konkretisht neni 4 thekson: “Gjykatat: vendosin për kontestet nga marrëdhëniet themelore personale, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të drejtat dhe detyrimet e bashkësive shoqërore – politike, shqiptojnë dënime dhe masa të tjera ndaj kryerësve të veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme me ligj, vlerësojnë ligjshmërinë e akteve individuale të organeve shtetërore dhe organizatave të cilat kryejnë autorzime publike, i zgjidhin kontestet nga marrëdhëniet pronësore dhe të punës, nëse zgjidhja e këtyre kontesteve nuk u është besuar gjykatave të vetëdministrimit, dhe zgjidhin edhe raporte të tjera kur kjo është e paraparë me ligj”.¹⁷⁵

Në nenin 31 parashihet edhe organizimi hierarkik i gjykatave. Sipas këtij neni hierarkia është siç vijon: gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut si gjykata me kompetencë të përgjithshme; gjykatat ekonomike të qarkut; gjykata ekonomike e Maqedonisë dhe Gjykata

¹⁷⁴ Ligji mbi gjykatat, neni 2, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁷⁵ Ligji mbi gjykatat, neni 4, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

Supreme e Maqedonisë”.¹⁷⁶ Për dallim nga sistemi aktual, ku nuk parashihen gjykatat ekonomike, sipas këtij Ligji paraparja e këtyre gjykatave ka pasur një rol të rëndësishëm në atë kohë, ngaqë zhvillimi i hovshëm i industrisë, qoftë ajo tekstile, kimike, hekurit etj, krijuan parakushtet për zhvillim ekonomik. Nga kjo natyrshëm se do të lindnin edhe konteste në mes subjekteve ekonomike në atë kohë. Prandaj edhe roli i këtyre gjykatave ka qenë që të zgjidhin kontestet në mes subjekteve ekonomike (tregtare).

Gjykatësit sipas këtij ligji janë zgjedhur nga Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë me mandat të caktuar. Ato janë zgjedhur dhe ka mundur t’i shkarkojë Kuvendi. Kjo nuk flet për pavarësinë e gjykatave, e aq më pak të pushtetit gjyqësor si pushtet i barabartë me atë ekzekutiv dhe legjislativ. Pra siç shohim gjykatat kanë qenë të varura dhe praktikisht e kanë pasur të pamundur t’a ushtrojnë funksionin e tyre në maksimumin e kapacitetit dhe të autorizimeve të cilat u janë dhënë me ligj.

Për sa i përket gjuhës në procedurat gjyqësore, ku bën pjesë edhe procedura kontestimore, kjo çështje është rregulluar me dispozitat nga neni 14 deri tek neni 20. Sipas nenit 14: “Procedura para gjykatave udhëhiqet në gjuhën maqedone. Pjesëtarë e kombeve dhe kombësive të tjera, në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre para gjykatës, kanë të drejtë në përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të tyre”¹⁷⁷. Sipas kësaj dispozite zyrtarizimi i gjuhëve të kombësive të tjera në procedurë është gjysmak, ngaqë ato vetëm mund t’i drejtohen dhe të ndërmarrin veprimet juridiko – procedurale në gjuhën e tyre. Nëse tërheqim një paralele me statusin e gjuhës shqipe deri para 2019, vërejmë se janë në po të njëjtin rrafsh të avancimit.

Neni 15: “Pjesëtarët e kombeve dhe kombësive të tjera, parashtresat mund t’i parashtrojnë në gjuhën e kombësisë së tyre”.¹⁷⁸ Pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive të tjera, gjykata do u mundësojë përkthim oral gjatë rrjedhës së procedurës, si edhe të akteve dhe shkresave të tjera, në atë vëllim në të cilin ajo duhet të bëhet, duke marrë parasysh cilësinë e personit në procedurë.¹⁷⁹ Për këtë të drejtë do të njoftohet personi i cili mund të heqë dorë nga

¹⁷⁶ Ligji mbi gjykatat, neni 31, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁷⁷ Ligji mbi gjykatat, neni 14, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁷⁸ Ligji mbi gjykatat, neni 15, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁷⁹ Ligji mbi gjykatat, neni 16, paragrafi 1, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

kjo e drejtë nëse e njëj gjuhën maqedonase, ndërsa në procesverbal do të evidentohet se personi është këshilluar në lidhje me këtë të drejtë, si dhe deklaratën e tij.¹⁸⁰ Përkthimi është bërë nëpërmjet përkthyesit. Pra nga sa shohim situata është ekzaktësisht e njëjtë me situatën aktuale, përkatësishtë deri para 2019 në R.M.V. Pak a shumë mund të themi se prej 1991 janë bërë hapa pas, dhe jo para në lidhje me avancimin e gjuhëve të kombësive të ndryshme nga ajo maqedonase.

Neni 17 paraqet “sensacionin” e këtij ligji për sa i përket përdorimit të gjuhëve të kombësive të tjera të ndryshme nga ajo maqedonase. Neni 17 thekson: “Në territorin e komunave ku jetojnë anëtarë të kombësive, nëse me statutin e komunës është paraparë përdorimi i gjuhës së kombësisë së caktuar, procedura para gjykatës komunale e cila vepron në atë komunë udhëhiqet edhe në gjuhën e asaj kombësie”¹⁸¹. Me fjalë të tjera dhe me shembull konkret, Tetova si qytet me shumicë të popullatës shqiptare, nëse me statut të komunës është paraparë edhe përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, ngaqë shumica e popullsisë së komunës është shqiptare, atëherë procedura, ka mundur të udhëhiqet edhe në gjuhën shqipe. Kjo paraqet në aspektin juridik një avancim të pa parë deri më atëherë të gjuhës shqipe në territoret e njësive federale të ish Jugosllavisë me shumicë të kombësive të tjera. Megjithatë edhe pse çështja në letër qëndron shumë bukur, duhet të kemi parasysh se kjo dispozitë nuk është qëndisur kështu për shqiptarët dhe gjuhën shqipe. Në R.S.M. të kohës shumica janë deklaruar si turq, serbë, bullgarë etj dhe kjo dispozitë është formuluar kështu për t’u shkuar përshtat këtyre kombësive. Duke mos pasur për qëllim të ofendojmë askënd, vetëm po mundohemi të etablojmë realitetin dhe faktet e kohës. I njëjti realitet mund të themi se ka ekzistuar edhe në Strugë si qytet me shumicë shqiptare, por i copëtuar në komuna të vogla, përkatësishtë fshatra – komuna. Dhe e pamundur që të sillet një statut në atë formulim, përsëri duke i’u referuar rrethanave. Teorikisht dhe ligjërisht e lejuar, praktikisht e pamundur. Kjo dispozitë si e tillë paraqet siç e thamë një avancim të pa parë të gjuhëve të popujve të ndryshëm nga ai maqedonas në R.S.M. edhe pse praktikisht e pamundur për kohën, të paktën vendosja e kornizës juridike, ka qenë rruga e duhur.

¹⁸⁰Ligji mbi gjykatat, neni 16, paragrafi 2, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁸¹Ligji mbi gjykatat, neni 17, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

Thirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore dorëzohen në gjuhën maqedonase.¹⁸² Kur me statutin e komunës në territorin e së cilës vepron gjykata, është paraparë përdorimi i gjuhës së një kombësie tjetër, gjykata komunale e atij territori, pjesëmarrësve në procedurë që i përkasin asaj kombësie, shkërsat (thirrjet, paditë, vendimet, ankesat, dhe parashtresat e tjera) do i'a dorëzojë edhe në gjuhën e asaj kombësie në qoftëse në procedurë e përdor gjuhën e tij.¹⁸³ Shpenzimet për përkthim të shkresave dhe shpenzimet për përkthyesin bie në ngarkesë të mjeteve buxhetore.¹⁸⁴

Në territoret e komunave në të cilat jetojnë anëtarë të kombësive, nëse me statutin e komunës është paraparë përdorimi i gjuhës së një kombësie tjetër, gjykata komunale e cila vepron në atë territor ka përherë përkthyes gjyqësor të gjuhës së kombësisë përkatëse.

Nga sa u tha dhe elaborua më sipër, mund të vërejmë se në aspektin ligjor gjuhët e kombësive të tjera të ndryshme nga ajo maqedonase, kanë pasur kornizë ligjore për përdorim zyrtar në procedurat gjyqësore. Kjo paraqet një të arritur të madhe të kohës, e cila ka ardhur si pasojë e një morie faktorësh socio – politik dhe socio – ekonomik. Rregullimi i këtij formacioni ekonomik – shoqëror, e ka pasur të nevojshme që t'u garantojë në njëfarë rrafshi të drejta themelore të gjithë anëtarëve të këtij shteti. Deri diku edhe ka dështuar, ndërsa herë herë ka dështuar edhe në mënyrë spektakolare.

Megjithatë ky akt juridik paraqet një nga aktet më të mirëformuluara dhe më të avancuara të kohës. Kjo ngaqë i ardhur nga një studim i faktorëve shoqëror të kohës, e ka bërë imediate nevojën për vendosjen e kornizës ligjore për përdorim zyrtar të gjuhës së kombësive të tjera të cilat nuk kanë qenë shumicë në R.S.M. Përveç kësaj duke i'u përshtatur edhe vetë formacionit socio-ekonomik, organizimi i tillë i gjykatave, ka qenë efikas dhe funksional.

Për sa i përket gjuhës shqipe, mund të themi se atëherë ajo ka qenë “më zyrtare” se para ndryshimeve kushtetuese të cilat pasuan nga konflikti i armatosur i 2001. Gjithashtu edhe pse në R.M. u vendos korniza kushtetuese, ajo asfare të implementohet, dhe nuk çuditemi pse,

¹⁸² Ligji mbi gjykatat, neni 18, paragrafi 1, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁸³ Ligji mbi gjykatat, neni 18, paragrafi 2, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

¹⁸⁴ Ligji mbi gjykatat, neni 19, 1976, Gazeta Zyrtare e R.S.M. nr. 10, 1976

sepse mësimi dhe precedenti është vendosur në ish sistemin. Pamundësimi i ushtrimit të të drejtave themelore të individit përherë paraqet një fuçi baruti.

4.Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë

Kushtetuta e Republikës Socialiste të maqedonisë është sjellë më 12 prill të 1963. I publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Maqedonisë më 12 prill të 1963. Me këtë kushtetutë e para që gjë vërehet është ndryshimi i emrit, nga Republika Popullore e Maqedonisë në Republika Socialiste e Maqedonisë. Gjithashtu me këtë kushtetutë u ndryshuan edhe një mori dispozitash, gjë të cilën nuk do e elaborojmë, ngaqë është jashtë objektit të shqyrtimit të tezës në shqyrtim.

Kushtetuta si akt më i lartë juridik i ka paraparë të gjitha çështjet të cilat janë esenciale për funksionimin e një shteti. Edhe ky rast nuk paraqet përjashtim. Ajo që na intereson për të shqyrtuar në këtë pikë është organizimi gjyqësor dhe gjuha në procedurat gjyqësore (konkretisht kontestimore). Kjo kushtetutë i ka kushtuar një kre të tërë gjyqësori, përkatësisht kreun IX. Sipas kushtetutës parashihet se gjykatat janë të pavarura dhe detyrën e tyre e ushtrojnë në bazë të ligjeve dhe kushtetutës. Neni 205 parasheh organizimin gjyqësor edhe atë: “Në Republikën Socialiste të Maqedonisë, si gjykata me kompetencë të përgjithshme funksionin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat komunale, gjykatat e qarkut, dhe Gjykata Supreme e Maqedonisë.¹⁸⁵ Për gjykim në kontestet ekonomike dhe vendosje për çështje të tjera juridike me interes për ekonominë, ekzistojnë gjykatat ekonomike.¹⁸⁶

Gjykatat vendosin për të drejtat personale, pronësore, të punës dhe të drejtat e tjera të qytetarëve dhe për detyrimet e tyre, për të drejtat pronësore dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera të organizatave dhe bashkësive shoqërore – politike, shqiptojnë dënime dhe masa të tjera ndaj kryerësve të veprave penale, vendosin në kontest administrativ për ligjshmërinë e akteve

¹⁸⁵ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/37EB0C4961424D1286094520A974BBC9.pdf> qasur më 06.03.2020

¹⁸⁶ Po aty

individuale të organeve shtetërore dhe organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike, vendosin edhe për raporte të tjera kur ajo është e paraparë me ligj.¹⁸⁷

Sipas kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë gjykatat themelohen nga Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë. Sipas kushtetutës, gjykatat komunale themelohen për një ose më tepër komuna. Për sa i përket gjykatave të qarkut, ato themelohen për një ose më tepër qarqe ose për pjesë të ndara të ndonjë qarku. Kuptohet Gjykata Supreme është gjykata më e lartë në vend, sipas kësaj kushtetutë.

Për sa i përket gjuhës në të cilën udhëhiqen procedurat gjyqësore, kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë në nenin 210 parasheh: "Procedura para gjykatave udhëhiqet në gjuhën maqedonase. Personat të cilët nuk e dinë gjuhën maqedonase kanë të drejtë që përpara gjykatave të shërbejnë me gjuhën e tyre".¹⁸⁸ Pra nga sa mund të shohim, nuk ka ndonjë risi kushedi se çfarë në këtë dispozitë, megjithatë në mënyrë të tërthortë ka vendosur edhe bazën kushtetuese për Ligjin mbi gjykatat të cilin e komentuar më sipër.

Për sa i përket kushtetutës në tërësi, ajo si popull shtetëformues njih vetëm popullin maqedonas. Të gjithë popujt e tjerë llogariten pakica. Kjo është kundërthënëse me faktet historike, por nuk është detyrë e jona të precizojmë këtë pikë. Ne fund të fundit ne jemi juristë, dhe jo historian apo persona të statistikës.

Për sa i përket zhvillimit historik dhe evoluiimit të përdorimit të gjuhës në procedurë, në kohën e ish sistemit, do ta përmbyllim me kaq. Pasi analizuam një mori aktesh juridike, mund të vërejmë se të paktën në letër, kanë qenë të garantuara një pjesë e madhe e të drejtave të popujve të cilët janë llogaritur si pakica. Ndërsa është çështje tjetër se sa janë respektuar dhe mbrojtur realisht ato të drejta gjatë kësaj periudhe kohore. Në kapitullin në vijim do mundohemi të elaborojmë gjuhën në procedurë pas shkëputjes së Maqedonisë nga ish federata. Konkretisht do të analizojmë një mori aktesh juridike, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, kanë rregulluar ose rregullojnë gjuhën e përdorur në procedurën kontestimore por edhe më gjerë.

¹⁸⁷ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/37EB0C4961424D1286094520A974BBC9.pdf> qasur më 06.03.2020

¹⁸⁸ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/37EB0C4961424D1286094520A974BBC9.pdf> qasur më 06.03.2020

Kapitulli III

1.Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991

Shkëputja e Republikës së Maqedonisë nga ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë paraqet një hap historik për Maqedoninë ngaqë, prej aty fillon të llogaritet ekzistimi i kësaj republike si shtet i pavarur. Me shkëputjen nga ish R.S.F.J. u shpall një kushtetutë fringo e re, me të cilën ndryshuan vlerat dhe parimet e organizimit të shtetit. Nga një shtet socialist, u ndryshua rendi shtetëror duke u organizuar në një shtet demokratik dhe me ekonomi të lirë tregu. Gjithashtu u ndryshuan dhe u parapanë edhe një mori gjërash, të cilat si të themi paraqesin “nishanet” e shtetit demokratik me ekonomi të lirë të tregut.

Për sa i përket gjuhës në procedurën kontestimore, shprehimisht nuk është paraparë ndonjë dispozitë që të rregullojë këtë çështje sipas kushtetutës së atëherëshme. Megjithatë ekzistonin dispozita të cilat parashihnin gjuhën e përdorur në komunikimin zyrtar të organeve të republikës me qytetarët dhe në mes organeve. Konkretisht gjuha zyrtare e republikës ishte e rregulluar me nenin 7 të kushtetutës.

Neni 7 i kushtetutës së vitit 1991 thekson se: “Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilat jetojnë shumicë nga kombësitë, në përdorim zyrtar, përkrah gjuhës maqedonase dhe shkrimit qirilik, është edhe gjuha dhe shkrimi i kombësisë në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në njësitë e vetëadministrimit lokal në të cilat jetojnë një numër i konsiderueshëm i kombësive, në përdorim zyrtar, është gjuha dhe shkrimi i kombësisë, nën kushtet e përcaktuara me ligj”.¹⁸⁹

Sipas nenit 7 gjuhë zyrtare në të gjithë Republikën e Maqedonisë është vetëm gjuha maqedonase. Ndërsa si gjuhë zyrtare lokale paraqiten edhe gjuhët e kombësive të tjera të cilat në komunat e caktuara janë shumicë. Për ta konkretizuar, Tetova si qytet dhe komunë me shumicë banorësh të kombësisë shqiptare ka mundur, gjithmonë sipas formulimit të dispozitës,

¹⁸⁹ <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/mk/mk/mk014mk.pdf> qasur më 10.03.2020

të përdorë edhe gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare në territorin e komunës së cilën e ka përfshirë, përkatësisht të udhëheqë procedurat për të cilat ka qenë e autorizuar për t'i zbatuar edhe në gjuhën shqipe.

Megjithatë për sa i përket procedurës kontestimore ose më përgjithësishtë gjyqësore nuk vërejmë që ajo të jetë e rregulluar specifikisht për sa i përket gjuhës në procedurë. Pra gjuha zyrtare në procedurën kontestimore ka qenë gjuha maqedonase. Duke mos pasur as edhe fare pak bazë juridike për të udhëhequr procedurat kontestimore edhe në gjuhën e kombësive që janë shumicë në komunat e tyre, kjo gjë shpesh herë është paraqitur edhe si penalizuese.

Duke e krahasuar situatën me Ligjin e gjykatave të cilin e kemi elaboruar më parë, kjo gjë paraqet hap pas për sa i përket barazisë së kombësive, ngaqë edhe pse në një komunë një kombësi ka qenë shumicë, procedura gjyqësore nuk ka qenë e mundur të zhvillohet edhe në gjuhën që është llogaritur si gjuhë zyrtare sipas kriteriumit kushtetues të sipërpërmendur. Duke mos marrë parasyshë se shteti është i të gjithëve, hartuesit e ligjeve dhe dispozitave kushtetuese edhe formalisht kombësitë e tjera të cilat kanë jetuar në R.M. të cilat nuk janë llogaritur as si kombe shtetëformues i kanë përjashtuar nga e drejta për të ushtruar dhe gëzuar të drejtat themelore të njeriut. Sipas preambulës së kushtetutës “Republika e Maqedonisë në referendumin e 8 tetorit 1991, si dhe faktin historik se Maqedonia konstituohet si shtet kombëtar i maqedonasve në të cilën sigurohet barazi e plotë qytetare dhe bashkëjetesë e vazhdueshme e popullit maqedonas me atë shqiptar, turk, vlleh, rom, dhe kombësive të tjera të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë...”¹⁹⁰. Pra R.M. qenka shtet vetëm i maqedonasve dhe këto kombësitë e tjera që janë përmendur të le të kuptosh sikur në mënyrë aksidentale janë gjendur brenda këtyre kufijve, dhe shteti zotohet se do sigurojë barazi qytetare në mes të të gjithëve, ndërsa që në fillim e vendos vijën dalluese ku këto kombësi nuk llogariten si kombësi shtetformuese, por si kombësi aksidentalisht të ndodhura në këto territore dhe “premtan” se nuk do të diskriminohen.

Duke pasur këtë që u tha më lartë parasyshë dhe një mori tjetër faktorësh të cilët kanë qenë të natyrës praktike, ndryshimet kushtetuese paraqisnin një gjë që domosdoshme. Gjë kjo

¹⁹⁰ <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/mk/mk/mk014mk.pdf> qasur më 10.03.2020

e cila u zvarrit dhe çoi deri në konfliktin e armatosur të viti 2001. Gjë që mund të kishte qenë lehtësisht e shmangshme, në qoftë se me kohë do të vendosej korniza kushtetuese, por edhe ligjore për barazi reale të kombësive në Republikën e Maqedonisë. Ndryshimet kushtetuese të pas konfliktit paraqesin ndryshime të mëdha ngaqë me ato ndryshime, u ndryshua qasja dhe gjithashtu edhe disponimi dhe vullneti politik për një barazi të mirëfilltë juridike... përsëri deri diku.

2.Amandamenti V

Ndryshimet kushtetuese që pësoi kushtetuta pas konfliktit të armatosur i cili u përmyll përfundimisht me nënshkrimin e marrëveshjes kornizë së Ohrit, paraqesin ndryshime shume të rëndësishme. Ato vendosën bazën juridike për ushtrimin e të drejtave të kombësive të tjera të ndryshme nga ajo maqedonase. Të formuluar sipas kriterëve që i përshtateshin kombësisë së dytë më të madhe në vend pas asaj maqedonase, këto ndryshime kushtetuese ishin me vlerë të jashtëzakonshme për ushtrimin e të drejtave themelore për shqiptarët. Si pasojë e këtyre ndryshimeve kushtetuese është amandamenti i V i kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Me amandamentin e V të kushtetutës së R.M. u ndryshuar neni 7 i së njëjtës.

Amandamenti i V thekson: “ Në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të saj, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik. Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Dokumentet personale të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga ajo maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj, si dhe në gjuhën dhe shkrimin të cilin ata e flasin në pajtim me ligjin. Cilido qytetar i cili jeton në njësitë e vetëadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga ajo maqedonase, në komunikimin me njësitë rajonale të ministrive, mund të përdorë cilën do gjuhë nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e tyre. Njësitë rajonale janë kompetente që për ato njësi të vetëadministrimit lokal përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, dhe në gjuhën dhe shkrimin zyrtar të cilin e përdor

qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministritë mund të përdorë një nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj, ndërsa ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, si dhe në gjuhën dhe shkrimin zyrtar që e përdor qytetari. Në organet e pushtetit shtetëror, në Republikën e Maqedonisë si gjuhë zyrtare, e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në pajtim me ligjin. Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe shkrimi të cilin e përdorin së paku 20% e qytetarëve, është gjuhë zyrtare përkrah gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj qirilik. Për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të cilin e flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësinë e vetëadministrimit lokal, vendosin organet e njësisë së vetadministrimit lokal. Me këtë amandament zëvendësohet neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë”.¹⁹¹

Nga sa mund të vërejmë nga amandamenti V qytetarëve të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga ajo maqedonase, u garantohen një mori të drejtash, të cilat nuk u janë njohur me sipas formulimit të dispozitës nga neni 7 i Kushtetutës. Mund të vërejmë se ajo që është më me rëndësi është se amandamenti i V vendos kornizën juridiko – kushtetuese për zyrtarizimin edhe të një gjuhe tjetër të ndryshme nga ajo maqedonase me kusht që atë gjuhë ta flasin së paku 20% e qytetarëve. Në mënyrë të tërthortë gjuhë zyrtarë sipas kësaj dispozite është gjuha zyrtare edhe gjuha shqipe. E njëjta sipas dispozitës mund të përdoret edhe në komunikimin ndërkombëtar të shtetit (gjë që nuk ka ndodhur pothuajse asnjëherë).

Për sa i përket procedurës kontestimore, ose procedurave gjyqësore, me amandamentin V ato nuk rregullohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Megjithatë logjika thotë se nëse një gjuhë është zyrtare, atëherë duke qenë zyrtare ajo gjuhë edhe procedura kontestimore mund të udhëhiqet në atë gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Pra ekziston baza kushtetuese për ta ndërmarrë këtë veprim. Megjithatë aktet tjera juridike me të cilat është rregulluar procedura kontestimore “pamundësojnë” këtë gjë. Është nonsens juridik që një ligj të pamundësojë ushtrimin e një të drejtë e cila të garantohet me kushtetutë. Duke pasur parasysh se kushtetuta paraqet aktin më të lartë juridik të një shteti dhe rrjedhimisht në hierarki është më lartë se ligji, atëherë i bie që me automatizëm, ato dispozita të jenë

¹⁹¹ <http://dzt.mk/Uploads/ustavrm.pdf> qasur më 10.03.2020

kundërkushtetuese dhe të mos vlejné. Megjithatë ngecja në pezhiçkat e lojërave politike të cilat bëhen ka sjellë deri në këtë nonsens dhe ofendim për inteligjencën dhe logjikën e çdo juristi të mirëfilltë në këtë shoqëri.

Është një situatë tjetër e cila është simptomatike, sipas formulimit të dispozitave nga amandamenti V. Në asnjë rast nuk përmendet gjuha zyrtare e komunikimit në mes organeve shtetërore. Edhe pse dikush mund të thotë se ajo nënkutohet me formulimin e paragrafit të parë të dispozitës së amandamentit të V, ne mendojmë ndryshe. Pra situatën e shtrojmë në dy rrafshë. Në rrafshin e parë është komunikimi i organeve me qytetarët, ndërsa në rrafshin e dytë është komunikimi i organeve në mes tyre.

Në rrafshin e parë, zyrtariteti i gjuhës së 20%-shit nuk kontestohet. Konkretisht gjuha shqipe paraqet gjuhë zyrtare. Pra qytetari mund t'i drejtohet organit në gjuhën shqipe, dhe të marrë përgjigje në gjuhën shqipe dhe kështu me radhë. Megjithatë duke dalë në rrafshin e dytë, përkatësisht në komunikimin në mes organeve shtetërore, sipas nesh amandamenti i V nuk e ka rregulluar siç duhet këtë çështje. Konkretisht nuk e ka përmendur faktin se si gjuhë zyrtare e komunikimit në mes organeve shtetërore duhet të jetë përpos gjuhës maqedonase, edhe gjuha e 20%-shit rrjedhimisht gjuha shqipe. Për mendimin tonë, sipas këtij formulimi të dispozitës së amandamentit, në këtë rrafsh gjuha shqipe nuk paraqet gjuhë zyrtare.

Për sa i përket procedurës kontestimore, edhe pse siç e thamë është vendosur baza juridiko – kushtetuese, Ligjet për procedurë kontestimore, qoftë ai i cili ishte në fuqi në kohën e ndryshimeve kushtetuese, qoftë ligji aktual, nuk e kanë recipuar siç duhet amandamentin e V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Përkatësisht nuk është e mundur që gjuha në të cilën udhëhiqet procedura dhe mbahet procesverbali të jetë e ndryshme nga gjuha maqedonase, sipas dispozitave të këtyre ligjeve që rregullojnë çështjen në fjalë. Kjo gjë përherë ka shkaktuar diskutime të ashpra qoftë në opinionin publik, qoftë në atë akademik.

Për sa i përket Amandamentit të V-të nuk do të shtojmë më shumë, formulimi është i qartë dhe konciz. Në vijim të këtij kapitulli do të shqyrtojmë Ligjet për procedurën kontestimore nga 1991 e deri më tani. Dhe gjithashtu do të shqyrtojmë edhe ligjet të cilat kanë buruar nga Amandamenti i V-të, konkretisht Ligjin për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e

qytetarëve në R.M. dhe njësitë e vetadministrimit lokal (2008) dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve (2019).

3.Gjuha në Ligjet për procedurën kontestimore (1998 dhe 2005)

Ligji i parë për procedurë kontestimore i Republikës së Maqedonisë është ligji i ish Jugosllavisë i sjellë më 1976. Kjo gjë do të ndryshojë më 1998 edhe atë më 1 korrik të vitit 1998. Ky ligj është ligji i parë për procedurë kontestimore i cili buron nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur. Për sa i përket procedurës kontestimore, qasja e këtij ligj dhe stili në të cilin është zhvilluar në mënyrën inkuizitore, me elemente tek tuk të stilit akuzator.

Për sa i përket gjuhës së përdorur në procedurë, kjo gjë është e rregulluar me nenin 6 të ligjit. Sipas nenit 6: “Procedura kontestimore udhëhiqet në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik; Pjesëtar i kombësive qytetar i Republikës së Maqedonisë i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë, nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik ka të drejtë në interpretues. Shpenzimet për interpretuesin bien në ngarkesë të Republikës së Maqedonisë; Gjykata është e detyruar ta këshillojë palën, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë nga paragrafi 2 i këtij neni për të drejtën e paraparë me të njëjtin nen. Kryetari i kolegjit ose gjyqtari individual është i detyruar që ta shënojë në procesverbal këshillën e gjykatës dhe deklaratën e palës, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë”.¹⁹²

Pra nga sa mund të vërejmë, dispozita e cila e rregullon gjuhën e cila duhet të përdoret në procedurë është shumë precize pa lënë hapësirë për interpretim. Megjithatë duke pasur parasysh rrethanat shoqërore dhe situatën politiko – shoqërore, hartuesit e ligjit duhet të kishin qenë më të kujdesshëm, që të paktën me një formulim ndryshë të kësaj dispozite, të tregoheshin më gjithëpërfshirës. E themi këtë ngaqë duke pasur parasysh se në krahasim me ligjin për gjykatat të 1976 të R.S.M. ky formulim i dispozitës është një hap prapa në kontekst të

¹⁹² <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/D4FC184C83214422BB68C53354EE2EEC.pdf> qasur më 11.03.2020

barazisë së popujve që jetojnë në shtet dhe tendecës që shteti të sigurojë barazi për të gjithë qytetarët. Në këtë aspekt Republika e Maqedonisë e pas 1991 ka dështuar në një mori rastesh, kjo duke mos futur në ekuacion gjëra të cilat janë sensitive për kombësitë e tjera që jetojnë në kufijtë e Republikës së Maqedonisë dhe janë qytetarë të saj.

Ndryshimet kushtetuese të cilat pasuan pas konfliktit të armatosur dhe Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, vendosën bazë juridike për përdorimin si gjuhë zyrtare të cilitdo popull i cili e arrin pragun e 20%. Në atë kohë por edhe tani i vetmi komb që e arrin këtë në Republikën e Maqedonisë Veriore janë shqiptarët. Pra me fjalë të tjera korniza kushtetuese për përdorimin e gjuhës shqipe edhe në procedurën kontestimore është vendosur me Amandamentin e V. Në vijim do e shqyrtojmë Ligjin për procedurë kontestimore të 2005.

Për sa i përket gjuhës në të cilën do të zhvillohet procedura kontestimore, ligji këtë gjë e parasheh në nenin 6. Sipas nenit 6: “Procedura kontestimore udhëhiqet në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik; Në procedurën kontestimore gjuhë tjetër zyrtare dhe shkrimi i saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, dhe përdoret në pajtim me këtë ligj; Pjesëtari i bashkësive, i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë, nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, ka të drejtë në përkthyes; Shpenzimet e përkthimit bien në barrë të gjykatës; Gjykata është e detyruar ta këshillojë palën, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë për të drejtën e paraparë në paragrafet 2 dhe 3 të këtij neni. Kryetari i kolegjit ose gjyqtari individual është i detyruar ta shënojë në procesverbal këshillën e gjykatës dhe deklaratën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë”.¹⁹³

Duke e lexuar nenin e cituar më lartë në shikim të parë duket se çështja e gjuhës, sidomos rregullimin e zyrtarizimit të gjuhës së cilën e flasin së paku 20% e popullsisë e ndryshme nga ajo maqedonase (pra shqipe) është rregulluar. Përkatësisht në paragrafin 2. Megjithatë është simptomatike se si “zyrtaritetit” të kësaj gjuhe i vendosen kufij për të pamundësuar realizimin praktik të së njëjtës. Me bindje mund të themi se prej me 2005 e deri më sot as edhe 1 procedurë kontestimore nuk është zhvilluar në gjuhën shqipe, konkretisht as

¹⁹³ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/C727BE1C5EE5A648A4663606B7FBD8BD.pdf> qasur më 11.03.2020

edhe 1 procesverbal nuk është shkruajtur në shqip. Edhe pse paragrafi 2 e rregullon çështjen në fjalë, dhe në fund thotë në pajtim me këtë ligj. Ndërsa dispozita tjetër duke mos precizuar se për cilat bashkësi i dedikohet kjo i fut në një thes të gjitha bashkësitë e tjera (edhe atë shqiptare) dhe u'a kufizon "zyrtaritetin" e procedurës me përkthyes.

Në nenet 93 deri më 97 rregullohet çështja e gjuhës nëpër shkresat nëpërmjet të cilave bëhet komunikimi zyrtar. Në këto dispozita është paraparë që pala e cila flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe është pjesëtare e popullsisë së 20% mund të përdorë gjuhën e saj. Konkretisht pala mundet që padinë, kundërpadinë, përgjigjen në padi, prapësimet etj t'i ndërmarrë në gjuhën të cilën e flet (shqipe). Gjykata është e detyruar që shkresat të cilat i referohen kësaj pale t'i shkruajë edhe në gjuhën shqipe. Deklaratat e dëshmitarëve, deklaratat e palës tjetër dhe të gjitha veprimet juridiko – procedurale t'ia përkthejë në gjuhën zyrtare të cilën e përdor pala, që është e ndryshme nga gjuha maqedonase. Pra në një farë mënyre pretendohet që të bëhet zbatim konsekuent i Amandamentit të V të Kushtetutës. Megjithatë duke u nisur nga praktika, nëse një avokat përpilon një padi në emër dhe për llogari të një klienti, ai asesi nuk mundet që atë padi ta vulosë me vulën e tij zyrtare. Pra personi duhet që personalisht ta parashtrojë shkresën e caktuar në gjykatë nëse do që ato t'i parashtrojë edhe në gjuhën e tij.

Është pothuajse banale e gjithë kjo situatë, sepse nga njëra anë ligjvënësi "dëshiron" të bëjë barazimin e qytetarëve ndërsa nga ana tjetër vendos kushte të cilat janë të pazbatueshme... me pak fjalë populli thotë: "për pulat e zeza vlejné rregulla të tjera". Duke pasur parasyshë të gjithë këtë situatë, përdorimi zyrtar, dhe me këtë nënkuptojmë mbajtjen e procesverbalit edhe në gjuhën shqipe dhe udhëheqjen e procedurës në shqip, ose pa marrë parasyshë, në cilëndo gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të ndryshme nga gjuha maqedonase, duhet të rregullohet duke mos vendosur kushte të cilat pamundësojnë të njëjtën. Kjo ngaqë edhe pse ekziston një kornizë kushtetuese e cila jep autorizime të gjëra, ligjëdhënësi me maliciozitet nga njëra anë dhe miopi nga ana tjetër, këtë gjë e kufizon në minimumin e mundshëm. Të parët nga nevoja për të qenë superior, të dytët nga shkaqe të tjera...

4.Ligji për përdorimin e gjuhës së cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal (2008)

Ligji për përdorimin e gjuhës së cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal, u soll në seancë parlamentare më 4 gusht të 2008. Me këtë ligj tentohet që të rregullohet konkretisht dhe në mënyrë konsektuente Amandamenti i V i Kushtetutës së Maqedonisë. Neni 1 dhe 2 përcaktojnë fushën e rregullimit e cila tentohet me këtë ligj. Neni 1 i këtij ligji thekson: “Me këtë ligj rregullohet përdorimi i gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal”.¹⁹⁴ Neni 2 vijon: “Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë mund të përdoret edhe gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase në pajtim me këtë ligj; Gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, përdoret në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, në komunikimin e qytetarëve me ministritë, procedurat gjyqësore, procedurat administrative, zbatimin e sanksioneve, avokatin e popullit, në procesin zgjedhor, në deklarimin e pandërmjetësuar të qytetarëve, në dhënien e dokumenteve personale të qytetarëve, në udhëheqjen e evidencës në librat amë, zbatimin e autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, objektet infrastrukturore, vetadministrimin lokal, financa, ekonomi, arsim dhe shkencë, kulturë, dhe në të tjera fusha dhe institucione në pajtim me këtë ligj”.¹⁹⁵

Nga sa mund të vërejmë ky ligj rregullon një mori të gjerë fushash për sa i përket përdorimi të gjuhës të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (gjuhën shqipe). Për këtë punim është me rëndësi të shohim se si e rregullon përdorimin e gjuhës së 20% në procedurën kontestimore. Përkatesishtë këtë gjë ky ligj e rregullon në nenin 10, 11, 12 dhe 13.

¹⁹⁴ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE07B4F6DDFBE948A0DFE2CFF240F02C.pdf> qasur më 11.03.2020

¹⁹⁵ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE07B4F6DDFBE948A0DFE2CFF240F02C.pdf> qasur më 11.03.2020

Neni 10 thekson: “Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare, e cila gjithashtu është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, në procedurë kanë të drejtë që gjatë pjesëmarrjes në seanca dhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale në formë orale para gjykatës ta përdorin gjuhën e tyre; Palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë nga paragrafi 1 i këtij neni në procedurë do u sigurohet përkthim oral në gjuhën e tyre për sa i përket seancës, si dhe përkthim oral dhe me shkrim të dokumenteve të cilat përdoren gjatë seancës për të provuar; Përkthimin e realizojnë përkthyesit gjyqësor”.¹⁹⁶ Në nenin 11 parashihet: “Thirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik; Palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, qytetarë të Republikës së Maqedonisë, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, thirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore u dorëzohen në atë gjuhë”.¹⁹⁷ Neni 12 vijon: “Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën kontestimore, paditë, ankesat dhe parashtersat e tjera i parashtrojnë në gjykatë në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik; Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë, qytetarë të Republikës së Maqedonisë, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik, paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera mund t’i parashtrojnë në gjykatë në gjuhën dhe shkrimin e tyre. Parashtresat e këtilla gjykata i përkthen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik, dhe u’a vendos u’a dërgon palës tjetër dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë”.¹⁹⁸ Neni 13: “Shpenzimet e përkthimit për palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë të cilët janë qytetarë të Republikës së Maqedonisë që krijohen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, për të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të tyre, bien në ngarkesë të mjeteve të gjykatës”.¹⁹⁹

Nga sa mund të vërejmë me këtë ligj zgjerohet rrethi i veprimeve të cilat palët mund t’i ndërmarrin në gjuhën e tyre. Megjithatë nuk mund të flasim për zyrtaritet të plotë të procedurës kontestimore, ngaqë në asnjë nen apo paragraf nuk është paraparë edhe udhëheqja e procedurës, përkatësisht seancës edhe në gjuhën shqipe, konkretisht, shkruajtja

¹⁹⁶ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE07B4F6DDFBE948A0DFE2CFF240F02C.pdf> qasur më 11.03.2020

¹⁹⁷ Po aty

¹⁹⁸ Po aty

¹⁹⁹ Po aty

e procesverbalit edhe në gjuhën shqipe. Përsëri zyrtariteti i cili buron nga Amandamenti i V i kushtetutës nuk është paraparë dhe zbatuar në mënyrën dhe frymën në të cilën është përpiluar Amandamenti i V në këtë ligj. Edhe pse ky ligj është një hap në drejtimin e duhur, përsëri nuk është plotësisht në pajtim me vullnetin dhe frymën e aktit nga ku buron, edhe pse formalisht është korrekt.

5.Ligji mbi përdorimin e gjuhëve (2019)

Ligji për përdorimin e gjuhëve u soll në seancë parlamentare e cila u mbajt më 14 mars të 2018. I ndjekur nga një mori sjelljesh kontraverse, duke mos u nënshkruajtur nga Presidenti i kohës, i cili në rrjedhë e sipër bëri edhe shkelje kushtetuese, më në fund u publikua në gazetën zyrtare pa nënshkrimin e dekretit të Presidentit të kohës. Ky ligj parasheh një përdorim më të gjerë të gjuhëve (gjuhës shqipe) më të gjerë në të gjith organet e pushtetit shtetëror.

Për sa i përket përdorimit ose më saktë ndikimin e këtij ligji në procedurën kontestimore, por edhe në të gjitha procedurat gjyqësore, ky ligj parasheh zgjerim dhe zyrtarizim të mirëfillte të gjuhës së cilën e flasin më së pakti 20% e qytetarëve, e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik. Përkatesishtë, kjo çështje rregullohet në nenin 9, cili në mënyrë ekstensive parasheh përdorimin e gjuhës së 20% (gjuhës shqipe).

Neni 9 paragrafi 1 thekson: “Në procedurat gjyqësore, administrative, përmbartuese dhe zbatimin e sanksioneve, para hetimore dhe hetimore, penale, e kundërvatjes, kontestimore dhe jo kontestimore, si dhe procedurave të tjera para gjykatës, prokurorive publike si dhe të gjitha organeve të tjera, trupave dhe institucioneve, zbatohet gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik, si dhe gjuha të cilën e flasin më së pakti 20% e qytetarëve dhe shkrimi i saj”.²⁰⁰ Paragrafi 2 i të njëjtit nen thekson: “Të gjitha procedurat e paragrafi 1 të këtij neni udhëhiqen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin më së pakti 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe shkrimin e saj nëqoftëse gjykatësi, prokurori

²⁰⁰ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2019/01/Zakon-za-upotreba-jazitsite-14-01-2019.pdf> qasur më 12.03.2020

publik, pala ose pjesëmarrës tjetër në procedurë është person i cili flet gjuhën të cilin e flasin më së pakti 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë”.²⁰¹

Paragrafi 3 i këtij neni parasheh: “Të gjitha, vendimet, shkresat dhe të gjitha aktet e tjera të cilat rrjedhin nga procedurat e paragrafit 1 të këtij neni sillen dhe lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në shkrimin e saj qirilik, si dhe në gjuhën të cilën e flasin më së pakti 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj, nëqoftëse gjykatësi, prokurori publik, pala ose pjesëmarrës tjetër në procedurë është person i cili flet gjuhën të cilën e flasin më së pakti 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë”.²⁰² Paragrafi 4 parasheh: “Institucionet e përmendura në paragrafi 1 të këtij neni janë të detyruara të mundësojnë përkthim të të gjithë dokumenteve dhe materialit, si dhe përkthim simultan të deklaratave dhe seancave në punët apo procedurat të cilat janë duke u udhëhequr”.²⁰³ Paragrafi i pestë parasheh: “Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve dhe materialit, respektivisht mossigurimi i përkthimit simultan gjatë gjithë rrjedhës së procedurës, paraqet shkelje esenciale procedurale”.²⁰⁴

Nga sa u tha më sipër mund të vërejmë se sipas paragrafi 1 dhe 2 të nenit 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve mund të vërejmë se tani krijohet një mundësi e re. Konkretisht tani procedura gjyqësore, rrjedhimisht edhe ajo kontestimore mund të udhëhiqen edhe në gjuhën tjetër zyrtare të cilën e flasin 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe). Me këtë nënkuptojmë që edhe procesverbali të mund të mbahet në gjuhën shqipe, dhe të gjitha veprimet procedurale nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurë të ndërmerren në gjuhën shqipe. Për to nëse gjykatësi është shqiptar të mund të vendosë në gjuhën shqipe dhe t’i shënojë të njëjtat në procesverbal në gjuhën shqipe.

Me këtë ligj bëhet një hap i madh përpara për sa i përket barazisë së kombësive të tjera të ndryshme nga ajo maqedonase, përkatësisht shqiptarëve, ngaqë edhe formalisht vendoset korniza juridike zyrtarizim të gjuhës shqipe edhe në gjyqësor. Edhe pse këto dispozita bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore, duhet të kemi parasysh se Ligji

²⁰¹ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2019/01/Zakon-za-upotreba-jazitsite-14-01-2019.pdf> qasur më 12.03.2020

²⁰² Po aty

²⁰³ Po aty

²⁰⁴ Po aty

për përdorimin e gjuhëve është Lex Specialis për sa i përket përdorimit të gjuhëve dhe i derogon dispozitat e L.P.K. për sa i përket gjuhës në procedurë.

Një tjetër situatë e cila parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve në dispozitat kalimtare neni 23 është:” Në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha institucionet e përmendura janë të detyruar që ti sjellin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji; Në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet janë të detyruara të përmbushin detyrimet të cilat burojnë nga neni 7 i këtij ligji; Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë program për të ngritur vetëdijen publike për këtë ligj; Në afat prej 1 viti dispozitat e ligjeve të tjera do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji; Në rast të mosharmonizimit të dispozitave të këtij ligji me dispozitat e gjuhës së ndonjë ligji tjetër, organet janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e këtij ligji”.²⁰⁵

Pra nga sa mund të vërejmë prej asaj që buron nga ky ligj mund të themi se më në fund është bërë një hap i madh në drejtimin e duhur. Kjo çështje e përdorimit të gjuhës me anë të këtij ligji po merr kahjen e duhur në kuptimin e zbatimit të plotë dhe konsekuent të Amandamentit të V i cili u tentua të rregullohet me ligje të tjera të cilat nuk ishin në frymën e Amandamentit të V dhe paraqesin fiasko të legjislativit. Kjo ndoshta edhe për shkak të mos ekzistimit të vullnetit politik të njërit bllok që të bëjë ndryshime esenciale të cilat do barazonin qytetarët edhe praktikisht, ngaqë sipas kushtetutës të gjithë qytetarët janë të barabartë.

Me elaborimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve do e përmbylлим këtë kapitull. Nga sa shqyrtuam në dy kapitujt, përkatësisht në të II dhe të III mund të vërejmë se ekziston një jo kontinuitet në mënyrën se si janë rregulluar procedurat për sa i përket gjuhës së përdorur në procedurë. Kjo jo konsistencë i atribuohet vullnetit politik dhe ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në shoqëri dhe ndryshimet esenciale në formacionet shoqërore. Megjithatë për fund mund të themi se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka filluar që të hidhen hapat e duhur në drejtimin e duhur, për të arritur idealet e drejtësisë dhe drejtshmërisë.

²⁰⁵ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2019/01/Zakon-za-upotreba-jazitsite-14-01-2019.pdf> qasur më 12.03.2020

Kapitulli IV


1.Të dhëna statistikore nga anketa

Në vijim të këtij punimi do të sjellim disa të dhëna statistikore të cilat janë nxjerrë nga një anketë e bërë nga ne, në lidhje me pasjen e një pasqyre në lidhje me mendimin e qytetarëve për sa i përket gjuhës në procedurën kontestimore dhe ndikimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në procedurën kontestimore. Gjegjësisht mundohemi të pasqyrojmë perceptimin e qytetarëve ndaj ndikimit të këtij ligji në proceset kontestimore konkrete. Anketa përbëhet nga pesëmbëdhjetë pyetje dhe është plotësuar nga 400 individë nga rajone të ndryshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Gjithashtu duhet të përmendim se të dhënat të cilat i kemi kërkuar nga gjykatat në lidhje me proceset gjyqësore dhe aktgjykimet e përpiluara edhe në gjuhë shqipe, nuk na u vendosën në dispozicion, vendosëm që të ndërmarrim këtë qasje, duke anketuar qytetarë, për të fituar një pasqyrë në lidhje me çështjen e cila është objekt studimi i këtij punimi. Në vijim do të pasqyrojmë në tabela disa nga rezultatet e fituara nga kjo anketë.

Nga 400 të anketuar 220 janë meshkuj dhe 180 janë femra, ndërsa përsa i përket moshës, të anketuarit janë grupuar në 4 grupmosha edhe atë: nga 18 deri më 30 vjeç të cilët kan plotësuar 83 anketa; 31 deri më 40 vjeç të cilët kan plotësuar 105 anketa; 41 deri më 50 vjeç të cilët kan plotësuar 127 anketa dhe 51 e më tepër vjeç të cilët kan plotësuar 85 anketa. Për nga përkatësia etnike të anketuarit janë: shqiptarë 200, maqedonas 160, turq 35 dhe të tjerë 5. Sipas vendbanimit të anketuarit grupohen në: 160 të anketuar nga rajoni perëndimor, 150 nga rajoni verior, 73 nga rajoni lindor dhe 17 nga rajoni jugor. Sipas shkallës së arsimimit të anketuarit grupohen në: arsim fillor 45, me arsim të mesëm 183 dhe me arsim sipëror 172.


Në pyetjen: **Sipas vlerësimit tuaj personal, a e vlerësoni që formulimi aktual i dispozitave për gjuhën në procedurën kontestimore është gjithëpërfshirës?** Përgjigjet e të anketuarve janë: Po-163; Jo-144 dhe Neutral-93




Në pyetjen: **A mendoni se është i nevojshëm Ligji për përdorimin e gjuhëve?** Përgjigjet e të anketuarve janë: Po-331; Jo-43 dhe Neutral-



Në pyetjen: **Sipas vlerësimit tuaj personal, Ligji për përdorimin e gjuhëve, e avancon, zyrtarizon apo neutral gjuhën shqipe?** Kemi marrë këto të dhëna: Zyrtarizon-137; Avancon-145 dhe Neutral-118.




Në pyetjen: **A mendoni se do të zbatohet Ligji për përdorimin e gjuhëve në procedurën kontestimore?** Të anketuarit dhanë këto përgjigje: Po-236; Jo-148 dhe Neutral




16

Në pyetjen: **Sipas vlerësimit tuaj, a vlerësoni se ndikimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve do të rrisë shpenzimet procedurale?** Të anketuarit u përgjigjën: Po-342; Jo-47 dhe Neutral-




Në pyetjen: **A mendoni se aparati gjyqësor ka kapacitet dhe përgatitje profesionale adekuate për të zbatuar në mënyrë efektive Ligjin për përdorimin e gjuhëve, konkretisht në procedurën kontestimore?** Të anketuarit u përgjigjën: Po-59; Jo-328 dhe Neutral-




Në pyetjen: **Sipas vlerësimit tuaj, a vlerësoni se palët në procedurën kontestimore (paditësi dhe i padituri) do i ushtrojnë të drejtat të cilat u burojnë nga Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Ligji për procedurë kontestimore për sa i përket përdorimit dhe zhvillimit të procedurës në gjuhën përkatëse, e ndryshme nga ajo maqedonase, nëse të gjithë pjesëmarrësit në**

procedurë janë të një etnie? Të anketuarit dhanë këto përgjigje: Po-321; Jo-13 dhe Neutral-




Në pyetjen: **A mendoni se Ligji për përdorimin e gjuhëve mund të ndikojë me stërzgjatjen e procedurave në procedurën kontestimore me përkthimin e të gjitha shkresave procedurale nga njëra gjuhë në një tjetër?** Të anketuarit u përgjigjën: Po-294; Jo-96 dhe Neutral-




Në pyetjen: **A mendoni se ndikimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në procedurat kontestimore, do të eliminojë disavantazhin gjuhësor në mes pjesëmarrësve të etnive të**

ndryshme në procedurën kontestimore? Të anketuarit u përgjigjën: Po-248; Jo-130 dhe



Në pyetjen: **A mendoni se Ligji për përdorimin e gjuhëve do të vendose kornizën definitive për sa i përket përdorimit të gjuhëve të ndryshme nga gjuha maqedonase, në të gjithë komunikimin me organet shtetërore, dhe veçanërisht në procedurën kontestimore?** Të anketuarit u përgjigjën: Po-124; Jo-231 dhe Neutral-45.



Nga sa mund të vërejmë nga të anketuarit dhe përgjigjet e tyre në pyetjet e anketës, konstatojmë se besimi i qytetarëve në efektet dhe zbatimin e një ligji në një tjetër është

relativisht në nivel konsiderueshëm. Megjithatë organet shtetërore dhe veçanërishtë pushteti gjyqësor duhet që të angazhohet në mënyre më këmbëngulëse për të zbatuar efektin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në Ligjin mbi procedurën kontestimore. Kjo ngaqë në këtë mënyrë do të anashkalohej së pari dëmtimi i të drejtave të cilat qytetarëve u burojnë nga e drejta objektive, dhe gjithashtu për të mënjanuar rrezikun e kontesteve në gjykatat ndërkombëtare për shkelje të këtyre të drejtave, kushtimisht nëse mjetet juridike të parapara me legjislaturën tonë janë konsumuar.

Qëllimi i kësaj ankete siç e thamë edhe më sipër është për të vendosur në pah mendimin e qytetarëve në lidhje me Ligjin mbi procedurën kontestimore dhe Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve. Për tu mos u përsëritur, në këtë pjesë nuk do të sjellim konkluzë dhe rekomandime, ato do të vijojnë në pjesën vijuese të këtij punimi

2.Konkluzë dhe rekomandime

Gjatë këtij punimi patëm mundësinë që të shqyrtojmë një mori çështjes për sa i përket procedurës kontestimore, përkatësisht gjuhës në procedurën kontestimore. Ndër periudha të ndryshme të zhvillimit të së drejtës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe emrat paraprak të cilat ka pasur shteti ndër vite edhe gjuha në procedurën kontestimore ka kaluar në stadi të ndryshme. Duke pasur parasysh që ne jetojmë në një shoqëri multi etnike edhe vetë gjuha e përdorur në procedurën kontestimore është dashur që të adaptohet me nevojat shoqërore. Edhe pse kjo gjë nuk ka qenë kështu çdoherë, sot, në zhvillimin shoqëror dhe zhvillimin e së drejtës, sot mund të themi që zhvillimi i së drejtës dhe zhvillimi i gjuhës në procedurën kontestimore, mund të themi se është në një stad të lartë të zhvillimit dhe gjithpërfshirjes dhe drejtshmërisë ndaj të gjithëve.

Nga shoshitja e çështjeve më sipër dhe nga anketa e realizuar kemi arritur në disa konkluzë: **1. Në stadi të caktuar të ekzistencës së shtetit tonë si njësi federale e ish Jugosllavisë, të paktën në teori, gjuha e etnive të cilat nuk kanë qenë shumicë, gjuhë e**

ndryshme nga ajo maqedonase ka mundur që të përdoret si gjuhë e procedurës kontestimore.

2. Aparati shtetëror ende nuk është i gatshëm për të zbatuar ndikimet e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore, konkretisht ato kontestimore.

3. Sipas formulimit të dispozitave të LPK për përdorimin e gjuhës në procedurë, aktualisht ekzistojnë më pak shpenzime procedurale, ndërsa ndikimi i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve do i rrisë shpenzimet, por kjo në këmbim të disa elementeve më të rëndësishme se shpenzimet procedurale. Duke pasur në mend drejtshmërinë dhe eliminimin e disavantazhit gjuhësor gjatë mbrojtjes së qëndrimeve të tyre në procedurën kontestimore, të etnive të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga ajo maqedonase.

4. Palët në procedurë janë të dekurajuar nga përdorimi i gjuhës së tyre në procedurë në mënyra indirekte (avokatët nuk mund t'i vulosin paditë ose shkresat e tjera të cilat i përpilojnë, nëse ato nuk janë në gjuhë maqedonase ose edhe në gjuhë maqedonase), edhe pse gjatë drejtimit të tyre gjykatës, i'u bëhet me dije që nëse duan mund të deklarohen në gjuhën amtare në prezencën e një përkthyesi.

5. Zhvillimet shoqërore kan ndikuar në nxitjen e lëvizjes së proceseve të ndryshme për të eliminuar pabarazinë ndërmjet qytetarëve, qoftë ajo faktuale apo juridike, duke çuar gradualisht në një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh etninë e tyre.

Duke u nisur nga konkluzat e parashtruara më sipër, mund të japim edhe disa rekomandime, të cilat do të ndikojnë në mënyrë pozitive për përmirësimin e situatës në të cilën gjenden qytetarët, për sa i përket gjuhës në procedurën kontestimore. Rekomandime:

1. Të ndërmerren fushata trajnimi për kuadrin profesional gjyqësor për aftësim sa i përket çështjes në fjalë. E gjithë kjo do të çonte në një mbarëvajtje të punës së sistemit dhe qasjes së qytetarëve në raport me të drejtat e tyre dhe realizimin e tyre.

2. Të organizohen fushata sensibilizimi të cilët do të fokusohen tek qytetarët dhe vetëdijësimin e tyre për sa i përket të drejtave të cilët u burojnë nga e drejta objektive. Gjithashtu të orientohen se në çfarë mënyrë dhe cilat hapa t'i ndërmarrin qytetarët për të realizuar të drejtat e tyre.
3. Të harmonizohet LPK me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve për sa i përket dispozitave të gjuhës në procedurën kontestimore. Kjo për arsye që të mos shkaktohet konfuzion tek aparati gjyqësor dhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi, në lidhje me çështjen në fjalë.
4. Të gjeihen mënyra kreative për të shkurtuar kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, konkretisht në procedurat kontestimore. Kjo me qëllim të arritjes sa më të shpejtë në një epilog të drejtë për palët. Shpesh themi se “drejtësia vonon por nuk harron” megjithatë, “drejtësia e vonuar, është padrejtësi”.
5. Të investohet në softuer përkthimi të cilët do të zgjidhin problemin e përkthimit, duke siguruar efikasitet, shpejtësi dhe cilësi, gjë e cila do të ndikojë pozitivisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procedurë, duke ulur shpenzimet kontinuele buxhetore por edhe shpenzimet procedurale të palëve.

Bibliografia

- Александар Јакшић, Граѓанско процесно право, Београд, 2008.
- Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska - Author; Emine Zendeli, Nagip Zendeli - Translator, E drejta procedurale civile, Libri i parë, Shkup 2011;.
- Brestovci F, E drejta procedurale civile I, 1988, Prizren
- Çavdar K, Komentar na zakonot na parnična postapka, 1998, Skopje.
- Janevski A; Zoroska – Kamilovska T, E Drejta Procedurale Civile – Libri i parë – E drejta Kontestimore, 2009, Shkup
- Georgievski S,. Gragjansko procesno pravo , 2000, Skopje
- Georgievski S,. Parnična postapka, Skopje, 1984
- Georgievski – Marina – Matovski, Pravosuden sistem na SFRJ, 1983, Skopje.
- Kamhi S. Gragjanski sudski postupak, 1961, Sarajevo.
- Lazareviç A, Osnovi na gragjanskata sudska postapka, Skopje, 1964
- Lazareviç A, Osnovi na gragjanskata sudska postapka, Skopje , 1972.
- Лазаревиќ А, Основи на граѓанската судска постапка, Парнична постапка, 1986, Shkup.
- Nuhiu A; Qato M, Procedura Civile Kontestimore, 2016, Tetovë
- Pozniq B, Gragjansko procesno pravo, 1994, Beograd
- Pozniq B; Vrzhalic M; Baçic F;, Zakon o parničnom postupku sa komentarom, Uvodim zakonom i registrom pojama, 1957, Beograd.
- Pozniq B, E drejta e procedurës civile, 1981, Prishtinë.
- Stavileci E, Hyrje në shkencat administrative, 1997, Prishtinë

- Shasivari J, E drejta kushtetuese-dispensë- Ligjërata të autorizuar.
- Shasivari J, E drejta kushtetuese, Tetovë, 2015.
- Triva S; Belajec V; Dika M;; Gragjansko parnično procesno pravo, 1986, Zagreb.
- Triva, Siniša - Dika, Mihailo, Građansko parnično procesno pravo, Zagreb, 2004.

Akte juridike

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991
- Ligji Hyrës për Ligjin mbi Procedurën kontestimore – Fl. Zyrtare e RFPJ, nr. 4/57.
- Ligji për gjykatat e rregullta 1976 – Gazeta zyrtare e R.S.M. nr. 10/1976
- Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 58/2006
- Ligji për përdorimin e gjuhëve i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare e R.M.V. 2019
- Ligji për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetqeverisjes lokale. Gazeta zyrtare e R.M.V. 101/2008
- Ligji mbi Procedurën Kontestimore të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2005.
- Ligji mbi Procedurën Kontestimore të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e R.M. 07/201

Burime nga interneti

- <http://www.zakon.hr>
- <http://pravo.org.mk/>
- <http://www.zdravstvo.gov.mk>
- <http://www.informator.rs/>
- <http://scindeks.ceon.rs/>

- <http://hrcak.srce.hr/>
 - <https://www.researchgate.net/>
 - <http://www.echr.coe.int/>
 - <http://ec.europa.eu/>
 - <http://www.who.int/>
 - <http://www.activecitizenship.net/>
- <http://www.supram.org.rs>